



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
në**

“Inxhinieri Industriale”, me profile:

**“Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”,
“Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim
Projektesh””**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Mimoza Dhrami

2. Dr. Erald Piperi

Korrik, 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", me profile "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", me profile "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 647, datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit viti akademik 2021-2022:	5 PAE / 11 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A 2021-2022, 27 Studentë
19	Komente / të tjera:	Programi është licensuar me emërtimin, Master i Shkencave "Inxhinieri Industriale" me profilet, "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Kimike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh". Me shkresë Nr. 96 Prot date 20.04.2021 protokolluar ne ASCAL me Nr. 19/5, datë 21/04/2021 IAL kerkoi të akreditojë vetëm profilet "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", me arsyen që profilet e tjera i ka jo active.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Master i Shkencave, shkurtimisht MSH në "Inxhinieri Industriale", që ofrohet nga Institucioni privat i arsimit të lartë "Universiteti European i Tiranës", është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 647, datë 11.10.2018, si program i studimeve universitare të ciklit të dytë në fushën e "Inxhinierisë Industriale" me katër profile "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh".

Veprimtaria akademike e këtij programi studimi filloi në vitin akademik 2019-2020, me 10 studentë të regjistruar për herë të parë. Në vijim, numri i studentëve të regjistruar në program ka ardhur duke u rritur e dyfishuar përgjatë këtyre tre viteve akademike.

Programi ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, njësi bazë në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Ristrukturimi i Universitetit European të Tiranës (UET) është bërë me Urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018, "Për hapjen e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, në Universitetin European të Tiranës". Aktualisht UET përbëhet nga 5 Fakultete, 11 Departamente dhe 4 qendra Kerkimore. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës përbëhet nga 2 departamente dhe një qendër për "Zhvillimin e teknologjisë dhe Inovacionin".

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", është program studimi i ciklit të dytë, i përket nivelit të 7_të të kualifikimit sipas KSHK. Ai realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit studentët fitojnë diplomë "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Industriale", me profile "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh".

Ky program i konceptuar në profile, e përgatit studentin me aftësitë dhe kompetencat profesionale për të dalë në tregun e punës, por edhe i jep mundësinë për të zhvilluar një karrierë akademike duke vazhduar studimet e doktoratës.

Programi ka për qëllim të formojnë inxhinierë me profile të ndryshme duke tërhequr ata individë që kanë kryer ciklin e parë të studimeve në inxhinieri industriale me profilet përkatëse që përputhen me profilet e Specializimit. Programi i kushton një theks të veçantë thellimit të njohurive mbi fenomenet, çështjet, problematikat dhe teoritë e shkencës së inxhinierisë, ndërkohë që ofron dhe njohuritë bazë për formimin profesional të një inxhinieri. Përveç sa më sipër, programi ofron edhe lëndë me një theks të qartë praktik.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm,

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, me profile “Inxhinieri Energjitime”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, ka ndjekur hapat të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Procesi nisi me kontaktin e ekspertëve, të cilët u trainuan për standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të brendshëm dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion.

Në fazën e dytë u zbatua me rigorozitet axhenda 2 ditore e vizitës në institucion datat 9 dhe 10 Mars 2022. GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takimet e zhvilluara sipas parashikimit në agjendën e vizitës. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Mimoza Cukalla dhe PhD. Erald Piperi, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentave të vëna në dispozicion në sistemin e ASCAL, të GVB, si edhe vizitës dy ditore pranë Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në UET.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Kodin e Cilësisë si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm. Në hartimin e raportit, grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancës së personelit akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion. Raporti i vlerësimit të jashtëm ju dorëzua koordinatori teknik të ASCAL.

Më datë 22.06.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 87/72 Prot., datë 22.06.2022, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 14.07.2022, dhe me shkresë zyrtare Nr. 78/103 Prot., datë 13.07.2022, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.2, Kriteri 2, GVJ gjykon se ndryshimet në strukturën organizative të Institucionit të Arsimit të Lartë, të miratuar nga MAS, është e nevojshme të reflektohen në dokumentet themelore të institucionit: Statuti, Rregullorja, Strategjia e Zhvillimit, etj. Të gjitha ndryshimet në Statut, të bëra me Vendim të Senatit Akademik, mund të reflektohen në anekset e tij. Në Aneksin 1: “Struktura Akademike”, të Statutit nuk ishte bërë përditësimi i strukturës akademike. [Evidenca 2]. Gjithashtu, në dokumentacionin e ngarkuar në sistem, GVJ nuk gjeti ndonjë organigramë të përditësuar të UET. Në datën 15.07.2022, në sistem janë ngarkuar dokumenta shtesë në lidhje me këtë çështje: Vendimi i Senatit Akademik të UET “Për miratimin e riorganizimit të fakulteteve

të Universitetit Europian të Tiranës dhe hapjen e dy njësive të reja kryesore”, [Evidencë 1.1], dhe “Struktura Organizative 2021-2022”, [Evidencë 1.2]. GVJ mendon se në Aneksin 1, të Statutit, është mirë të reflektohet ndryshimi, i miratuar, i Strukturës Organizative të UET. **Raporti në këtë pikë ndryshon si më poshtë:**

GVJ gjykon se ndryshimet në strukturën organizative të UET, të miratuar me Urdhërin e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018, është mirë që të reflektohen në Aneksin 1 “Struktura Akadematike” të Statutit të UET, për të shmangur çdo konflikt ndërmjet dokumentave themelor të institucionit.

2. Lidhur me komentimin e institucionit për Standardin II.1, Kriteri 1, GVJ konstaton se kreditet e punimit të diplomës janë gjithsej 18 ECTS, të ndara 6 ECTS në semestrin e parë dhe 12 ECTS në semestrin e dytë. [Evidence 14.2] Komentimi i bërë nga Institucioni është i drejtë.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Hiqet paragrafi:

GVJ konstaton se sasia e krediteve (18 ECTS), të alokuar për punimin e diplomës në kurrikulën e Programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale [Evidenca 14], nuk është e njëjtë me sasinë e krediteve (12 ECTS) të vendosura në planin mësimor për punimin e diplomës, [Evidenca 14.2]

3. Lidhur me komentimin e institucionit për Standardin II.3, Kriteri 2, GVJ konstaton se kreditet e punimit të diplomës janë gjithsej 18 ECTS, të ndara 6 ECTS në semestrin e parë dhe 12 ECTS në semestrin e dytë. [Evidence 14.2] Komentimi i bërë nga Institucioni është i drejtë.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Hiqet fjalia:

GVJ konstaton se në planin mësimor, punimit të diplomës i janë alokuar 12 ECTS, ndërkohë që në kurrikul janë vendosur 18 ECTS.

4. Lidhur me komentimin e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 4, GVJ sqaron se komentimi i bërë kërkon të nënvizoj pikërisht vendosjen e kriterëve specifikë referuar moshës së personelit akademik në përputhje me Nenin 65 pika 1 dhe pika 2 e Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë”. **Raporti në këtë pikë ndryshon. Reformulohet paragrafi:**

GVJ rekomandon që referuar Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë” Nenin 65 pika 1 dhe pika 2, urdhrat administrative dhe dokumentat bazë të UET, si: Statuti dhe Rregulloret e UET të vendosen kushtet specifike për kohëzgjatjen e shërbimeve akademike nga persona të cilët kanë mbushur moshën e daljes në pensionit (sipas titujve “Profesor” apo “Profesor I asociuar”) në rastet kur institucioni ka nevojë për angazhimin/ria-angazhimin e tyre.

5. Lidhur me komentimin e institucionit për Standardin V.1, Kriteri 4, GVJ pas vendosjes në dispozicion të dokumentave shtesë (date 15.07.2022) merr në konsiderat komentet e UET dhe reflekton ndryshimin për këtë kriter. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.4, Kriteri 5, GVJ sqaron se ka vlerësuar (citoj) “*Gjurmimi i punësimit të studentëve edhe pse është bërë...*” dhe ndërkohë i përgjigjet pyetjes së kriterit lidhur me natyrën periodike të raporteve analitike referuar programit të studimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
7. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.5, Kriteri 4, GVJ evidenton gjetjet e RVB citoj “*..është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet e dala nga ky raport në njësinë bazë*”. Edhe në dokumentat shtesë të dërguara nga institucioni (date 15.07.2022) një raport i analizës së gjetjeve të raporteve të pyetësorve në nivel njësie bazë mungon. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
8. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.2, Kriteri 3, GVJ pas vendosjes në dispozicion të dokumentave shtesë (date 15.07.2022) merr në konsiderat komentet e UET dhe reflekton ndryshimin për këtë kriter. **Raporti në këtë pikë ndryshon si më poshtë:**
- GVJ thekson se Institucioni, organizon aktivitete monitoruese dhe vlerësuese të organizuara nga KSBC mbështetur në plane monitorimi periodike për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.*
9. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.3, Kriteri 2 dhe 3, GVJ pas vendosjes në dispozicion të dokumentave shtesë (date 15.07.2022) merr në konsiderat komentet e UET dhe reflekton ndryshimin për këtë kriter. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**




**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Inxhinieri Industriale” me profile “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri
Mekanike”, Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË
STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE**


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale është në harmoni me interesat kombëtare . Organizimi i tij është konform me legjislacionin shqiptar dhe përmbajtja e tij është në harmoni me interesat kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, e ofruar nga “Universiteti European i Tiranës”, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore, në përputhje me interesat kombëtare. Ky program studimi mbështetet në misionin e UET. Sipas Statutit të UET, pika 6.2, Misioni i programeve të studimit është që t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përkthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. [Evidencë 2]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, me profile “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, të shprehur në Planin Strategjik 2021-2025 të UET, e cila është detajuar më tej në Planin Strategjik të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”. Fusha e studimit të programit të studimit përputhet me fushën e veprimtarisë së departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës të këtij institucionit. Ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MSH në Inxhinieri Industriale. [Evidencat 3.3; 4].

<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Në veçanti, programi i studimit MSH në “Inxhinieri Industriale”, me profile, është hartuar në përshtatje të kërkesave të tregut të punës dhe ndihmon për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale është në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe i shërben nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe/ose kombëtar, në mbështetje edhe të vizionit të UET për të qenë një qendër ekselence me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal.</p> <p>[Evidencat 3.1, 3.2, 4,7]</p>		
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Përfundimi me sukses i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale me 4 profile u ofron studentëve mundësinë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë. Në rregulloren e Programit të Studimit, është shprehur mjaft qartë që ky program studimi, me 4 profile, synon të thellojë njohuritë e studentëve, të aftësohen me kompetencat e duhura për të ushtruar profesionin si dhe për të vazhduar studimet e doktoraturës, në të ardhmen.</p> <p>[Evidencë 7]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se: Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” me profilet “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Institucionit 2021-2025 dhe objektivat strategjike dhe të departamentit.</p> <p>[Evidenca 2]</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në planin strategjik 2015-2020, pika Objektivat strategjike, theksohet se “UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, TI, komunikimit, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për t'i aplikuar ato”. [Evidencë 3]</p>




	<p>Në statutin e UET, pika 6.1 jepet vizioni i UET “Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike, juridike, të edukimit, e të teknologjisë së informacionit në vend, me ndikim në rajon e më gjerë...” [Evidenca 2]</p> <p>Në dokumentin e Planit Strategjik 2021-2025, pika II.1 “Prioritete në kërkim shkencor”, theksohet ndër të tjera se “...fushat dhe drejtimet kryesore të kërkimit shkencor duhet të jenë në të njëjtën linjë me vetë profilin akademik e shkencor të UET, duke u përqëndruar në drejtime të tilla si ekonomia, financa, menaxhimi, administrimi, marketing, ligji dhe e drejta, komunikimi, shkencat politike, sociologjia dhe antropologjia, edukimit, shkencat kompjuterike dhe TI, studimet rajonale, etj.” [Evidenca 3.3]</p> <p>Në dokumentin e departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës “Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale”, theksohet se “Ky program me profilet e tij mbështeten në strategjinë institucionale të UET dhe në përmbushjen e objektivave strategjike institucionale...”. [Evidenca 4]</p> <p>Referuar vizitës në institucion, strukturës organizative të UET, ku ekziston një njësi kryesore e emërtuar “Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës” dhe njësi bazë “Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës”, si dhe citimeve të mësipërme të nxjerra nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se drejtimet prioritare të zhvillimit akademik të insitucionit janë të përcaktuar në Planin Strategjik 2021-2025 të Institucionit, Statutin e Universitetit si dhe në “Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” të departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale është në përputhje me këto drejtime.</p> <p><i>GVJ gjykon se ndryshimet në strukturën organizative të UET, të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018, është mirë që të reflektohen në Aneksin 1 “Struktura Akademike” të Statutit të UET, për të shmangur çdo konflikt ndërmjet dokumentave themelor të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon, që në Statutin e UET, pika Vizioni dhe Misioni i UET, të dalë qartazi drejtimi inxhinierik si një drejtim akademik dhe shkencor me prioritet zhvillimi për të ardhmen.</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, me profilet “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh” është emërtuar,</p>




përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>organizuar, strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit. Përmbajtja e këtij programi studimi është në linjën e formimit inxhinjerik për industrinë, drejtim që mbulohet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Struktura dhe organizimi i këtij program studimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Programi i studimit është i organizuar me 120 ECTS, kohëzgjatja normale e tij është dy vite akademike dhe disipinat karakterizohen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Grupimet në këto kategori janë Brenda kriterëve të vendosura në VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL"</p> <p>[Evidenca 14, 53.1].</p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale" është ndërtuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe interesit kombëtar. Ai ndjek trendet botërore të zhvillimit, duke respektuar kërkesat e "Kartës së Bolonjës", si dhe duke u përshtatur me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut.</p> <p><i>GVJ nuk konstatoi që të ishte ndjekur ndonjë model programi studimi nga universitete të vendeve të rajonit dhe më gjerë, me të cilët ky program studimi mund të kishte afërsi më të madhe.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3 Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale me profilet "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" janë organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë njohuri të thelluara shkencore, aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e inxhinierisë industriale, specifkisht profilet energjitikë, mekanike, transport dhe menaxhim dhe vlerësim projektsh. Në rregulloren e programit të studimit, pika 3.3 [Evidenca 7] jepen Objektivat Formuese të programit të studimit, si edhe mundësitë e punësimit të studentëve në përfundim të studimeve, (Aneksi 1), si më poshtë:</p> <p>Objektivat formuese: Programi i studimit Master i Shkencave, synon ta pajisë studentin me: a. Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;</p>




- b. Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;
- c. Formim tematik dhe jopanoramik apo historik;
- d. Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor;
- e. Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit;
- f. Stazhe, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj;
- g. Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës.
- h. Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit.

Mundësitë për punësim:

Sipas rregullores së programit të studimit, Aneksi 1, [Evidenca 7] Programi i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri industriale” u jep mundësi studentëve të punësohen si inxhinierë industrialë, sipas njohurive dhe kompetencave të fituara në:

- industrinë e përmasave të ndryshme që kryejnë aktivitetin e tyre në fushën e mekanikës, elektrike, energjetike;
- sektorët e prodhimit, instalimeve dhe testimeve, të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të linjave dhe reparteve të prodhimit;
- industrinë për prodhimin e pajisjeve elektrike dhe makinerive e sistemeve elektrike të fuqisë;
- entet për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e nergjisë elektrike;
- kompani për prodhimin dhe përpunimin e metaleve, polimereve, qeramikave, qelqit dhe kompoziteve si dhe për aplikime në fushat kimike;
- administratën publike, në nivel vendor apo qendror, në menaxhimin dhe kontrollin e kompanive të shërbimit komunal;
- profesionistë të lirë për shërbime dhe këshillim teknik ndaj subjekteve publike apo private.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale” ofron mundësi profilizimi në “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Energjetikë”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe vlerësim projektesh” përmes zgjedhjes të grup-lëndëve të kategorisë C, që përbëjnë vetëm 18 ECTS. Sipas dokumentit të departamentit “Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit Master në “Inxhinieri Industriale”, [Evidencë 4] mundësitë e punësimit të specifikuara sipas profileve të studimit, janë si më poshtë:

Profili “Inxhinieri Energjetikë” ka këto mundësi punësimi:

- në kompani për projektimin e sistemeve të ndryshme energjetike;
- në industrinë e prodhimit ose të shërbimeve;
- profesion i lirë;
- në administratën publike.

Profili "Inxhinieri Mekanike" ka këto mundësi punësimi:

- në projektim, prodhim, menaxhim dhe organizim, asistencë teknike, ekspertizë
- profesion të lirë
- administrate publike
- në projektim të asistuar, mekanike, etj.;
- në ndërmarrje të industrisë mekanike dhe elektromekanike; ndërmarrjet e shndërrimit të energjisë; ndërmarrjet impiantistike; industri të automatikës e robotikës; ndërmarrje për prodhim, instalim, kolaudim, mirëmbajtje të linjave dhe reparteve me sisteme komplekse

Profili "Inxhinieri Transporti" ka këto mundësi punësimi:

- planifikim të komunikacionit,
- projekte dhe planifikim në komunikacionin urban,
- sigurinë rrugore, kompani të sigurimit,
- analizë të qarkullimit rrugor, sinjalistikë rrugore apo hekurudhore,
- vlerësim profesional të aksidenteve,
- në shërbimin e regjistrimit të automjeteve, depo të transportit. Detyrat kryesore që mbulon ky profil lidhen me: incizimin, analizimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, rregullimin e qarkullimit me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë në rrugë apo hekurudhë

Profili "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh" ka këto mundësi punësimi:

- menaxherë të ndërmarrjeve industriale;
- menaxherë të sektorit të prodhimit dhe përpunimit,
- menaxherë të projekteve dhe planifikimit në industri,
- menaxherë të organizimit të proceseve dhe prodhimitarisë,
- menaxherë të mirëmbajtjes,
- menaxherë të transportit,
- menaxherë të logjistikës në industri, etj

GVJ konstaton se objektivat formuese të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, të dhëna në rregulloren e programit të studimit [Evidenca 7], nuk shprehin qartazi njohuritë që merren në fushën e Inxhinierisë Industriale, aftësitë konkrete në këtë fushë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojë ai në dalje, nëpërputhje me VKM Nr.879, datë 18.12.2019. Për më tepër nuk diferencohen objektivat formuese për profilet që ofrohen. Mundësitë e punësimit në disa profile dalin jashtë objektivave formuese. Në dokumentin Plani i Strategjik i zhvillimit të programit të studimit Master në "Inxhinieri Industriale", në Profilin Inxhinieri Energjitime është dhënë mundësia e punësimit në projektimin e sistemeve energjitike. Kjo mundësi punësimi nuk përputhet me objektivat formuese që japin

	<p><i>disiplinat në këtë profil. Nga ana tjetër duhet të bëhet qartazi dallimi i "Inxhinierit Industrial" me profil "Inxhinier Energjitikë" ndaj "Inxhinierit Elektrik" me profil "Energjitikë" jo vetëm në drejtim të rezultateve të të nxënit, por edhe në drejtim të punësimit.</i></p> <p><i>Gjykojmë se tre disiplina me 18 ECTS gjithsej (15% të totalit të krediteve) nuk mund të bëjnë një diferencim kaq të madh në mundësitë e punësimit. Në profilin Inxhinieri transporti jepen mundësi të punësimit në nën-sektorë apo aktivitete, për të cilat në kurrikulën përkatëse nuk përfshihen disiplinat formuese.</i></p> <p>Rekomandohet:</p> <p>1. Objektivat formuese të organizohen në formën e "rezultatet e të nxënit", të organizuara në tre shtylla: njohuritë që përftohen, aftësim për të vepruar dhe kompetenca/përgjegjësi që mund të mbajë. Këto duhet të jenë brenda Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK)</p> <p>2. Profilet të jenë nën-ndarje e formimit kryesor, pa haruar qëllimin për të cilën ngrihet ky program studimi dhe emërtimet e tyre të jenë të jenë të lidhura ngushtësisht me emërtimin kryesor, duke mos sjellë ngatërresë me emërtimet bazë në fushat e inxhinierisë, si Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Pranë Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës është ngritur për herë të parë Bordi i tregut të punës, në përbërje të të cilit janë 13 anëtarë, specialistë, me eksperiencë pune të gjatë, të fushave të ndryshme inxhinjrike dhe arkitekturës, si: në fushat e ndërtimit, mekanikes, transportit, elektrikes, energjitikës, kimisë, teknologjisë së informacionit, arkitekturës, dhe përfaqësues të alumnit. [Evidenca 12.1]</p> <p>Ky bord është konsultativ dhe ndihmon në organizimin dhe përmirësimin e planit mësimor.</p> <p>Në statutin e UET është përcaktuar funksioni i Bordit të tregut të punës për konsultimin e përputhshmërisë së përmbajtjes së programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, dhe analizën e ecurisë së zhvillimit të praktikave dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës. [Evidenca 2, pika 18.4]</p> <p>Departamenti ka kryer studime të tregut të punës [Evidenca 17] referuar kërkesave për profilin e inxhinierisë industriale dhe ka analizuar përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. [Evidenca 35]</p> <p>GVJ konstaton se studimi i tregut të punës, i kryer nga UET është i përgjithshëm dhe nuk ka përfundime në lidhje me kërkesat që ka tregu i sotëm i punës për profilizimet që ofron programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i</p>	<p>Në aneksin e rregullores së programit të studimit, [Evidenca 7], janë listuar disa mundësi punësimi, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> entet për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e nergjisë elektrike;

përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

- kompani për prodhimin dhe përpunimin e metaleve, polimereve, qeramikave, qelqit dhe kompoziteve si dhe për aplikime në fushat kimike;
- administratën publike, në nivel vendor apo qendror, në menaxhimin dhe kontrollin e kompanive të shërbimit komunal

Në analizën e departamentit “Mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesionale” [Evidenca 38], janë dhënë objektiva formuese sipas profileve, një pjesë e të cilave nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me strukturën dhe përmbajtjen e programit, si më poshtë vijon:

a) Kurrikula Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Profili Inxhinieri Energjitike, [Evidenca 38]:

Objektivi formues sipas evidence 38	Përputhshmëria me strukturën dhe përmbajtjen e pr. studimit
<i>Të fitojë njohuri bazë të shkencave të matematikës dhe fizikës në lidhje me pofilin e inxhinierisë elektrike;</i>	<i>Në planin mësimor nuk ka lëndë fizikë të lidhur me profilin e inxhinierisë elektrike</i>
<i>në përfundim të kursit studentët do të kenë njohuri të gjera në lidhje me elektroteknikën.</i>	<i>Në kurrikul nuk ka disiplinë të lidhur me elektroteknikën. Për më tepër, kjo disiplinë zhvillohet në ciklin e parë</i>
<i>studentët do të fitojnë njohuri mbi vizatimin teknik që lidhet drejtpërsëdrejti me projektimin e veprave të ndryshme në këtë fushë dhe mbi të gjitha me standardet e normat që duhet t’ju referohen gjatë punës</i>	<i>Në kurrikul nuk ka disiplinë që të lidhet me vizatimin teknik. Për më tepër, disiplina e Vizatimi Teknik zhvillohet në ciklin e parë</i>
<i>Kursi synon një përgatitje solide bazë që janë për të mbuluar role teknike, tekniko-organizative në fushën e projektimit, prodhimit, kolaudimit, menaxhimit, kontrollit dhe mirëmbajtjes së aparaturave të impianteve elektrike, makinave elektrikestatike dhe rrotulluese, dispozitive elektrike/elektronikë të fuqisë</i>	<i>Në kurrikul nuk ka disiplina që të japin këtë formim</i>

Në kurrikulën e profilit “Inxhinieri Energjitikë” është vendosur lënda “Shkenca dhe teknologjia e materialeve elektrike dhe energjetike”, në të cilën trajtohen tematika në lidhje me lëndët eksplozive, energjia e eksplozivit, vatët goditëse, etj. **Përmbajtja e kësaj lënde nuk ka asnjë lidhje me objektivat formuese për profilin në fjalë.**

b) Kurrikula Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Profili Inxhinieri Mekanike:

Objektivi formues sipas evidencës 38	Përputhshmëria me strukturën dhe përmbajtjen e pr. studimit
<i>studentët do të jene të aftë të kryejnë detyra të ndryshme që nga projektimi i prodhimit deri në menaxhimin e proceseve prodhuese dhe impianteve industriale</i>	<i>Në kurrikulën për profilin "Inxhinieri Mekanike" janë vendosur lëndë, të cilat nuk kanë lidhje me këtë objektiv formues.</i>
<ul style="list-style-type: none"> - të fitojë njohuri bazë mbi teknikat e projektimit mekanik; - të fitojë njohuri bazë mbi materialet dhe strukturën e materialeve; - të fitojë njohuri bazë mbi energjitikën, termodinamikën, mbi transmetimin dhe ruajtjen e energjisë; - të fitojë njohuri bazë mbi punimet e ndryshme mekanike - të fitojë njohuri bazë mbi forcat dhe sistemet e tyre që veprojnë mbi një strukturë të caktuar. 	<p><i>Në kurrikulën për profilin "Inxhinieri Mekanike" janë vendosur disiplina</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Dinamika e sistemeve mekanike; - Mekanika e vibrimeve; - Mekatronikë, <p><i>të cilat nuk kanë lidhje me këto objektiva formues.</i></p>

c) Kurrikula Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Profili "Inxhinieri transporti":

- njohuri mbi sistemet dhe veçoritë e cdo sistemi transporti
- njohuri mbi dinamikën dhe aerodinamikën e mjeteve të transportit
- njohuri mbi mekanikën e automjetit

d) Kurrikula Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Profili Menaxhim dhe vlerësim projektesh:

- njohuri mbi konceptet dhe vlerësimin e projekteve industriale;
- njohuri mbi aftësitë menaxheriale të nevojshme mbi drejtimin e projekteve industriale
- njohuri mbi vlerësimin ekonomik të projekteve

GVJ konstaton se lidhja ndërmjet objektivave formuese-strukturës dhe përmbajtjes së programit të studimit-rezultateve të të nxënit dhe mundësive të punësimit nuk është domethënëse dhe e qëndrueshme. Nga ana tjetër mundësitë e punësimit janë të shprehura në forma të ndryshme në disa dokumenta [Evidenca 38, 4, 7]

GVJ rekomandon që Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës të përcaktojë qartë rezultatet e të nxënit për këtë program studimi sipas profileve që ofrohen nëpërmjet tre komponentëve të tyre që janë: dijet,

	<p><i>aftësitë dhe kompetencat në dalje që përfton student i diplomuar. Rezultatet e të nxënit të jenë të lidhura me mundësitë e punësimit dhe nevojat e tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që emërtimi i profileve të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale të jenë brenda fushës kryesore të studimit që të mos ngatërrohen me fushat e tjera të studimit si Inxhinieri Elektrike, profili energjistik, Inxhinieri Ndërtimi, profili transport, Inxhinieria e transportit, etj.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga departamenti nuk na u ofrua një program/programme studimi të ngjashme me këtë, të ofruar nga universitete në rajon e më gjerë.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvijën disavejeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p><i>Objektivat e këtij programi studimi nuk shkojnë tërësisht në linjën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar për profesionet e rregulluara. VKM Nr.514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, si dhe me direktivën e Bashkimit Europian 2005/36/EC “on the recognition of professional qualifications”.</i></p> <p>Kualifikimi Inxhinieri Industriale, në bazë të këtyre dokumentave është i lidhur me dizejnimin e programeve për koordinimin e veprimtarive prodhuese dhe vlerëson nëse janë kosto efektive dhe të sigurta. Ai organizon dhe mbikëqyr procesin e prodhimit me qëllim nxjerrjen e produktit me cilësi të lartë, duke përdorur metodat efektive dhe me kosto të ulët, ndërsa redukton impaktin e dëmshëm tek mjedisi.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit. Ky program parashikon 12 ECTS për kryerjen e praktikave profesionale në kompani prodhuese. Për këtë UET ka lidhur Memorandume bashkëpunimi me rreth 20 kompani të biznesit.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Në programin Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, me 4 profile lëndët ofrohen në gjuhën shqipe, në përputhje me aktin e licencimit të programit të studimit. Deri tani, UET nuk ka marrëveshje me universitete partnere për shkëmbim studentësh në këtë program studimi. Në planin strategjik për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka parashikuar ofrimin e shkëmbimeve studentore në institucione universitare partnere të huaja nëpërmjet programit ERASMUS</p>

Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Plani mësimor, silabuset, diploma dhe suplementi i diplomës janë përgatitur edhe në gjuhën angleze.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	X		

Standardi I.4																																																						
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.																																																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																					
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës është krijuar në vitin akademik 2018-2019, së bashku me licensimin e programeve të studimit Inxhinieri Industriale, Inxhinieri Ndërtimi dhe Arkitekturë. Në vitin akademik 2021-2022, departamenti përbëhet nga 10 personel akademik efektiv (PAE) dhe 16 personel akademik me kontratë (PAK). 80% e personelit akademik efektiv është me tituj e gradë shkencore dhe 50% e personelit akademik me kontratë është me tituj e gradë shkencore. [Evidenca 23, tabelat 1 dhe 2]</p> <p>Referuar CV të ngarkuar në sistem konstatohet që personeli akademik efektiv është me përvojë në mësimdhënie dhe ekspertiza e tyre është në përputhje me fushat akademike specifike të programeve të studimit që mbulon ky departament. Evidenca 20</p> <p>Në programin e studimit Masteri Shkencave në Inxhinieri Industriale përfshirja e stafit akademik në mësimdhënie ka qenë si më poshtë. [Evidenca 02]:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Titulli</th> <th colspan="2">V.a. 2019-2020</th> <th colspan="2">V.a. 2020-2021</th> <th colspan="2">V.a. 2021-2022 (S.1)</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>3</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>13</td> <td>5</td> <td>11</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” është me nivel kualifikimi kryesisht më të lartë se ai ciklit të studimit. Nga shqyrtimi i CV rezultoi se stafi akademik ushtron aktivitetin mësimdhënës brenda fushës së kualifikimit të tij akademik. Raporti i personelit efektiv me atë me kontratë është 1/2.3 për v.a. 2019-2020 ; 1/2.6 për v.a. 2020-2021 dhe 1/2.2 për vitin akademik 2021-2022 (semestri 1)</p>						Titulli	V.a. 2019-2020		V.a. 2020-2021		V.a. 2021-2022 (S.1)		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	2	1	1	2	1	1	Prof.As.Dr	1	2	3	4	-	3	Dr./PhD	-	3	1	4	3	4	Msc	-	1	-	3	1	3	Totali	3	7	5	13	5	11
Titulli	V.a. 2019-2020		V.a. 2020-2021		V.a. 2021-2022 (S.1)																																																	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																
Prof.Dr	2	1	1	2	1	1																																																
Prof.As.Dr	1	2	3	4	-	3																																																
Dr./PhD	-	3	1	4	3	4																																																
Msc	-	1	-	3	1	3																																																
Totali	3	7	5	13	5	11																																																

	<p>GVJ konstaton se në departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, numri i personelit akademik efektiv me ekspertizë të afërt me atë të fushës akademike të Inxhinierisë Industriale, referuar stafit të deklaruar për vitin akademik 2021-2022 është i ulët (gjithsej 4)</p> <p>Si rrjedhojë, programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” mbulohet pjesërisht nga pedagogët e departamentit dhe kryesisht nga pedagogë të ftuar. Për semestrin e1 të vitit akademik 2021-2022, raporti i ngarkesës sërealizuar nga personel akademik efektiv dhe atij me kontratë ka qenë: 32% PAE dhe 68% PAK. Tabela 12.</p> <p>Për realizimin e planit mësimor, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës shfrytëzon auditorët e Universitetit, laboratorët e informatikës së UET si dhe laboratorët Kolegjit Professional të Tiranës. [Evidenca shtesë 5, 42.1]</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës nuk i ka plotësisht burimet e nevojshme për realizimin e këtij programi studimi. Burimet njerëzore janë të kufizuara.</p> <p>GVJ rekomandon rritjen e numrit të personelit akademik efektiv me ekspertizë në fushën akademike të afërt me Inxhinierinë Industriale.</p>						
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Ky fakultet përmbledh fushat e studimit si Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi (BA dhe Msc), Inxhinieri Industriale (BA dhe MSC), Inxhinieri Informatike (BA dhe MSC), Teknologji Informacioni (BA dhe MSC). Vetë emërtimi i Fakultetit ka përmbledhur të gjithë fushat e përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Nga verifikimi i të dhënave themi se, programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore.</p> <p>[Evidenca 26, tabela 3]</p>						
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike, si dhe me fushën kërkimore të njësisë bazë.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="563 1827 775 1895">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="775 1827 978 1895">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="978 1827 1185 1895">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="563 1895 775 1935"></td> <td data-bbox="775 1895 978 1935" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="978 1895 1185 1935"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						




Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në dokumentacionin themelor të Universitetit, Statuti [Evidenca 2], Rregullore e UET [Evidenca 5], Dokumenti F.IV dhe F.V mbi funksionimin e dekanatit dhe departamentit [Evidenca 6] shprehin mjaft qartë strukturën e drejtimit të universitetit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe procedurën për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Njësitë administrative të Universitetit kanë detyra dhe përgjegjësi në lidhje me faza të ndryshme të procesit të miratimit të një programi studimi, por pesha kryesore e përgjegjësisë për përmbajtjen, strukturën e programit të studimit dhe realizimin e saj mbetet në Departament.</p> <p>Departamenti ka përcaktuar koordinatorin e programit të studimit [Evidenca 36]. Në aktet rregullatorë janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjësit të njësive bazë, përgjegjësit të grupit mësues/koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë periodike [Evidencat 35, 38, 46.5, 46.6]. Në bazë të këtyre evidencave rezultojnë se janë bërë raportime periodike për zhvillimin e mësimit online; është bërë analiza e departamentit për përmbushjen e objektivave formuese për këtë program studimi; është raportuar mbi përfitimet e departamentit nga marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani të ndryshme në tregun e punës.</p> <p><i>RVJ konstaton se koordinatori i programit të studimit nuk rezultojnë të jetë pjesë e stafit mësues në këtë program Studimi. Për më tepër ai është koordinator për të gjitha programet e studimit që ofron njësia bazë, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësues e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për Inxhinieri Industriale. [Evidenca 3.3]. Në nivel institucional UET gëzon 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL kryesisht në Europë [Evidenca 34]. Nga ana tjetër DIA gëzon marrëveshje bashkëpunimi me IAL të ndryshme shqiptare, publike dhe jo publike si dhe me subjekte të prodhimit. [Evidenca 32]. Gjithashtu, UET ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave dhe mundësi të tjera bashkëpunimi [Evidenca 34.1 – 34.21].</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore,</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës ka nënshkruar Memorandume bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas për realizimin e praktikave profesionale [Evidenca 34.1 – 34.21]. IAL ka të përcaktuara rregulla mbi organizimin, kontrollin dhe raportimin në lidhje me</p>

<p>kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>organizimin e praktikave profesionale. [Evidenca 32.1]. Në fund të vitit akademik, praktika vlerësohet nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një pyetsori, ku merret nje feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre, dhe ku mund të punohet më tej në përmirësimin e praktikave [Evidenca 32.2]. Departamenti ka hartuar një raport analitik për periudhën 2018-2021 në lidhje me përfitimet e DIA prej marrëveshjeve të bashkëpunimit. [Evidenca 35].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen e praktikave profesionale është zyrtarizuar përmes marrëveshjeve të shkruara. Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet akteve të brendshme, Dokumenti B.I, ku janë parashikuar edhe detyrat dhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces, brenda apo jashtë UET. [Evidenca 32.1].</p> <p>Meqenëse studentët e masterit ishin të gjithë të punësuar, në periudhën 2018-2021, studentët i kanë kryer praktikat profesionale pranë qendrave të tyre të punësimit. Departamenti kishte ngarkuar nje person të kompanisë si përgjegjës për të ndjekur ecurinë e praktikës nga ana e studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UET synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboreve, etj.</p> <p>UET-i ka krijuar me sukses Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve, me qëllim për të zhvilluar projekte ndërkombëtare, partneritete strategjike dhe të lehtësojë aplikimet për grante kërkimore. [Evidenca 28.1; https://uet.edu.al/active-projects/; https://uet.edu.al/completed-projects/].</p> <p>Nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara, https://uet.edu.al/en/inter-institutional-agreement/ është bërë e mundur shkëmbimi i stafit, për të dhënë mësim, në universitetet homologe dhe shkëmbimi i studentëve, nëpërmjet programit Erasmus+. Veçanërisht nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës prej vitit 2019 angazhohet personel akademik në projektin ERASMUS KA2 “Engineering curricula modernization in renewable energy in Albania Universities-ENGINE”, ku UET është partner. [Evidenca 28.5].</p> <p><i>GVJ vlerëson se duhet të rritet numri i bashkëpunimeve me institucione homologe ndërkombëtare, që ofrojnë programe studimi në fushën e Inxhinierisë Industriale, me qëllim përmirësimin e kurrikulës dhe mundësimin e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës kishte hartuar një raport ku analizonte përfitimet e DIA-s nga marrëveshjet e bashkëpunimit për kryerjen e praktikave profesionale [Evidenca 35]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UET ndjek një politikë mbështetëse për veprimtarinë kërkimore shkencore të stafit akademik dhe publikimin produktit kërkimor të stafit dhe studentëve. Kjo është e shprehur qartë në Strategjinë e kërkimit shkencor UET 2017-2020 [Evidencë 3.1] dhe Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025, Pika 6 – 8 [Evidencë 3.2].</p> <p>Personeli akademik i Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (DIA) ka mundësi për të publikuar në revistën shkencore ndërkombëtare NODUS dhe për të referuar në konferencën ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”. [Evidencë 55]. Në UET janë rritur kërkesat në drejtim të cilësisë së punimeve duke kërkuar publikimeve në revista me faktorë impakti mundësisht Thomson Reuters/Clarivate [Evidencë 3.3] Gjithashtu, studentët e programit të studimit, nxiten nga pedagogët e tyre të botojnë punimet e tyre në revistën shkencore të fakultetit “INGENIOUS”, ose të referojnë në konferencën ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare”. [Evidencë 55]. Kjo politikë është theksuar dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit të Studimit. [Evidencë 4]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UET ka hartuar Strategjinë e kërkimit shkencor në UET (2017-2020; 2021-2025), i cili shërben si dokument rregullator për kërkimin shkencor. Kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentat që do të përdorë UET për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor. [Evidencë 3.1; 3.2]</p> <p>Në organikën e UET, është përcaktuar edhe pozicioni i Zv. Rektorit për kërkimin shkencor, që kujdeset edhe për pjesën e kërkimit shkencor dhe studimet e ciklit të tretë në UET.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Çdo dy vjet në UET, realizohet folloë up me stafin akademik mbi publikimet dhe aktivitetin e tyre shkencor, të cilat vetëdeklarohen në “Formular për vetvlerësimin e performancës së personelit akademik”, Gjithashtu, nëpërmjet financimeve që UET ofron, nxit promovimin e kryerjes së kërkimit shkencor. Promovimi i këtyre rezultateve realizohet gjatë mbledhjeve të ndryshme, si psh., në Asamblenë e personelit akademik, gjatë mbledhjeve të departamentit, apo edhe publikimeve nga Shtëpia Botuese UET Press, Gazeta Liberale, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>UET ka të parashikuar në Kodin e Etikës së institucionit, Dokumenti A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2, praktikën e mirë që duhet të ndjekë çdo anëtar i komunitetit UET, qofshin këta anëtarë të personelit apo student, për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si edhe praktikën e mirë në</p>

	veprimtarinë kërkimore e botuese. [Evidenca 56] Instalimi i sistemit të antiplagjiaturës Turnitin Ephorus, pavarësisht kufizimeve që ka, ndihmon për të kontrolluar punimet e studentëve.		
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Një ndër objektivat kryesor të programit të studimit, është të pajisë studentin me aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, zakonisht realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me pedagogët e tyre. Format e bashkëpunimit, mund të jetë përfshirja e studentëve në punën kërkimore të pedagogut, prezantimi në konferencën shkencore si DSSH apo detyrat e kursit. <i>GVJ rekomandon që DIA të shtojë përpjekjet për përfshirjen e studentëve të Inxhinierisë Industriale në aktivitete kërkimore, nëpërmjet bashkëpunimit të tyre me pedagogët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Mbështetur në kurrikulën e programit të studimit Master i shkencave në "Inxhinieri Industriale", konkludojmë se ky program studimi është i organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara në kredite, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 6 kredite (ECTS), punimi i diplomës është vlerësuar me 18 kredite (ECTS) dhe praktika profesionale me 12 kredite (ECTS). Totali i krediteve që studenti duhet të marrë për t'u diplomuar është 120 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 2 (dy) vite akademike. [Evidenca 14].
Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një	Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale" është i licënsuar me 5 profile, nga të cilat kërkohet akreditim për katër profile: "Inxhinieri Energjitike" dhe "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh". Nga shqyrtimi i

<p>Ilojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>dokumentacionit të këtij programi studimi, për dy profilet e aktivizuara, si: Rregullorja e programit të studimit, plani mësimor, syllabuset, [Evidenca 7, 14, 19], si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve llojshmëri në njohuri, të nevojshme për përgatitje profesionale në përgjigje të kërkesave të tregut të punës, si dhe u jep mundësi për të vazhduar studimet në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p><i>GVJ vëren se profili “Inxhinieri Kimike”, i licensuar me këtë program studimi nuk është aktivizuar dhe për këtë profil nuk është kërkuar akreditim.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, studentët përftojnë aftësi teorike dhe praktike të nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike në fushën e inxhinierisë industriale.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i kurrikulës, si disipinat e formimit karakterizues të këtij programi studimi dhe disipinave të profileve të dhëna, si dhe shqyrtimi i silabuseve, GVJ gjykon se formimi që merr studenti është shumë më afër me njohuritë që përftohen në programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, me profilet “Energjitikë”, “Konstruksione Mekanike” dhe “Mjete Lëvizëse”. [Evidenca 14, 19].</i></p> <p>Përgjithsisht niveli i njohurive që jepen në silabuset e lëndëve ngrihen mbi ato të ciklit të parë dhe deri diku kanë një nivel të thelluar, aplikativ dhe krahasues. Në dokumentin A.III, [Evidenca 39] jepen parimet e ndërtimit të programeve lëndore, ku për programet e ciklit të dytë rreth 15% e lëndës përbëhet nga koncepte dhe njohuri bazë, rreth 70% përbëhen nga njohuri të thelluara, të aplikuara dhe krahasuese dhe rreth 15% analizë /kritikë e teorisë dhe aplikimeve të fushës.</p> <p>Nëpërmjet kurrikulës synohet që studenti të pajiset me [Evidenca 7]:</p> <ol style="list-style-type: none"> Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; Parapërgatitje për licensën e profesionit të rregulluar; Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; Aftësim të plotë për zhvillim karriere dhe vazhdim të studimeve të përgjithshme praktike, aplikative; Punim diplome me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përshtatje me formimin inxhinierik.</p> <p><i>GVJ gjykon se njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që zhvillohen nga ky program studimi përfaqësohen më shumë me programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike se sa me formimin Inxhinieri Industriale, referuar VKM 514, datë 20.09.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”</i></p>




<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 75). Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Studimet përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Shkencave". Rregullorja mësimore e programit të studimit MSc në "Inxhinieri Industriale", mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi, në Statutin dhe Rregulloren e UET. Plani mësimor, Syllabuset dhe rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", përmbajnë të gjithë elementët përshkruar të programit të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënjes, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, kodi i lëndës, etj. [Evidenca 7, 14, 14.2, 19.1].</p> <p><i>GVJ konstaton se në planin mësimor nuk reflektohen kreditet e lëndës të alokuara për detyra ose projekte. Per shumë disiplina ka ndarje të krediteve sipas aktiviteteve formuese: leksione, seminare (ose leksion/seminar), ushtrime/laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor.</i></p> <p><i>Theksojmë se kontrolli i vazhdueshëm nuk është aktivitet formues për lëndën. Aktiviteti formues detyrë ose projekt nuk pasqyrohet në planin mesimor, megjithëse ky aktivitet është pjesë përbërëse e aktiviteteve formuese të disiplinave inxhinjerie. Nga ana tjetër në të gjitha silabuset nuk reflektohet dallimi ndërmjet seminarit dhe ushtrimeve gjatë zhvillimit të lëndës. Në silabuse nuk reflektohen orët në auditor të alokuara për aktivitetin formues "Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor"</i></p> <p><i>GVJ konstaton se në të gjitha disiplinat ka mospërputhje të orëve në auditor të vendosura në planin mësimor me ato të reflektuar në silabuse. Në silabuse flitet për kontrolle të ndërmjetme, por nuk parashikohen se kur do të zhvillohen ato, pavarësisht se janë parashikuar orë në auditor për ato kontrolle.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët e programit të studimit janë të organizuara në 5 kategori disiplinash (A-E), sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe rregullores së UET. Plani mësimor, i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", i ka lëndët e grupuara sipas tipit të veprimtarisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndë bazë 12 ECTS ose 10% • lëndë karakterizuese 60 ECTS ose 50% • lëndë ndërdisiplinore/integruese 18 ECTS ose 15% • lëndë plotësuese 12 ECTS ose 10% • detyrime përmbyllëse 18 ECTS ose 15% <p>Kreditet e alokuara në lëndët e kategorisë A+B përbëjnë 60% të krediteve</p>

	<p>totale.</p> <p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Detyrimet përmblylëse janë me punim diplome.</p> <p>Ngarkesa normale është 60 kredite në vit, e ndarë në mënyrë të barazpeshuar me nga 30 ECTS për semestër. Të gjitha disiplinat janë të barazpeshuar me 6 ECTS. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore në auditor dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Orët në auditor janë më pak se 50% e orëve totale të punës së studentit. [Evidenca 5, 14, 14.1]</p>						
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në programin e studimit, punimi i diplomës ndodhet në kategorinë E “Detyrime Përmblylëse” dhe ka 18 ECTS. Në dokumentin B. II, <i>Mbi punimin e diplomës</i> , janë të përcaktuara qartë kërkesat për punimin e diplomës dhe procedurat e zhvillimit të punimit të diplomës dhe aktivitetet që kryhen në këtë kuadër të saj. [Evidenca 10].						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X	
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
	X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Universiteti Europian i Tiranës është i licensuar VKM Nr. 636, datë 20.9.2006 si një shkollë e lartë universitare jopublike. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës është hapur me ristrukturimin e Universitetit Europian të Tiranës (UET), me Urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018, “Për hapjen e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, në Universitetin Europian të Tiranës”. Aktualisht UET përbëhet nga 5 Fakultete, 11 Departamente dhe 4 qendra Kërkimore. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (FIIA) përbëhet nga 2 departamente dhe një qendër për “Zhvillimin e teknologjisë dhe Inovacionin”. UET është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, dhe pas riorganizimit me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019. [Evidenca 54.1, 54.2, 54.3, 54.4]</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022, semestri I, në FIIA numëroreshin 27 personel akademik efektiv, nga të cilët 13 janë me tituj dhe grada. Shpërndarja e personelit akademik efektiv sipas njësive bazë është: [Evidenca 23, tabela 1]</p>

Njësia	FIIA	Departamenti IT	Departamenti IA	Qendra ZHTI
Nr.total PAE	27	8	10	9
Nr.PAE me tituj/ gradë shkencore	15	4	8	3
Nr.PAE,kategoria "Profesor"	6	1	4	1

Në përbërje të fakultetit janë 6 personel akademik efektiv i kategorisë "Profesor". Departamenti është njësi bazë e Fakultetit Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Departamenti zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Fakulteti FIIA dhe njësitë e tij bazë plotësojnë kërkesat ligjore për të funksionuar si të tilla.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i cili është përgjegjës për programin Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, përmbush detyrimet ligjore sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", si edhe për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti ka tre njësi bazë, ku secila prej tyre plotëson kriteret strukturore për të qenë njësi bazë më vete. Fakulteti ka një numër të mjaftueshëm personel akademik efektiv me tituj e gradë shkencore (15). Fakulteti ka personel ndihmës akademik dhe administrativ në ndihmë të zhvillimit të procesit mësimor. Një pjesë e proceseve administrative në lidhje me menaxhimin e hyrjeve, në universitet, si dhe për mbajtjen dhe administrimin e rekordeve akademike të studentëve janë të përqëndruar në nivel universiteti, si rezultat i përdorimit të platformës Moodle UET-LMS. Departamenti plotëson kriteret minimale ligjore në lidhje me numrin e personelin akademik efektiv dhe atij me tituj e gradë shkencore. Raporti personel akademik efektiv/studentë në nivel njësie bazë është 1 me 22.4. Departamenti organizohet në grupe mësimore, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grupeve mësimore.

GVJ konstaton se në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat e vëna në dispozicion nuk figurojnë në departament të këtyre personelit ndihmës akademik (laborant). Kjo vjen nga fakti se vetë departamenti nuk ka ndonjë laborator nën menaxhimin e tij. Punët laboratorike të parashikuara në kurrikulën e Inxhinierisë Industriale zhvillohen në laboratorë që menaxhohen nga departamente të tjerë të FIIA, si dhe nga KPT. Për këtë ka Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet UET dhe KPT, Nr.171 Prot, date 23.09.2020 [Evidencë shtesë 4].

	<p>Ky departament zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të cilat përditësohen në vazhdimësi në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Struktura akademike e departamentit të Inxhinierisë përbëhet nga 2 programe studimi të ciklit të parë, Bachelor, të organizuara në profile, 2 programe studimi të ciklit të dytë, Master i Shkencave, të organizuara me profile dhe një program i integruar i studimit Master i shkencave.</p> <p>Aktivizimi i personelit akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar krijon mundësi që të plotësohet kriteri i nivelit të kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënje në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit rezultojnë se njësia bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Përbërja e Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës në 4 vitet e fundit, referuar personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë, ka qenë si më poshtë:</p> <p>Viti akademik 2018-2019:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 PAE, të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 3 me grada e tituj • 2 PAK, të angazhuar me kohë të pjesshme, me gradë shkencore Dr. <p>Viti akademik 2019-2020:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 8 PAE, të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 6 me grada dhe tituj • 16 PAK, të angazhuar me kohë të pjesshme, nga të cilët 11 me grada dhe tituj <p>Viti akademik 2020-2021:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 9 PAE, të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 7 me grada dhe tituj • 25 PAK, të angazhuar me kohë të pjesshme, nga të cilët 19 me grada dhe tituj <p>Viti akademik 2021-2022 (Sem.I):</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 PAE, të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 8 me grada dhe tituj • 16 PAK, të angazhuar me kohë të pjesshme, nga të cilët 8 me grada dhe tituj.
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Këto të dhëna tregojnë një rritje, nga viti në vit, të numrit të personelit akademik efektiv me rritjen e ngarkesës mësimore në departament. Në rritje të numrit të përgjithshëm fokusi ka qenë në rekrutimin e personelit akademik me kualifikimet e nevojshme.</p> <p><i>Nga kqyrja e të dhënave të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënje konstatohet se përgjithsisht personeli akademik, si ai efektiv dhe me kontratë të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, pranë Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, është me përvojë në mësimdhënje dhe specialistë në fushat e tyre të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore,</p>	<p>Për realizimin e praktikave profesionale, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, përgjegjëse për organizimin e kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, cakton një pedagog për t'i ndjekur ato. Në Broshurën B.I. "Mbi praktikën profesionale", [Evidenca 32.1], jepen</p>




<p>laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>kërkesat e Institucionit për organizimin, kontrollin dhe vlerësimin e praktikave profesionale. Në ciklin e dytë të studimeve, studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/kompani i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës, i caktuar në rolin e Këshilluesit të karrierës. Fakulteti i Inxhnierisë, Informatikës dhe Arkitekturës ka marrëveshje me institucione dhe kompani që ushtrojnë biznes në fushën e profesionale të programit të studimit për realizimin e praktikave mësimore. [Evidenca 18]. Praktikant mbikëqyren nga një pedagog i departamentit, si edhe nga personi përgjegjës në insitucionin/kompaninë ku zhvillohet praktika.</p> <p>GVJ konstaton se në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat e vëna në dispozicion nuk figurojnë që në departament të ketë personel ndihmës akademik (laborant).</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me vendim të Dekanit Nr. 36, date 14/04/2021, është bërë emërimi i Koordinatorit të Programit të studimit. [Evidencë 36] Në departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës është caktuar një koordinator për të gjitha programet e studimit, që mbulon ky departamenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bachelor në Inxhinieri Industriale, (në të gjitha profilet) • Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi (në të gjitha profilet) • Master i shkencave në Inxhinieri Industriale (në të gjitha profilet) • Master i shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (në të gjitha profilet) • Program i Integruar Master i Shkencave në Arkitekturë <p>Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET. [Evidenca 6] Në bazë të këtyre evidencave, Koordinatorin e programit të studimit shqyrton hartimin e programeve të lëndëve, përcakton materialet e nevojshme bibliografike dhe informatike për lëndët, miraton tezat e provimeve, kontrollon përputhshmërinë e temave të diplomës me fushën e kërkimit të pedagogut udhëheqës, ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale, punon për garantimin e përputhshmërisë së kurrikulës me të rejtat e fundit të shkencës dhe nevojat e tregut të punës, harton raportin periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të nxënit.</p> <p>GVJ konstaton se departamenti mbulon programe studimi që i përgjigjen quartazi tre fushave të ndryshme të formimit: Inxhinieri Industriale, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë. Caktimi i një koordinatori të vetëm për të gjitha programet e studimit, të ciklit të parë dhe të dytë, për të tre fushat e studimit nuk mundëson kryerjen me cilësi të të gjitha detyrave që i janë ngarkuar koordinatorit në aktet e brendshme të UET [Evidenca 6, 36]</p>
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Nga kqyrja e silabuseve, GVJ konstatoi se koordinatori ka firmosur silabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale". Në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nuk ka ndonjë evidence në lidhje</p>

	<i>me raportimin periodik të koordinatorit tek drejtuesi i njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë të detajuara në dokumentacionin themelor të programit të studimit: Kurrikula, Plani mësimor, Silabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit [Evidenca 7, 14, 14.2, 14.4, 19] Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mesimdhenje në këtë program studimi.</p> <p>Nga vizita në mjediset e UET, u konfirmua që stafi akademik dhe studentët kishin akses të plotë mbi këtë informacion dhe në të gjithë dokumentacionin tjetër të UET: statut, rregullore, etj, pasi këto dokumeta janë të publikuara në intranet të UET.</p> <p>Menaxhimi i të gjithë procesit mësimor dhe administrativ bëhet nëpërmjet platformës UET LMS, që është një platformë komunikimi i vazhdueshëm interaktiv midis studentëve dhe stafit akademik, administrativ dhe departamenteve përgjegjëse për programet e studimit. Në këtë platformë studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij, Silabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë. Kjo platformë është vënë në funksionim në vitin 2017 [Evidenca 46.1]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në "Inxhinieri Industriale" është i organizuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Programi është i ndarë në lëndë mësimore/module, praktike dhe detyrime përmblyëse. Çdo lëndë ndahet në aktivitete formuese si: Leksione/Seminare/ushtrime&labororë/ Forma të kontrollit & praktika profesionale të zhvilluara në auditor. Mënyra e organizimit të programit të studimit detajohen në kurrikulën dhe planin mesimor. [Evidencë 14, 14.2, 14.4] Nga shqyrtimi i planit mësimor, konstatohet se disiplinat mësimore dhe komponentët e tjerë mësimor janë të organizuara në 5 kategori: A, B, C, D dhe E.</p> <p>Në kategorinë A janë grupuar lëndë të formimit bazë dhe kulturë e përgjithshme, në total 12 ECTS, të cilat i përkasin përgatitjes metodologjike për thellime në fushën inxhinjrike (Metoda kërkimi të avancuara dhe Kërkime Operacionale).</p>

Në kategorinë B janë grupuar lënde karakterizuese, të cilat bëjnë përgatitjen për fushën e inxhinierisë industriale. Totali i krediteve të grupuar në këtë kategori është 60 ECTS. Në këtë kategori futen:

- grup disiplinat në fushën e energjitikës” (30 ECTS), si: “Aplikime të avancuara në Fizikë Teknike”, “Fluidodinamika e kompjuterizuar e makinave”, “Impjante termoteknike për ngrohje-ftohje”, “Energjetikë: Burimet energjetike, akumulimi dhe transporti”, “Turbomakinat”.
- grup disiplina në fushën e konstruksioneve mekanike (12 ECTS), si: “Konstruksion Makinash”, “Pajisje dhe sisteme robotike Industriale”.
- grup-disiplina në fushën e materialeve dhe sistemeve të prodhimit (12 ECTS), si “Sistemet e integruara dhe inovative për prodhimin industrial”, “Materialet për industrinë”.
- disiplina e Bioteknologjisë (6 ECTS)

Në kategorinë C janë grupuar lëndët e profileve, të cilat janë të detyrueshme për profilin përkatës. Për të katër profilet janë parashikuar nga 3 disiplina për secilin profil që përbëjnë në total 18 ECTS, përkatësisht:

- Profili Inxhinieri Energjitikë: “Shkenca dhe teknologjia e materialeve elektrike dhe energjetike”, “Eficienca energjetike”, Sisteme energjetike inovative dhe mbrojtja e mjedisit”.
- Profili Inxhinieri Mekanike: “Dinamika e sistemeve mekanike”, “Mekanika e vibrimeve”, “Mekatronikë”.
- Profili Inxhinieri Transporti: “Sistemet e transportit rrugor, hekurudhor, detar e ajror”, “Dinamika dhe aerodinamika e mjeteve të transportit”, “Mekanika e Automjetit”.
- Profili Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh: “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, “Aftësi menaxheriale”, “Vlerësim ekonomik Projektsh”


Në kategorinë D është kategorizuar Praktika profesionale me 12 ECTS.

Në kategorinë E është futur punimi i diplomës me 18 ECTS.

Gjatë semestrit të katërt, studenti shlyen detyrimin përmbyllës, në të cilën duhet të vlerësohet pozitivisht që të përmbyll studimet e ciklit të dytë.

GVJ gjykon se në disa profile disiplinat e profilit nuk lidhen me tërësinë e disiplinave që formojnë bërthamën e programit të studimit, si p.sh. disiplinat e profilit Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh, ose disiplina “Shkenca dhe teknologjia e materialeve elektrike dhe energjetike”, në të cilën trajtohen materialet eksplozivë, ose disiplina “Mekatronikë”, për të cilën studenti duhet të ketë fituar njohuri paraprake në projektimin e sistemeve të kontrollit si dhe të njohë qarqet elektronikë dhe amplifikatorët operationale, etj. Nga ana tjetër lënda e Bioteknologjisë nuk përputhet fare me formimin që merr studenti në këtë program studimi.

	<p><i>GVJ gjykon se emërtimi i profileve si “Inxhinieri Energjitikë”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, të cilat diferencohen nga njera tjetra vetëm me 18 ECTS, i ekuivalenton këto profile me programet e studimit Master i shkencave, që kanë emërtim të njëjtë me to.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Lëndët e programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Inxhinieri Industriale” janë të vlerësuara sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve. Programi i studimit është me 120 Kredite ECTS. Viti akademik ka 60 kredite ECTS. Një semestër është i organizuar mesatarisht me 30 kredite ECTS. Kurrikula është ndërtuar me lëndë e module të vlerësuara me ECTS. Çdo lëndë ka 6 ECTS [Evidencë 14, 14.2]</p> <p>Shpërndarja e krediteve sipas kategorive të disiplinave nga A në E është bërë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi (VKM nr.41, datë 24.01.2018):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kategorinë A janë grupuar 10% e krediteve të programit të studimit. • Në kategorinë B janë grupuar 50% e krediteve të programit të studimit. • Në kategorinë C janë grupuar 15% e krediteve të programit të studimit. • Në kategorinë D janë grupuar 10% e krediteve të programit të studimit. • Në kategorinë E janë grupuar 15% e krediteve të programit të studimit (sipas kurrikulës) [Evidenca 14].
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jastë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Informacioni i ofruar për programet e studimit, me lëndët përbërëse të tyre, sipas viteve dhe semestrave janë të publikuara në faqen e internetit të UET-it.</p> <p>https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2021/09/Msc.-Inxhinieri-Industriale.pdf</p> <p>Plani mësimor i program jep informacion në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Në rregulloren e UET, [Evidenca 5], dhe rregulloren e programit të studimit, [Evidenca 7], përcaktohen rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimin, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, mënyrën e zhvillimit të provimeve, etj. Për këtë program studimi, leksionet, seminarat, leksion/seminar, kanë detyrimin e frekuentimit në të gjitha aktivitetet formuese në masën 80%. Studentët në fillim të semestrit pajisen me silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e leksioneve me literaturën bazë, forma e kontrollit të dijeve si dhe literatura e rekomanduar, [Evidenca 19]</p> <p>Lëndët në këtë program studimi janë të tipologjisë II. Për këto lëndë vlerësimi përfundimtar peshohet me: 40% provimi përfundimtar i lëndës, 30% provimi i ndërmjetëm, 20% detyra e kursit, 10% niveli i diskutimit në seminare. [Evidenca 7]</p> <p>Në rregullore jepet edhe sistemi i vlerësimit sipas sistemit lokal dhe European të vlerësimit. [Evidenca 7]</p>

Pikët	Nota	Germa
96 - 100	10	A
91 - 95	10	A-
86 - 90	9	B+
81 - 85	9	B
76 - 80	8	B-
71 - 75	8	C+
66 - 70	7	C
61 - 65	7	C-
56 - 60	6	D+
51 - 55	6	D
46 - 50	5	D-
41 - 45	5	E
0 - 40	4	F

GVJ konstaton se Planet mësimore nuk jepen të ndarë sipas profileve. Planet mësimore nuk kanë të evidentuar vitin akademik përkatës dhe nuk përmbajnë firmat e personave përgjegjës për atë plan mësimor: përgjegjësi i departamentit, dekanit dhe rektorit.

Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë 7], në pikën 2 "Pranimi në programin e studimit" jepen kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në këtë program e studimit. Po ashtu dhe në pikën 9 të këtij dokumenti përcaktohet procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve. [Evidenca 7] Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL apo program të mëparshëm studimi rregullohet me dokumentin D.II. "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve". [Evidenca 28]

Në rregulloren e programit të studimit janë parashikuar si kritere në hyrje:

- Kandidati të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë
- Kandidati të njohë një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.

GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit nuk jepet fusha e edukimit ku është diplomuar studenti. Kjo është lënë e hapur, duke nënkuptuar që në këtë program studimi mund të pranohen kandidatë me formim paraprak të ciklit të parë të studimeve Bachelor në fusha studimi jo inxhinierike, të cilët nuk kanë njohuritë paraprake të nevojshme për të ndjekur këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit nuk është vendosur ndonjë kriter për të kontrolluar cilësinë në hyrje, p.sh. nota mesatare, apo konkurs pranimi.

Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

Silabuset e lëndëve, që përmban kurrikula e programit janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion mbi rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e leksioneve sipas javëve, format e kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Në silabusin e lëndës evidentohet ngarkesa në ECTS, në orë në auditor për aktivitetin formues leksion dhe seminar. Në disa sillabuse jepet ngarkesa javore. Ai tregon format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre si dhe detyrimet e studentit për lëndën.

Silabuset janë hartuar në përputhje me Shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 "Për elementët e programeve të studimit"

32

UET ka një dokument udhëzues për hartimin e programit të lëndës, Dokumentit A.III. "Parimet e ndertimit te programit te lendes", [Evidenca 39]. Në bazë të këtij dokumenti për programet e ciklit të parë, në 15% të përmbajtjes së lëndës jepen konceptet dhe njohuritë bazë, në 70% të përmbajtjes së lëndës jepen njohuri të thelluara aplikative dhe krahasuese, dhe 15% të përmbajtjes së lëndës jepen analizë/kritikë teorisë apo aplikimeve nëfushën përkatëse.

Silabuset, si rregull, miratohen përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit.

Syllabuset e çdo lënde janë të depozituara dhe mbahen nga personeli administrativ i programit apo koordinatori i departamentit si dhe vendosen për studentët në sistemin LMS (Learning Management System).

GVJ konstaton disa mangësi në lidhje me hartimin e sillabuseve të programit të studimit Msc në Inxhinieri Industriale. Format i sillabuseve i përgjigjet atij të përcaktuar në VKM 41, datë 24.01.2018, por për specifikat që kanë disiplinat në fushën inxhinjrike, është mire që në sillabus të pasqyrohen edhe elementët e tjerë të aktiviteteve formuese që janë pjesë e lëndës, si:

1. Tematikat e detyrave të kursit/projekteve të kursit,
2. Temat e punëve laboratorike, nëse ka dhe javët kur kryhen.

GVJ konstatoi mangësi në plotësimin e pjesës më të madhe të sillabuseve, si:

1. Nuk jepen të detajuara çështjet që do të trajtohen në temat e leksioneve.
2. Rezultatet e të nxënimit për lëndën nuk shprehen sipas komponentëve të tij përbërës: njohuritë që fiton studenti, aftësitë për zbatim dhe kompetencat në përfundim të lëndës.
3. Ka mospërputhje të orëve në auditor të pasqyruar në planin mësimor me orët në auditor të reflektuar në sillabus.
4. Megjithëse për disa lëndë, në planin mësimor, janë parashikuar aktivitete formuese "seminar" dhe "ushtrime/laborator", në sillabus reflektohet vetëm aktiviteti formues "Seminar"
5. Për aktivitetin formues ushtrime/laborator, në sillabus, nuk jepet asnjë informacion i detajuar.
6. Në të gjitha lëndët, janë alokuar kredite dhe orë në auditor (18-22orë) për aktivitetin formues "Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor". Në lidhje me këtë aktivitet nuk jepet asnjë informacion në sillabusin e lëndës.
7. Në përmbajtjen e disa sillabuseve konstatohen përsëritje të tematikave të dhëna në disiplina të tjera, si p.sh në lëndët "Shkencë dhe teknologji Materialesh" (cikli I) dhe "Materialet për industrinë" (cikli II); "Fizikë teknike e avancuar" (cikli II) dhe "Fizikë teknike" (cikli I); "Pajisje dhe sisteme robotike industriale" (cikli II) dhe "Mekanika Racionale" (cikli I)




33


	<p>8. Në disa silabuse ka mospërputhje të informacionit që jepet në “Përmbledhje të lëndës dhe rezultatet e të nxënit” me përmbajtjen e lëndës, si në lëndën “Pajisje dhe sisteme robotike industriale”.</p> <p>9. Përgjithësisht silabuset janë plotësuar me gabime, ka mungesa të faqe, ka tema që nuk lidhen me objektivat formuese të lëndës.</p>						
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, pika 10, parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. [Evidenca 7] Rishikimi si rregull duhet të bëhet në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p> <p>Në dokumentin E VIII “Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave”, pika 4 jepet procedura që ndiqet për hapjen, riorganizimin, mbylljen e programeve të studimit.[Evidenca 52] Në bazë të këtyre dokumentave, propozimi merr miratimin përfundimtar në Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit.</p> <p>Në vizitën e bërë në mjediset e UET, nga drejtuesi i departamentit u deklarua se për këtë program studimi nuk është bërë rishikim i planit mësimor që nga momenti i licensimit të tij.</p> <p>GVJ konstaton se Dokumenti E VIII përmban referenca ligjore të shfuqizuara (i referohet udhëzimit 31, datë 29.12.2017, i cili është zëvendësuar me Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020)</p> <p>Silabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Nga shqyrtimi që ju bë silabuseve të hedhura në sistem u konstatua se silabuset ishin të përditësuara dhe i referoheshin vitit akademik 2021-2022. Përgjithësisht ato ishin të firmosura nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe drejtuesi i departamentit, por në disa raste mungonte firma e drejtuesit të departamentit. Silabuset e disiplinave që mbulohej nga departamente të tjera përmbanin firmën e departamentit përkatës. <i>Grupi i ekspertëve sugjeron që silabuset e lëndëve, që realizohen nga njësi të tjera bazë, të kenë edhe miratimin e departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, pasi ky departament është përgjegjës për të gjithë programin e studimit Master i shkencave në Inxhinieri Industriale.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="555 1518 767 1585">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="767 1518 979 1585">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="979 1518 1192 1585">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="555 1585 767 1630"></td> <td data-bbox="767 1585 979 1630" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="979 1585 1192 1630"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga verifikimi rezulton se ngarkesa e programit mësimor është në përputhje me aktet ligjore. Programi është i ndërtuar nga 3000 orë studimi në total, nga të cilat 1219 janë orë studimi në auditor dhe 1781 janë orë studimi individual. Në kalendarin akademik, procesi mësimor gjatë një semestri zgjat 14 javë.[Evidenca 10.1-10.4]</p> <p>Mesatarisht ngarkesa vjetore është 609.5 orë në auditor ndërkohë që ngarkesa javore mesatare është 21.76 orë në javë në auditor.[Evidenca 14.2]</p> <p>Ngarkesa e programit të studimit është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga analiza që i është bërë përmbajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale” me profile: “Inxhinieri Mekanike” dhe “Inxhinieri Energjitike” “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” dhe përputhshmëria e saj me kërkesat e shprehura në VKM 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, <i>GVJ gjykon se ky program studimi me lëndët e trngut të përbashkët dhe ato të profilit “Inxhinieri Energjitike” përaftron më shumë me programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, me profil Energjitike, se sa me fushën e Inxhinierisë Industriale. Profilet e tjera, sidomos profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projekti” nuk janë në përputhje me sistemin e klasifikimit të profesioneve, të dhëna në VKM 514 dhe kjo e vështirëson hyrjen e studentëve në tregun e punës.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, i ofruar me profile, nuk ndjek strukturën e programeve të ngjashme të universiteteve të Bashkimit Europian.</i></p> <p><i>Ky program studimi nuk arrin të formojë specialistë që të punojnë në sektorët e industrisë prodhuese qofshin këto në fushën e mekanikës, të elektrikes, të impianteve kimike, etj., pasi studentët marrin shumë pak informacion të thelluar në lidhje me proceset e prodhimit, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë, automatizimin e proceseve industrial, etj.</i></p> <p><i>Emërtimi i profileve, sidomos “Inxhinieri transporti” apo “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” nuk përputhet me rezultatet e të nxënësve që përfton studentin në përfundim të tyre.</i></p> <p>Në kurrikul janë rreth 12 ECTS, të cilat japin njohuri të thelluar në drejtim të metodave të kërkimit që mund të përdoren në studime si dhe përdorimin e metodave matematikore për optimizimin e parametrevave. Këto module japin një përgatitje për kryerjen e studimeve të pavarura.</p> <p><i>GVJ gjykon se emërtimi i profilit si Inxhinieri Mekanik dhe Inxhinieri Energjitike, Inxhinieri transport nuk është korrekte dhe në përputhje me klasifikimin e fushave të edukimit sipas ISCED dhe klasifikimin kombëtar të profesioneve gjë që sjell një konfuzion në mundësitë e punësimit të tyre.</i></p>

	<p><i>Ekspertët rekomandojnë që emërtimet të jenë më afër formimit që merr studentit: Inxhinier Industrial me profil Mekanik apo Inxhinier Industrial me profil energjitike.</i></p> <p><i>Ekspertët rekomandojnë që kurrikula të rishikohet duke u orientuar drejt formimit të mirëfilltë të Inxhinierit Industrial i destinuar për sektorin prodhues.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga verifikimi i programit mësimor rezulton se, lëndët dhe modulet janë shpërndarë përgjatë 2 viteve dhe 4 semestrave në mënyrë korrekte. Në këtë formë mundësohet formimi gradual i studentëve. Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit bazë, nëpërmjet të cilave, studentët marrin njohuri të thelluar në metodat e kërkimit dhe optimizimit. Në vitin e parë studentët marrin formimin kryesor karakterizues, të përbashkët (të trungut). Në vitin e dytë studenti merr kryesisht formimin profilizues dhe zhvillon praktikën profesionale dhe punimin e diplomës.</p> <p><i>Grupi i ekspertëve konstaton se në disiplinat e trungut të përbashkët 50% e krediteve të kategorisë B i përkasin lëndëve që japin formim në fushën e energjitikës dhe vetëm 20% e tyre i përkasin fushës së teknologjisë së prodhimit. Në trungun e përbashkët nuk ka asnjë disiplinë në drejtim të formimit menaxherial, që është aq i nevojshëm për Inxhinierin e prodhimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga verifikimi rezulton se programi <i>Master i Shkencave</i> në “Inxhinieri Industriale” në profilin Inxhinieri Energjitikë ngjason më shumë me programin e studimit të Inxhinierisë Mekanike në universitetet e tjera. Duke qenë se ky program studimi jep formim për Inxhinieri Industriale, ai duhet të përafrohet më shumë me programe të të njejtit emërtim në universitete të tjera të vendeve fqinj. Universitete të vendeve të Bashkimit European ofrojnë programe studimi në Inxhinieri Industriale. Kurrikulat e këtyre programeve studimi mund të shërbejnë si një bazë krahasuese për të përmirësuar këtë program studimi dhe për të krijuar mundësinë e ndërkombëtarizimit të tij.</p> <p>Plani mësimor ka në përbërjen e tij 15 disiplina/module. [Evidenca 14, 14.2] Shpërndarja e krediteve sipas këtyre disiplinave është e njejtë me 6 ECTS.</p> <p>Disiplinat janë të grupuara sipas kategorive A, B, C, D, E, duke ruajtur raportet në përqindje të përcaktuara në VKM Nr.41, date 24.01.2018.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksione, Seminare ose leksion/seminar, Ushtrime/laborator, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor. Në të gjitha disiplinat ka aktivitete formuese teorike dhe praktike. Në këtë kurrikul shpërndarja e krediteve në aktivitetet formuese është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 37.5 ECTS • Seminare 42.4 ECTS • Ushtrime/Laboratorë 3.5 ECTS • forma të kontrollit të vazhdueshëm 24.6 ECTS • Praktikë 12 ECTS

	<p>Pra 31.25% të krediteve totale i janë alokuar përgatitjes teorike, pra leksioneve dhe 35.3% e krediteve janë të lidhura me aplikime të njohurive teorike, 23.4 % janë të lidhura me ushtrime/laboratore, detyra, projekte dhe praktika profesionale (aftësim praktik).</p> <p>Brenda lëndës kreditet e alokuara për leksion përbëjnë vetëm 41.6% të krediteve totale të lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se në silabuse nuk specifikohen kreditet/ orët e alokuara për aktivitetin Seminar dhe ato të alokuar për aktivitetin Ushtrim/Laborator. Ato trajtohen bashkë.</p> <p>Nëse do t'i referoheshim orëve të planifikuar në auditor për këto aktivitete formuese do të kishim si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione 420 Orë në auditor • Seminare 207 Orë në auditor • Ushtrime/Laboratorë 42 Orë në auditor • forma të kontrollit të vazhdueshëm 295.2 Orë në auditor • Praktikë 255 Orë në auditor • diploma 26 Orë në auditor <p>Shpërndarja e 1 ECTS në orë në auditor i përdorur për këtë program studimi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 ECTS leksion = 11 orë në auditor • 1 ECTS seminar = 7 ose 8 orë në auditor • 1 ECTS Ushtrime/laborator = 12 orë në auditor • 1 ECTS detyrë/projekt = 12 orë në auditor • 1 ECTS praktikë = 21 orë në auditor • diploma = 20 orë në auditor <p>Në hartimin e kurrikulës së programit të studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, për të gjitha lëndët janë përdorur të njëjtat raporte ECTS/orë në auditor për veprimtaritë formuese të lëndës.</p> <p>GVJ gjykon se orët në auditor që i janë alokuar aktivitetit formues "format e kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika profesionale" duhet të reflektohen dhe të detajohen në silabusin e lëndës përkatëse për të bërë transparente mënyrën se si menaxhohet ky fond orësh nga pedagogu i lëndës.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga analiza e kryer mësipër në lidhje me ndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik, rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orët në auditor, gjithsej 1219, përbëjnë 40.63% të fondit total të orëve të këtij programi studimi. • Orët jashtë auditorit (studim individual) përbëjnë 59.37% të ngarkesës totale. <p>Fondi i orëve në auditor në raport me fondin total të orëve për programet e ciklit të Dytë, Master i Shkencave, është më i vogël se 50% të ngarkesës totale (3000 orë), në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p>

Raporti teori praktikë, referuar orëve në auditor do të ishte:

- 34.45% e orëve në auditor i përkasin përgatitjes teorike (leksioneve)
- 65.55% e orëve në auditor janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu praktikën dhe punimin e diplomës.
- 16.98% të orëve në auditor i përkasin zhvillimit të seminareve
- 3.44% të orëve në auditor i përkasin zhvillimit të ushtrime/ laboratorë
- 24.22% të orëve në auditor i përkasin formave të kontrollit të vazhdueshëm, detyrave dhe praktikave lëndore të zhvilluara në auditor
- 20.92% të orëve në auditor i përkasin praktikës profesionale
- 2.13% të orëve në auditor i përkasin diplomës

Pra sasia e orëve në auditor për përgatitje praktike të studentit (seminare, ushtrime/laboratorë, detyra, praktika punim diplome janë rreth 1.9 herë më shumë se orët e alokuar për përgatitje teorike.

GVJ gjykon se fondi i orëve në auditor i alokuar për leksione nuk është mirë jetë më pak se 50% të fondit të përgjithshëm të orëve në auditor për lëndët inxhinjerie. Përfshirë në këtë rast mund të bëjnë disiplinat me karakter të mirëfilltë projektues, ku projekti është aktiviteti formues kryesor për arritjen e objektivave formuese të disiplinës përkatëse.

GVJ sugjeron që të rishikohet raporti i shpërndarjes së krediteve të lëndës sipas veprimtarive formuese

Fondi i orëve i alokuar për formimin praktik është i përshtatshëm për arritjen e objektivave formuese dhe mundëson transferimin e studimeve dhe punësimin në përfundim të studimeve.

Në planin mësimor ndarja e krediteve të lëndës sipas aktiviteteve formuese bëhet përgjithsisht njësoj për disiplinat me natyrë të njëjtë. Si aktivitete formuese janë të përcaktuara leksionet, seminarët, Ushtrime/Laboratorë, Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor. Nga verifikimi i bërë në silabuset, GVJ konstatoi se shpërndarja e orëve sipas aktiviteteve formuese në silabuse nuk përputhet me ato të planit mësimor për disa disiplina:

a) në të gjitha disiplinat janë parashikuar orë në auditor për aktivitetin formues “forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor”. Në silabuse nuk jepet asnjë informacion në lidhje me mënyrën se si organizohet ky aktivitet formues.



b) Në disa disiplina, si “Fluidodinamika”, “Impiante termoteknike për ngrohje-ftohje”, “Konstruksione Makinash”, “Materiale për Industrinë”, “Shkenca dhe Teknologjia e materialeve elektrike dhe energjiike”, shpërndarja e orëve në auditor është:

- në planin mësimor është: 28(L)/8(S)/6(U/Lab)/22(P).
- në silabuse jepen 28 orë(L) dhe 14 orë(S)

c) Në disa disiplina, ka mosperputhje midis planit mësimor dhe silabuseve për orët në auditor të aktiviteteve formuese:

38

	<ul style="list-style-type: none"> • Në lëndët “Bioteknologji”, “Pajisje dhe sisteme robotike industriale” shpërndarja e orëve në auditor sipas planit mësimor është: 28(L)/14(S). Në silabuse jepet 42 orë/klasë (30L, 20S) • Në lëndët “Mekanika e automjetit”, “Sistemet e transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror” shpërndarja e orëve në auditor sipas planit mësimor është: 28(L)/14(S). Në silabuse jepet 14(L)/28(S). • Në lëndët “Sistemet energjitike inovative dhe mbrojtja e mjedisit”, “Turbomakinat”, “Dinamika dhe aerodinamika e mjeteve të transportit” shpërndarja e krediteve dhe orëve në auditor sipas aktiviteteve formuese në planin mësimor është: 28(L)/14(S). Në silabuse jepet 28(L)/28(S). • Në silabuset e lëndëve “Kërkime Operacionale”, “Konstruksione Makinash” jepen në total orët në auditor, të pandara në orë për leksione dhe për seminare. <p>GVJ rekomandon që silabuset të rishikohen për të korrigjuar të gjitha lapsuset dhe për të reflektuar ndarjen e planifikuar të orëve dhe krediteve sipas aktiviteteve formuese</p> <p>GVJ rekomandon që në silabuse të jepet informacion i detajuar në lidhje me fondin e orëve në auditor të alokuar në aktivitetin formues “Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor”, i cili është më i madh (18-22 orë) se fondi i orëve të alokuar për seminare (max 14 orë)</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga vizita në mjediset e institucionit, takimet me drejtuesit e njësisë bazë, dhe shqyrtimi i silabuseve, konstatohet se Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga Përgjegjësi i grupit mësimor/koordinatori i programit të studimit dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. [Evidenca 39, 19]</p> <p>Përgjithësisht, programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe të rekomanduara të 10 viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe përmbajtjes së silabuseve të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale konstatohet që studentët pajisen me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; rezultatet e të nxëniet i përgjigjen nivelit të shtatë të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Evidenca 14.2, 19]</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kurrikulës dhe sylabuseve konstatohet se Programi kombinon teorinë dhe praktikën duke synuar që studenti të përvetësojë dije bashkëkohore, dhe të marrë formim bazë me njohuri në fushën e metodave të kërkimit, të cilat e përgatisin studentit për kërkime të thelluara në fushën e studimeve inxhinjerieke. Njohuritë e marra në disiplinat inxhinjerieke karakterizuese i japin studentëve formim të thelluar teorik dhe aftësi të përgjithshme praktike, në fushën e inxhinierisë Industriale kryesisht për energjitikë. Përfundimi me sukses i ciklit Master i Shkencave, u jep mundësinë studentëve për të vazhduar më tej studimet në ciklin e tretë, ose për të punuar si specialistë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. [Evidenca 14.2, 19].</p>

	GVJ gjykon se kreditet e alokuara për profilizim (18 ECTS) janë të pamjaftueshme për të formuar profilizimin përkatës.		
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UET u konstatua se Programi synon të transmetojë aftësi dhe shprehë të studentët për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, mbështetur edhe në lidhjet e krijuara me partnerët konkretë të tregut të punës të përfaqësuar në Bordin e Tregut të Punës të Departamentit, si dhe përmes programit 500+ nëpërmjet të cilave Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës merr në konsideratë mendimet, propozimet dhe konsultohet në mbledhje të posatshme me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.		
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Nga shqyrtimi i kurrikulës dhe sylabuseve konstatohet se Programi kombinon teorinë me metodat e kërkimit shkencor duke synuar që studenti të përvetësojë dije bashkëkohore, të thellojë njohuritë në drejtim të metodave të kërkimit, të realizimit të analizave, të cilat e përgatisin studentin për kërkime të thelluara në fushën e studimit dhe vijimin e aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve. Përveç kësaj në UET realizohen vazhdimisht veprimtari të formimit teorik e shkencor, duke bere te mundur aftesimin me njohuri te avancuara per studime, analiza, mbrojtje temash, thellim ne kerkime shkencor duke vijuar me ciklet te trete studimi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	X		

Standardi II.5						
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Në realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” me profile “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”. janë përfshirë personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe personel ndihmës akademik. Në tre vitet e fundit angazhimi i personelit akademik në mësimdhënje, në këtë program studimi dhe kualifikimi i tyre përkatësisht është si më poshtë: [Evidenca 02, Evidenca shtesë 01]:					
	2019-2020		2020-2021		2021-2022 (S.I)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof	2	1	1	2	1	1
Prof As	1	2	3	4	-	3
Dr.PhD	-	3	1	4	3	4

Dr proc	-	-	-	-	-	-
Msc	-	1	-	3	1	3
Totale	3	7	5	13	5	11

Në të gjitha vitet akademike raporti PAE/PAK ka qenë:

- v.a. 2019-2020 1:2.3
- v.a. 2020-2021 1:2.6
- v.a. 2021-2022 1:2.2

Pra numri i personelit akademik me kontratë ka qenë mbi 2 herë më i madh se numri i personelit efektiv.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se, gjatë gjithë periudhës së implementimit të këtij program studimi, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv në masën 32.1%-41.4%, si më poshtë. [Evidenca 02]:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2019-2020	41.4%
2020-2021	40.1%
2021-2022/sem I	32.1%

Departamenti i Inxhinierisë dhe arkitekturës mbulon 5 programe studimi (2 Bachelor, 2 Master i Shkencave dhe 1 Program të integruar). Ngarkesa në auditor e pedagogut luhet në kufijtë 80.5 deri në 381.5 ndërsa numri i lëndëve/moduleve që jep një pedagog në vit luhet nga 3 në 5. Konstatohet se si ngarkesa edhe numri i disiplinave është brenda standardeve shtetërore.

GVJ sugjeron që departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës duhet të bëjë përpjekje për të plotësuar standardin e ngarkesës mësimore në këtë program studimi (70% e ngarkesës të mbahet nga personeli akademik efektiv).

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënje në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale nga v.a.2019-2020 deri në 2021-2022 ka qenë përgjithsisht me tituj e grada.

Raporti i personelit me tituj e grada ndaj personelit me Msc ka qenë:

- v.a. 2019-2020 9:1
- v.a. 2020-2021 5:1
- v.a. 2021-2022 3:1

Numri i stafit akademik me tituj e grade shkencore, të përfshirë në mësimdhënje, në të gjitha vitet akademike, është nga 3 deri në 9 herë më i madh se ai me Msc. [Evidencat 02]

GVJ konstaton se pavarësisht në numër të vogël (nga 14.3% deri në 27.3% të numrit total), në këtë program studimi janë aktivizuar në

	<p><i>mësimdhënje personel akademik efektiv dhe me kontratë me nivel kualifikimi të njëjtë me atë të programit të studimit (Msc).</i></p> <p>Atje ku është e mundur, Personeli me gradë Msc është i angazhuar në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike, ndërsa zhvillimi i leksioneve kryhet kryesisht me personel akademik me tituj dhe gradë shkencore.</p> <p>Programet e lëndëve rishikohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Përgjegjësi i grupit mësimor është me titull Profesor i Asociuar. Silabuset e disiplinave që mbulohen nga departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës janë firmosur nga përgjegjësi përkatës i grupit mesimor.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV dhe disiplinave ku angazhohen në mësimdhënje personeli akademik, konstatohet se përgjithsisht ka përputhje të formimit teorik dhe profesional të personelit akademik me përmbajtjen e lëndës ku është angazhuar. [Evidenca 02, 20]</p> <p>Personeli akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit në fushën akademike dhe kërkimore për këtë program studimi dhe për lëndët që ata mbulojnë.</p> <p>Personeli akademik me kontratë ishte i angazhuar totalisht brenda fushës akademike të kualifikimit të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, me kompani të cilat operojnë në fushën e Industrisë mekanike dhe energjitikës. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si qëllim njohjen e tregut të punës dhe realizimin e praktikave mësimore. [Evidenca 34, 34.1-34.21]</p> <p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, për shkak të pandemisë globale Covid 19, praktika mësimore është kryer në qendrat e punës të studentit, meqenëse të gjithë studentët janë të punësuar.</p> <p>GVJ sugjeron që departamenti të sigurojë që praktikat profesionale të studentëve të zhvillohen pranë ndërmarrjeve të profilit industrial.</p> <p>Diplomimi i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri industriale bëhet nëpërmjet një punimi diplome. UET ka rregullore të detajuar për organizimin, kontrollin e punimit të diplomës deri nëmbrojtjen e tij, Dokumenti B.II. "Mbi Punimin e Diplomës dhe Dizertacionit". [Evidenca 10]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Për programin e studimit Msc në Inxhinieri Industriale parashikohen edhe orë laboratorike. Për disa disiplina, punët laboratorike kryhen pranë Kolegjit Profesional, të Tiranës (KPT), me të cilën është lidhur një Memorandum Bashkëpunimi. [Evidencë 4 Dokumentacion Shtesë] Në këtë Memorandum shprehet bashkëpunimi në realizimin e punëve laboratorike në laboratorët e KPT. Nga vizita në laboratorët e KPT, konstatuam që këto laboratorë ishin të pajisur me poste pune për studentët dhe me pajisje laboratorike të shumëllojshme, që mundësonin punë</p>




	laboratorike në fushën e mekanikës, të matjeve elektrikes, automatizimit, elektroteknikës, etj. Personeli ndihmës akademik në këto laboratore kishte kompetencën e nevojshme për realizimin e tyre. Ata kishin të përgatitur udhëzuesit e kryerjes së punëve laboratorike [Evidenca shtesë 5]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Në nivel departamenti është ngritur Bordi i Tregut të Punës, i cili do të shërbejë si një organ këshillimor për përmirësimin e programeve të studimit duke e përshtatur sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, dhe do të ndihmojë për organizimin e praktikave profesionale. [Evidenca 12.1] Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se UET ka programuar politika dhe ka përcaktuar procedura për përmirësimin e programeve të studimit, për të reflektuar zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. [Evidenca 2] GVJ konstaton se, Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale", është në vitin e tretë të implementimit të tij dhe në akreditim fillestar. Për këtë program studimi nuk është bërë rishikim dhe përmirësim. [Evidenca 52]
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se një herë në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur me studentët e programeve të studimit që mbulon, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimin të programit të studimit dhe problematikat që ata kanë. Diskutime zhvillohen gjatë mbledhjeve të hapura dhe nëpërmjet fokus grupeve të organizuara. Reflektimi i sugjerimeve të studentëve është bërë në drejtim të zgjidhjeve të problematikave të tyre për aspekte të ndryshme të procesit mësimor. Në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit, departamenti nuk ka filluar ende këtë proces.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. [Evidenca 29] Në UET është ngritur edhe shoqata ALUMNI, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme të programeve të studimit. Përfaqësues të kësaj shoqate janë përfshirë në Bordin e Tregut të Punës, të ngritur pranë departamentit të

	Inzhinierisë dhe Arkitekturës. [Evidenca 12.1] UET angazhohet në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UET, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UET. Një politikë e tillë është në qendër të Planit Strategjik 2016-2021, pjesa Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore, pika 3. [Evidenca 3; 3.3]								
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Fakulteti i Inzhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës dhe Departamenti i Inzhinierisë dhe Arkitekturës, deri tani, nuk ka organizuar programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit bazë të programit të studimit, GVJ konstaton se, në rregulloren e programit të studimit, pikën 3.3, përcaktohen qarte qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor. [Evidenca 7] Nga vizita në institucion, u theksua rëndësia e përfshirjes së studentëve në punë kërkimore, e cila realizohet kryesisht nëpërmjet punimit të detyrave dhe projekt-diplomës.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Në takimin me dekanin e fakultetit dhe përgjegjësin e departamentit, doli se Fakulteti i Inzhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Në UET zhvillohen aktivitete, p.sh. Forumet, përtej procesit mësimor, gjatë gjithë vitit akademik. [Evidenca 55.1] Të fuar në këto forume, janë personalitete të fushave të ndryshme, të cilët vijnë dhe bashkëbisedojnë me pedagogë dhe studentë. Fakulteti dhe Departamenti nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në Konferencën e Ditëve të Studimeve Shqiptare, [Evidenca 55] ku çdo department ka panelin e tij. Në takimin me personelin akademik u theksua se ata kanë liri akademike dhe behen pjese puneve kerkimore etj, duke respektuar gjithnje mesimdhënien.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në takimin me stafin akademik dhe studentët u theksua se nxitja dhe motivimi i studentëve për t'u përfshirë në studime dhe projekte kërkimore realizohet nëpërmjet disa mënyrave: nëpërmjet detyrave të kursit, duke i nxitur që ta realizojnë në terren në formën e një ministudimi, ose përfshirja e studentëve në projektet kërkimore të pedagogëve të programit të studimit. UET cdo vit, realizon Konferencën Ndërkombëtare "Ditët e

	studimit Shqiptar” dhe nxit studentët të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. Keto punime kryhen edhe nën mbikqyrjen e pedagogeve udhëheqes, të cilët kanë tituj të grada shkencore dhe janë të specializuar në ndjekjen e këtyre studimeve. Nga studentët e programit të studimit Master të Shkencave në Inxhinieri Industriale nuk ka patur raste të pjesëmarrjes së tyre në Konferencën ndërkombëtare “Ditët e studimit Shqiptar”. Kjo ka ndodhur pasi programi i studimeve është i ri dhe numri i studentëve ka qenë i kufizuar.						
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore të shkencore rajonale dhe kombëtare.	Në pikën 3 “Objektivat Strategjike” të Strategjisë së Kërkimit Shkencor, [Evidenca 3.2] nëpërmjet kërkimit shkencor institucioni synon: <ul style="list-style-type: none"> • Të arrijë dhe të konsolidojë një pozicion dinjitoz, në mësimdhënie dhe në shkencë, si një nga universitetet më të mira të Shqipërisë dhe rajonit; • Të ndihmojë në progresin e dijes njerëzore, në krijimtarinë dhe praktikën profesionale, me qëllim që të krijojë impakt mbi shoqërinë dhe ekonominë nëpërmjet transferimit të dijes përtej komunitetit akademik, tek institucionet publike e private dhe grupet e interesit; • Të perfeksionojë mësimdhënien dhe zhvillimin akademik në të gjitha nivelet, në mënyrë që studentët të përjetojnë një përvojë dhe një kulturë akademike sfiduese; • Të realizojë një mjedis stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët; • Si dhe të projektojë reputacionin e vet si një <i>qender ekspertize</i> në rrafshin kombëtar 						
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme	UET siguron financim të kërkimit duke alokuar një sasi monetare çdo vit. [Evidenca 3.2] Akademikët në UET janë të inkurajuar që të hulumtojnë dhe të publikojnë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet. Në këtë mënyrë universiteti shmang shpërdorimin e burimeve, shpërblen ata që janë më aktivë dhe produktivë në kërkim, dhe krijon një mjedis ku kërkimi është pjesë integrale e jetës universitare. Të gjitha njësitet bazë janë të mbështetura financiarisht nga institucioni i cili ofron fonde për aktivitetet studimore, kërkimore dhe shkencore. Të ardhurat që vijnë prej aktiviteteve të ndryshme administrohen nga institucioni dhe pasqyrohen në mënyrë transparente në bilanci të vitit, duke u bërë të aksesueshme nga fakultetet përkatëse.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në takimin me Dekanin dhe përgjegjës të departamentit, u theksua se kërkimit shkencor, realizohet nga njesitë bazë të Fakultetit. Projektet e mëdha kërkimore, inkurajojnë interdisiplinartetin dhe mundësojnë koordinimin shkencor. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës ka marrëveshje me institucione arsimore dhe të tjera për realizimin e punëve kërkimore shkencore, duke vënë në dispozicion të dhena dhe infrastrukturën që ato disponojnë. Është garantuar angazhimi i personelit ndihmës për realizimin e bashkëpunimeve me struktura të ndryshme kërkimore. Gjithashtu ka nisur puna për ndërtimin e ambienteve specifike të pajisura me teknologji të mirefillte për të kryer eksperimente e kërkime shkencore brenda kampusit UET.</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjës të departamentit dhe personelin akademik u theksua se anëtarët e departamentit janë të angazhuar në studime e projekte kërkimore shkencore, në të cilat aktivizojnë edhe studentët. Grupet drejtuese të PMK-ve janë një mekanizëm i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor pasi, ndër të tjera, vendosin për punimet që pranohen në DSSH dhe orientojnë kërkimin shkencor të Junior Researchers që punojnë në PMK-të përkatëse. Grupet kërkimore shërbejnë gjithashtu edhe si 'strehë' për doktorantët të cilët atashohen pranë një grupi kërkimor dhe zhvillojnë pranë tyre punimin doktoral. Grupet kërkimore, duke qenë se janë në linjë me PMK-të dhe strehojnë doktorantët. Ky organizim inkurajon kërkimin, mundëson ndërdisiplinartetin si dhe orientojnë kërkuesit drejt atyre çështjeve të cilat kanë rëndësi për UET dhe partnerët jashtë UET.</p>			
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua se UET organizon çdo vit, në muajin prill, Konferencën Ditë të Studimeve Shqiptare. Panelet organizohen mbi bazën e fakulteteve dhe Projekteve të Mëdha Kërkimore. Cdo muaj organizohen prej fakultetit konferenca, aktivitete, biseda të hapura midis studenteve dhe personelit në mënyrë që të plotësohen objektivat e vendosura në fushën e programit të studimit. Të gjitha këto mbledhen dhe afishohen në listen e aktiviteteve të cilat mund të aksesohen në çdo moment tek koordinatori i programit. Këto aktivitete duhet të shtohen në sasi dhe cilësi në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	--	------------------------------	-----------------------------------	------------------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

46




Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>UET realizon trajnime të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Nga vizita në UET u theksua se janë bërë trajnime të pedagogëve në lidhje me metodikat e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Në çdo fillim viti akademik, është realizuar aktiviteti trajnues i drejtuesëve të departamenteve në programin një javor "Back to Work" ku drejtuesit e universitetit dhe profesorë me tituj akademike kryejnë trajnimin mbi ecurinë e aktivitetit akademik dhe menaxherial të IAL. [Evidenca 33] Nga kqyrja e mjediseve, u konstatua se ato janë të pajisura me mjetet audio-vizive të nevojshme për zhvillimin e mësimin.</p> <p>Në Nëntor 2017, është nxjerrë një Urdhër administrativ Nr.9 i rektorit për zbatimin në procesin e mësimor dhe administrativ të platformës UET LMS. [Evidenca 46.1] Në vijim të kësaj janë nxjerrë guidat e nevojshme për pedagogët dhe studentët përdorimin e platformave LMS në mësimdhënje dhe guida e përdorimit të UMS në proceset administrativ. [Evidenca 46.2, 46.3, 46]</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 është realizuar trajnimi "UET 2020: mësimdhënia, cilësia, strukturimi" për pedagogët e Universitetit ku profesorë me tituj akademik trajnuan pedagogët mbi metodat e reja të mësimdhënies, inovacionit si dhe trajnim mbi përdorimin e platformës elektronike LMS. [Evidenca 33]</p> <p>Nga Mars 2020, për shkak të mbylljes prej pandemisë COVID-19, mësimi u zhvillua online përmes platformës TEAMS. Për këtë janë bërë trajnime të pedagogëve për shfrytëzimin sa më të mirë të saj nëpërmjet shpërndarjes së videove dhe guidave. Pedagogët morën pjesë në trajnimin online, aktiviteti në formë ëebinar organizuar nga Echnologinal Educational Institute of Crete, partnerë të UET. Aktiviteti konsistonte në prezantimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe sjelljes së pedagogëve kundrejt studentëve. Ky aktivitet është zhvilluar në muajin prill 2020. [Evidenca 33, 46.4]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga vizita në UET dhe shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se në UET kryhet monitorim sistematik i stafit duke përdorur mekanizma të ndryshme. Të gjitha mjediset e mësimdhënjes ishin të pajisur me kamera monitorimi.</p> <p>Në "UET " janë ngritur dhe funksionojnë strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe kontrollit të cilësisë, si: KSBC, Komisioni i Vlerësimit të Performancës, si dhe strukturat akademike Përgjegjëse departamenti dhe dekanat [Evidenca 5]</p> <p>Në Rregulloren e UET theksohet se cilësia në mësimdhënje vlerësohet nëpërmjet disa mekanizmave të monitorimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani,


	<p>Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatin e tyre, vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; • vetëvlerësimi; • rezultatet e raporteve të KSBC-së; • vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (folloë-up). • Zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara. [Evidenca 5] <p>Vlerësimi i procesit të mësimdhënies realizohet, në mënyrë periodike gjatë dhe në fund të semestrit. Procesi i vlerësimit realizohet nëpërmjet pyetësorëve që ruajnë anonimatin e studentëve, fokus grupet, ndjekja e mësimdhënies në auditor nga drejtuesi i departamentit ose një profesor i fushës, etj, për të gjitha lëndët dhe të gjithë personelin akademik. [Evidenca 30.8, 40, 41]</p> <p><i>GVJ konstaton se evidencat referuar këtij kriteri (evidencë 30.8, 40 dhe 41) janë formate që mund të përdoren për vlerësimin periodik të cilësisë në mësimdhënie nga ana e pedagogut. Ekspertet gjykojnë se në këtë kriter duhet të jepet informacioni se si e ka zbatuar departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës këtë mekanizëm vlerësimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në rregulloren e UET theksohet përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të procesit mësimor dhe kjo garantohej nga KSBC e UET_it. [Evidenca 5] Për realizimin e kësaj përdoren pyetësorë dhe formularë të ndryshëm, mbledhje të hapura e deri të focus grupet. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e performancës së anëtarëve të personelit akademik, jo vetëm në kuadër të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të aspekteve të sjelljes, komunikimit, mbështetjes së studentëve, cilësisë së literaturës së përzgjedhur, etj., është një nga komponentët me të rëndësishëm për të evidentuar dhe adresuar problemet e mundshme. [Evidenca 40] Nga takimi me studentët, UET organizon takime periodike në formën e “fokus grupeve” si dhe pyetësorë problemeve specifike, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë, mbi format e metodave të mësimdhënies dhe çdo pedagog. Nga takimi me drejtuesin e departamentit, doli se studentët kanë të drejtë të shprehin ankesat dhe sugjerimet e tyre në mbledhjet e hapura të departamentit, që zhvillohen një herë në muaj, pranë Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, apo edhe me kërkesë drejtuar Përgjegjësit të departamentit ose Sekretarit të Përgjithshëm. Sa i përket ankesave individuale për vlerësimin e marrë në kuadër të lëndëve të zhvilluara, studenti i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit, mbështetur në nenin 32 të Rregullores së UET. [Evidenca 5]</p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesin e KSBC dhe Përgjegjësin e departamentit rezultoi se rezultatet e vlerësimit bëhen publike në momentin e përshtatshëm për stafin pedagogjik, duke u siguruar në këtë mënyrë që këto rezultate të mos ndikojnë në objektivitetin e kryerjes së detyrës prej pedagogut. Rezultatet e vlerësimit pasi përpunohen nga KSBC, apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve on-line i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Nga vizita në Institucion, në takimin me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit u theksua se rastet e vlerësimeve pozitive bëhen shembuj për t'u ndjekur nga anëtarët e tjerë të stafit.</p> <p>Të dhënat e përfuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës, por edhe për identifikimin e problematikave.</p> <p>Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme</p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Industriale" bazohet në formën standarte të mësimdhënies. Transmetimi i dijeve jepet nëpërmjet, Leksioneve, seminare, leksion/seminare, Ushtrime/Laboratorë, Detyrave të kursit dhe praktikave profesionale. Vlerësimi përfundimtar bëhet nëpërmjet punimit të diplomës. [Evidenca 14.2, 19]</p> <p>Për këtë program mësimor, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së inxhinierise elektrike apo inxhinierise mekanike, për të ndarë eksperiencat e tyre me studentët. [Evidenca 33]</p> <p>Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e</p>	<p>Nga vizita në institucion u verifikua se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët kanë ofruar metoda dhe mundësi alternative (nëpërmjet konkretizimit me shembuj praktik, etj) në mënyrë që studenti të risë interesin dhe dëshirën e të nxënësit. Përdorimin e sistemeve kompjuterike është një praktikë normale në mbarëvajtjen e mësimdhënies. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe</p>

<p>programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>studentëve, u sollën shembuj të ofrimit nga ana e pedagogëve të metodave të ndryshme për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin.</p> <p>Nga feedback-u i marrë nga studentët, u verifikua që personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim, projekte në grup, mjete audio-vizive etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni mbështet përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible për zhvillimin e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e rezultateve të të nxënit. Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kushteve të mësimdhënies.</p> <p>Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET lidhet me trajnimin e pedagogëve. Institucioni siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Universiteti organizon në mënyrë periodike “Staff Development Day” – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. [Evidenca 43].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit (dosjet e personelit akademik si dhe CV e tyre) themi se përgjithsisht personeli akademik i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, është kompetent për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve bazë për disiplinat ku është i angazhuar, dhe ofron një mësimdhënie cilësore. Këtë e demonstruan edhe studentët në takimin që patëm me ta.</p> <p>Nga vizita nëpër laboratorët e KPT, që përdoren për kryerjen e punëve laboratorike, në disa disiplina, u konstatua një gërshetim mjaft i mirë i leksioneve me ushtrimet që zhvillohen nëpërmjet laboratorit. Kjo është një formë e mire për ndërthurjen e njohurive teorike me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimentimeve në laboratorë [Evidencë 5, Dokumenta shtese]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë stafi akademik dhe departamenti që mbulon programin mësimor në fjalë. Vëmendje e veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vijnë nga vetë studentët, me të cilët zhvillohen në mënyrë periodike fokus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen në lidhje me mësimdhënien, për rritjen e nivelit të mësimnxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve.</p> <p>Përveç fokus grupeve, studentët vlerësojnë mësimdhënien në sistemin LMS.</p>

	Departamenti organizon një herë në muaj mbledhje të hapur për studentët e programeve që administrojnë duke dëgjuar sugjerimet dhe problematikat e tyre në lidhje me procesin mësimor. Në takimin me Dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, u theksua rëndësia e këtij procesi dhe masat që merren për përmirësimin e situatës.		
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Nga biseda me personelin akademik dhe me studentët u verifikua se gjatë orëve të seminarëve dhe leksioneve vihen në përdorim një numër i madh shembujsh reale në mënyrë që ora mësimore të bëhet sa më tërheqëse dhe të nxitet diskutimi në lidhje me tematikën në fjalë. Personeli akademik synon në aktivizimin gjithnjë e më shumë të studentit në mësimdhënje. Diskutimet në orën e mësimin, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që përdoren për realizimin e këtij ndërveprimi dhe angazhimit të studentëve.		
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Në takimin me personelin akademik dhe studentet, u evidentua rëndësia e nxitjes së sensit të autonomisë dhe mendimit kritik të studentëve. Nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxëniet jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. Pedagogët nxisin realizimin e detyrave nga ana e studentëve, gjatë orëve të seminarit, si një mënyrë për të nxitur punën e pavarur dhe përfshirjen më të madhe të tyre në procesin e mësimdhënies. [Takimi me pedagogët] Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve gjatë orëve të seminarit, u jepen detyra që duhet t'i realizojnë në grup. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe nxit përmirësimin e aftësive të punës në grup. [Evidenca 19]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita në institucion rezultoi se Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës e zhvillon aktivitetin e tij në godinat e vendosura në adresën Rruga Xhanfize Keko, Nr.56, në Tiranë. Në këtë vendndodhje, UET ka në dispozicion dy godina, sipërfaqja totale e të cilave është rreth 7,545 m ² . Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m ² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m ² dhe 353 vende. [Evidenca 42.1]

	<p>Mjediset ku zhvillohet mësimdhënja menaxhohen në nivel universiteti, për të gjitha programet e mësimi. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillohen pasdite.</p> <p>Sallat dhe mjediset e tjera ishin të mirëmbajtura dhe plotësonin kushtet e zhvillimit normal të mësimi.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>UET ka vënë në dispozicion të programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” salla leksionesh dhe salla seminaresh, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Labororet janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Labororët e informatikës/statistikës janë pajisur me softçare-t përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Sistemi i operimit është në të gjithë kompjuterat windows 7; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë.</p> <p>Labororët KPT, të nënkontraktuar, gjendeshin në njerën nga godinat ku zhvillohej mësimi për programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale”. Ato ishin të plotë, me pajisje të reja laboratorike, të siguruar gjatë pesë viteve të fundit. [Evidenca 42.1, Vizita në UET]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Mirëmbajtja dhe përditësimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe përditësimet e tyre bëhen në kohë reale. Në kompjuterat që përdoren në mesimdhënje janë instaluar programe aplikative sipas kërkesave të departamenteve në funksion të programeve të studimit.</p> <p>Të gjitha klasat janë të pajisura me internet. UET ka investuar në sisteme, që mbështesin studentin në procesin mësimor. Ata përdorin gjerësisht platformën MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive etj. [Evidenca 46.1, 46.2, 46.3, takimi me studentët dhe personelin akademik]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Në çdo syllabus të hartuar, vendoset literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Literatura e përdorur bën të mundur që studentët të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura bazë është përgjithsisht në gjuhën shqipe, ndërsa ajo e rekomanduar gjendet në gjuhë të huaj (gjuhën angleze ose italiane). [Evidencë 19, takimi me studentët]</p> <p>Literatura bazë i vihet në dispozicion studentëve, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Tekstet bazë janë botime kryesisht të shtëpive botuese shqiptare, me autorë specialistë të nënfushave përkatëse, të kategorisë së profesorëve. Tekstet e rekomanduara në gjuhë të huaj, janë botime kryesisht të 10 viteve të fundit. Në ndonjë rast, në mungesë të teksteve të përditësuar në gjuhën shqipe, në fushat Inxhinierike, studentëve ju ofrohen leksione të shkruara të përgatitur nga pedagogu i lëndës si dhe literature ndihmëse në gjuhë të huaj. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online) [Evidenca 42.1]</p>

<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me rreth 450 tituj librash e teksteve në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj në fushat e shkencave të natyrës (matematikë, fizikë, kimi), shkencave ekzakte, arkitekturës dhe inxhinierisë, nga të cilat rreth 250 tituj janë në fushat e inxhinierisë. Botimet janë relativisht të vjetra. Rreth 90 tituj janë botime pas vitit 2000. [Evidencë 45] Këto botime mbështesin jo plotësisht zhvillimin e programit të studimit dhe mund të përdoren nga studentët.</p> <p>Nga shqyrtimi i literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar në silabuset e lendeve, konstatohet që përgjithsisht kjo literature nuk gjendet në bibliotekë. Literatura e rekomanduar nga pedagogët, sidomos ajo në gjuhë të huaj, është pjesë e bibliotekës personale të pedagogut. Departamenti duhet të gjejë format që literatura bazë dhe ajo e rekomanduar në silabuset e lendeve të jete e aksesueshme për studentet.</p> <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00- 17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur. [Vizita në UET]</p> <p>Rekomandohet që të pasurohet biblioteka me botime të viteve të fundit në fushat inxhinjerike.</p>												
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Një burim tjetër për përdorimin e teksteve dhe librave ndihmës në procesin mësimor është edhe shfrytëzimi i librarive elektronike ose burimeve on-line të rekomanduara nga pedagogët.</p> <p>UET ka siguruar aksesin në disa librari on-line për personelin akademik dhe studentët, duke e rritur kështu potencialin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. [Evidenca 2, tabela 17]</p> <table border="1" data-bbox="592 1216 1353 1518"> <thead> <tr> <th>Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka online.</th> <th>Emërtimi</th> <th>Kohëzgjatja e kontratës aktuale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Platformat on-line</td> <td>1. Learning Management System (UET LMS) 2. Microsoft TEAMS</td> <td>Pa limit</td> </tr> <tr> <td>Biblioteka online</td> <td>1. Sage&EBSCO 2. Questia 3. ASTM Compass 4. Edward Elgar Publishing – Elgar Online Platform</td> <td>1. 5 vjet 2. 5 vjet 3. Pa limit 4. Pa limit</td> </tr> <tr> <td>Struktura e teknologjisë së informacionit që menaxhon IAL.</td> <td>University Management System (UET UMS)</td> <td>Pa limit</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga vizita në bibliotekën e UET, u theksua se Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage.</p> <p>Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p>	Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka online.	Emërtimi	Kohëzgjatja e kontratës aktuale	Platformat on-line	1. Learning Management System (UET LMS) 2. Microsoft TEAMS	Pa limit	Biblioteka online	1. Sage&EBSCO 2. Questia 3. ASTM Compass 4. Edward Elgar Publishing – Elgar Online Platform	1. 5 vjet 2. 5 vjet 3. Pa limit 4. Pa limit	Struktura e teknologjisë së informacionit që menaxhon IAL.	University Management System (UET UMS)	Pa limit
Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka online.	Emërtimi	Kohëzgjatja e kontratës aktuale											
Platformat on-line	1. Learning Management System (UET LMS) 2. Microsoft TEAMS	Pa limit											
Biblioteka online	1. Sage&EBSCO 2. Questia 3. ASTM Compass 4. Edward Elgar Publishing – Elgar Online Platform	1. 5 vjet 2. 5 vjet 3. Pa limit 4. Pa limit											
Struktura e teknologjisë së informacionit që menaxhon IAL.	University Management System (UET UMS)	Pa limit											

<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET ka në përdorim laboratorë mësimorë Informatike, të cilat janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat janë të përshtatshme në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që i përdorin ato sikurse dhe janë të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. (nga vizita në UET)</p> <p>Në takimin me studentët u theksua se ata kanë akses të vazhdueshëm në infrastrukturën e UET për të realizuar detyra të ndryshme të tyre gjatë programit të studimit. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Ëi-Fi.</p> <p>Studentët e Inxhinierisë Industriale mund të përdorin edhe laboratorët e KPT për realizimin e detyrave ose projekt-diplomave, mbi bazën e Memorandumit të bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve. [Evidencë shtesë 4, 5]</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Referuar vizitës në UET dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet që në UET përdoret sistemi MOODLE (UET LMS) në mbështetje të procesit mësimor. Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Nëpërmjet këtij sistemi, studenti ka mundësi të komunikojë në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet [Evidenca 46.1]</p> <p>Personeli akademik ka përdorur rregullisht e-learning sidomos në periudhën e pandemisë, ku zhvillimi i mësimit u bë online. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platformën UET LMS dhe Microsoft Teams. [Evidencë 5.1] Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, ëëblink-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj.</p> <p>Zyra e IT në UET ka kryer dhe trajnime mbi përdorimin e platformave online Microsoft Teams dhe LMS në procesin mësimor [Evidenca 46, 46.2, 46.3, 46.4, 46.5]</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Sistemet e komunikimit të brendshëm bëjnë të mundur që personeli akademik dhe studentët të përdorin dokumentacionin elektronik. Nëpërmjet Intranet bëhet komunikimi dhe dhënja informacionit të nevojshëm për realizimin e proceseve akademike si programet e lëndëve dhe dokumentacioni që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, legjislacionin përkatës, urdhërat e Rektoratit të UET-it, etj.</p> <p>Përmes UET LMS pedagogët dhe studentët shkëmbejnë materiale, njoftime dhe çdo informacion që lidhet me lëndët. Studenti ka akses tek materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj, ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe studentët e tjerë; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit theksohet se vlerësim i final i studentëve bëhet me mbrojtje të temës së diplomës. Në rregulloren e programit të studimit, [Evidenca 7], si dhe në dokumentin B.II, pjesë e Broshurës së dokumenteve, [Evidenca 10] jepen në mënyrë të detajuar i gjithë procesi nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrotja e temës. Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit, u theksua se procesi i punimit të temës së diplomës, i cili aplikohet në ciklin e dytë, ishte shumë i detajuar dhe bëhej në përputhje me dokumentin B. II. [Evidenca 10] Përpara se studenti të bëjë aplikimin për temë diplome, Departamenti i vë në dispozicion ekspertizën e anëtarëve të personelit akademik, me drejtimet ku ata mund të udhëheqin tema. Pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit të temës, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësim të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. [Evidenca 30.1] Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit. Në planin e vitit akademik 2021-2022, ndërmjet të tjerave, janë parashikuar aktivitete në lidhje me vlerësimin e silabuseve, organizimi i pyetësoreve të studentëve online dhe në focus grup, vlerësimi i rishikimit të kurrikulave, ndjekje të të detyrave të lëna nga analiza e stafit akademik, etj. [Evidenca 30.1]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” mbështetet nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, i cili është njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi të studimit. Në dokumentin F.V përcaktohet përgjegjësia e departamentit për sigurimin e cilësisë në mësimdhënje për programet e studimit që mbulon. [Evidencë 6] Departamenti punon në mënyrë të vazhduar në drejtim të përmbushjes së standardeve të cilësisë në mësimdhënie, si dhe nxitjen e vetëdijes mbi</p>

	<p>rëndësinë e tyre tek stafi akademik dhe tek studentët. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me standardet e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimit nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, ose në cdo kohë.</p>
	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka bënë analiza periodike vjetore mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale [Evidenca 38].</p> <p><i>GVJ rekomandon që departamenti të synojë në rritjen e efektivitetit të mekanizmave të vendosura për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, duke përmirësuar planin mësimor dhe silabuset e lëndëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies inkurajohet edhe në kuadrin e departamentit, por edhe prej dekanatit dhe rektoratit. Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit u konstatua se IAL përmes strukturave përkatëse si: Komisioni e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrrës së Kurrikulave mbështet njësinë bazë dhe stafin akademik në zhvillimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie. Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë për çdo temë metoda pedagogjike që do të përdoret në mësimdhënie. [Evidenca 19].</p> <p><i>GVJ konstaton se në pjesën më të madhe të silabuseve, të kqyrura nga ekspertët, nuk përshkruhen metodat pedagogjike, që do të përdor pedagogu në trajtimin e temës së leksionit, por jepet vetëm një fjali ushtrime në lidhje me çështjen.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik, i përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale është përgjithsisht me kualifikimet e kategorisë së profesorëve dhe atë të lektorëve. Në UET ka plan strategjik për kërkimin shkencor, në të cilën përveç objektivave strategjike për zhvillimin e kërkimit në UET, nëpërmjet strukturimit të kërkimit shkencor, zhvillimit të projekteve kërkimore, revistave dhe botimeve shkencore, organizimit të konferencave, por edhe organizimit të trajnimeve dhe certifikimeve. [Evidenca 3.2].</p> <p>Në <i>Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit</i> ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë në katër drejtime: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike. [Evidenca 3.2].</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	<p>Nga vizita në institucion, në takimin me përgjegjësin e departamentit dhe personelin akademik u theksua se trajnimet e personelit akademik për çështje didaktike dhe metodave të mësimdhënies kanë qenë periodike dhe të vazhdueshme. Këto trajnime janë realizuar përmes:</p>

<p>mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>a. Periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1. [Evidenca 43].</p> <p>b. Trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera). [Evidenca 46.4].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me personelin akademik, rezultoi se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik i përfshirë në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” ka një angazhim të plotë për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Sipas stafit qëllimi kryesor përkon me nxitjen e mësimnxënies tek studentët dhe përgatitjen e tyre sipas kërkesave të tregut të punës. Përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Departamenti ka konstatuar se përvetësimi dhe shfrytëzimi i metodave të reja në mësimdhënie janë përqafuar lehtësisht nga pedagogët e rinj, ndërkohë që janë përdorur më pak nga brezi i pedagogëve me më shumë përvojë. Megjithatë, në kushtet e krijuara nga situata pandemike Covid-19, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020, dhe gjatë vitit akademik 2020-2021, pa përjashtim i gjithë stafi akademik u angazhua në mësimdhënie online në platformat e-learning.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion, personeli akademik është i motivuar të testojë metoda të reja mësimdhënieje. Personeli akademik ka mundësi të reflektojë çdo vit përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme në silabuset e lëndëve. Nëse gjatë punës së tyre ata vënë re se një eksperiencë e re është efektive, raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga kolegët e tjerë. [Nga takimi me përgjegjësin e departamentit] Gjatë trajnimeve të ndryshme të personelit akademik, stafi është i lirë të sugjerojë metodat që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Nga vizita në UET, në takimin me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, u theksua angazhimi herë pas herë i partnerëve si lektorë dhe kërkues shkencorë për të shkëmbyer ide dhe metoda. Departamenti ka angazhuar lektorëve të ftuar, për të zhvilluar leksione të hapura me temë: “Mundësitë dhe avantazhet e përdorimit të gazit të TAP dhe gazit të lëngshëm në Shqipëri”, “Planet Urbane të trafikut”, “Robotika: Mundësitë dhe ndikimi socioekonomik”, “Standardet angleze të ndriçimit dhe sistemet antizjarr”, etj [Evidenca 33]</p> <p>Këto tema janë të vlefshme për studentët e ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale. Shembujt nga jeta reale dhe analiza e ekspertëve bën që temat të jenë më të prekshme për studentët dhe të përvetësohen më lehtë. Gjithashtu UET zhvillon vazhdimisht seminare dhe trajnime me qëllim që anëtarët e personelit jo vetëm të zhvillohen më tej, por edhe të mund të shkëmbejnë përvojën e tyre me kolegët. Disa nga aktivitetet e zhvilluara kanë qënë: “Si të jemi lektorë të suksesshëm” (Janar 2016); “Hoë to publish and research” (Qershor 2017); “UET Research” (Gusht 2018) [Evidenca 55.1]</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i rregullores së UET dhe dokumentacionit të paraqitur në sistem, konstatohet se në UET funksionon një rregullore e posaçme për kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, e cila është e bërë publike për studentët. [Evidenca 7.4] Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen edhe në rregulloren e programit të studimit, si dhe për çdo disiplinë jepen në silabusin përkatës. [Evidenca 7, 19] Nga takimi me studentët dhe zyrën e karrierës, rezultoi se kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lëndë/moduli, studentët njihen me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit, të prezantuar nga pedagogu lëndës. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në çdo syllabus është seksioni “ <i>Kontrolli i Vazhdueshëm</i> ”, ku në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohet dhe vlerësimi i studentëve. [Evidenca 19] Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatoreja e departamentit. Në takimin me studentët rezultoi se studentët në këtë pike ishin mjaft mire të informuar.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të UET në lidhje me metodologjinë e vlerësimit, konstatohet se vlerësimi përbëhet nga tre komponentë: a. performanca e studentit gjatë vitit, duke nxitur studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; b. merr në konsideratë të gjithë komponentët e aktiviteteve që kryhen për këtë lëndë: si detyra, projekte, laboratorë, etj, duke i dhënë secilit prej këtyre komponentëve një peshë të caktuar; c. Nëpërmjet kontrolleve të ndërmjetme bëhet e mundur të vlerësohet ecuria e studentit gjatë vitit dhe vështirësitë që ai mund të has. Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, citohet se të gjitha disiplinat e këtij programi studimi janë të Tipologjisë II. Kjo tipologji përdoret për lëndë që kanë aktivitete formuese laboratorë dhe detyra, pesha e të cilave nuk është mbizotëruese. Për këto disiplina vlerësimi përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> • 40% provimi përfundimtar

	<ul style="list-style-type: none"> • 30% provim i ndërmjetëm, • 20% detyra, laboratori • 10% niveli i diskutimeve në seminare <p>Forma e vlerësimit jepet në silabuset e lëndëve. Studentët ishin të mirë informuar në lidhje me këtë. [Evidenca 7, 19; takimet me personelin akademik dhe studentët]</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, si: rregullorja e UET, Rregullorja e programit të studimit, Dokumenti A. IV Sistemi i Vlerësimit të Studentëve, Silabuset e lëndëve , dhe kalendari akademik, rezultojnë se vlerësimi i studentëve mbështetet në kontrollin e vazhdueshëm, gjatë gjithë semestrit. Në të gjithë këto dokumenta jepen format e kontrollit që përdoren për tipologjinë e lëndës dhe periudhat se kur kryhen kontrollet e ndërmjetme. Në kalendarin akademik në periudhën 25 Prill – 30 Prill 2022 parashikoheshin kontrollet e ndërmjetme. [Evidenca 5, 7, 7.2, 19, 10.1-10.4; takimet me personelin akademik dhe studentët]</p> <p>Gjatë gjithë vitit akademik kryhen testime dhe vlerësime të njohurive, dijeve dhe aftësive, të cilat reflektohen në vlerësimin përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi i ndërmjetëm • Niveli i diskutimit në seminare • Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike • Provimi përfundimtar. <p>Pesha që ze secili prej elementëve të aktiviteteve formuese është spjeguar në Standardin III.5, kriteri 3.</p> <p>Vlerësimet gjatë vitit për studentët dokumentoheshin në procesverbalet e vlerësimit dhe ruheshin në sekretarinë mesimore, sëbashku me fletën e provimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe trisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion doli se format e realizimit të provimit mbeten ato klasiket. UET ka krijuar standard për mënyrën e hartimit të tezës, duke gërrshetur pyetje me alternative, pyetje me natyrë analitike dhe pyetje për kontroll njohurish. [Evidenca 7.3]</p> <p>Në takimin me personelin akademik dhe përgjegjës të departamentit, u theksua se ka filluar të përdoret në një fare mase sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit, në ato raste kur ka qenë e mundur. Institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation)</p>

	po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: "clean scoring". Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme të ciklit të parë dhe të dytë.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga vizita në institucion rezultoi se vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, në bazë të rregullores së UET dhe rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, është në gjykimin e titullarit nëse korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. [Evidenca 5, 7]</p> <p>Në takimin me përgjegjës të departamentit, u sqarua se pedagogu përgjegjës i lëndës ka përgjegjësinë e hartimit të tezës, mbështetur në standardet e vendosura për strukturën e tezës, dhe të miratimit të saj tek përgjegjësi i grupit mësimor përkatës. Në përfundim të provimit pedagogu dorëzon tek koordinatori i departamentit tezën origjinale dhe çelësi i zgjidhjes. Pedagogu shënon në fletën e provimit të studentit pikët për secilën pyetje. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. [Evidenca 5, 7]</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Në vizitën në UET, grupi i ekspertëve u informua për mënyrën e zhvillimit të provimeve. Provimet e studentëve sekretohen dhe UET ka siguruar gjithmonë infrastrukturën e nevojshme për këtë gjë, duke i pajisur sallat e provimeve me personel të posaçëm monitorues. Në bazë të Rregullores së programit të studimit dhe Dokumentit E.I mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. [Evidenca 5, 7] Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit. [Evidenca 7.2]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me personelin akademik dhe studentet u theksua se, vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente dhe sqarime për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Në tezat e provimeve është seksioni "Komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit për pyetjen e kategorisë C "Mbaj qëndrimin tënd" ku pedagogu jep feedback mbi zhvillimin e pyetjes nga studentit. Në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korrigjimin e pedagogut dhe të marrin komente të detajuara mbi vlerësimin e bërë. [Evidenca 7.3]
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk	Në dokumentin A.IV "Sistemi i vlerësimit të studentëve" dhe në takimin me personelin akademik dhe përgjegjës të departamentit theksohet se zhvillimi i provimit të ndërmjetëm ose përfundimtar bëhet në salla me

<p>tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>kapacitet sa dyfishi i numrit të studentëve, e cila monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, të caktuar nga përgjegjësi i Departamentit, të cilët janë përgjegjës për ecurinë e provimit në sallë. Pedagogët nuk lejojnë kopjimin nga ana e studentëve.</p> <p>Studentët nuk mbajnë çantat apo materialet mësimore, që lidhen me lëndën përkatëse, në bankat ku janë ulur. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohej përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi.</p> <p>Në silabuset e lëndës jepen elementë të kodit të Etikës në lidhje me kopjimin ose plagjiaturën, të cilat janë të dënueshme për studentin. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. [Evidenca 5, 19]</p> <p>Gjithashtu, UET që prej vitit 2015, implementon sistemin antiplagjiature (<i>Turnitin Ephorus</i>), në mënyrë që punimet e diplomave të studentëve të mund të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas, për plagjiaturë përpara se të marrin vlerësimin final nga pedagogët, apo komisionet e vlerësimit përkatës.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga rregullorja e programit të studimit, rregullorja e UET dhe dokumenti A.IV “Sistemi i Vlerësimit të studentëve” rezulton se provimi është i sekretuar; vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit (vendosen pikët për secilën pyetje dhe më pas mblidhen), e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. [Evidenca 5]</p> <p>Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. [Takimi me përgjegjësin e departamentit]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rregulloren e UET, Rregulloren e programit të studimit, Dokumentin A.IV “Sistemi i Vlerësimit të studentëve” theksohet e drejta e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikimin e tij. [Evidenca 5, 7, 7.2] Kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët. Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (<i>LMS dhe UMIS</i>). Brenda dy javëve nga realizimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. [Evidenca 7] Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente</p>	<p>Nga takimi me përgjegjësin e departamentit rezultoi se kërkesat dhe ankime të studentëve në lidhje me vlerësimin shqyrtohen nga një komision vlerësimi që ngrihet në departament, duke përfshirë pedagogë kompetentë për të gjykuar çështjen, pasi fusha e tyre e ekspertizës konsiderohet e njëjtë ose e afërt me atë që është subjekt vlerësimi.</p>

për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Procedura zhvillohet në mënyrë transparente, dokumentohet dhe arkivohet. Kjo procedurë jepet në rregulloren e programit të studimit. Studenti mund t'i drejtohet përgjegjësit të departamentit me një kërkesë për rivlerësim pasi të ketë bërë seancat sqaruese me pedagogun e lëndës. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. [Evidenca 7] Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale” me profile, “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” synon ta pajisë studentin me njohuri dhe koncepte të thelluara të fushës. Plani mësimor i këtij programi studimi është i strukturuar në dy vite akademike. Në kurrikulën e programit të studimit studentit i ofrohen njohuri mbi metodat dhe metodologjike për kërkime operationale (12 ECTS), nëpërmjet të cilave studenti merr një formim të thelluar për kryerjen e kërkimeve shkencore. Lëndët karakterizuese (60 ECTS), japin përgjithsisht njohuri të thelluara, të ngritura mbi ato të ciklit të parë. Lëndët profilizuese (18 ECTS) bëjnë diferencën në profilet e këtij programi studimi. Kurrikula parashikon 12 ECTS për praktikën profesionale, gjatë të cilës studenti zhvillon aftësitëe tij praktike në fushën e studimit dhe përgatitet për tregun e punës. [Evidenca 14.2]</p> <p>Në të gjitha disiplinat ndërthurret formimin teorik me element praktikë, si ushtime, laboratorë dhe detyra, që shërbejnë për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve.</p> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, student mund të vijojë rrugëtimin e tij drejt tregut të punës apo thellimit të mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë.</p> <p><i>GVJ konstaton se në kurrikul janë parashikuar disiplina, të cilat nuk janë pjesë e formimit të Inxhinierisë Industriale dhe studenti nuk ka njohuri paraprake të nevojshme për të nxënurit e asaj lënde, si Bioteknologji, “Shkenca dhe teknologjia e materialeve elektrike dhe energjitike”, “Mekatronikë”.</i></p>

	<i>GVJ konstaton se në disiplinat “Materialet për Industrinë” dhe “Pajisje dhe sisteme robotike industriale” ka përkatësisht përsëritje të temave të zhvilluara në ciklin e parë apo ripërsëritje të temave në kapitujt e lëndës.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky programi studimi synon të përgatisë studentit nga ana metodologjike për të kryer kërkime të pavarura dhe për përpunimin e rezultateve. Për këtë, në Kategorinë A janë përfshirë lëndët “Metoda kërkimi të avancuara” dhe “Kërkime Operacionale”, me 12 ECTS gjithsej. Në disa disiplina njohuritë në fushën e teknologjisë së informacionit janë të integruara me përmbajtjen e lëndës, duke i dhënë studentit aftësim për zbatime në praktike të njohurime informatike. [Evidenca 14, 14.2]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Pedagogët e përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi verifikojnë kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të lëndës mësimore, nëpërmjet kontrollit të detyrave të kursit, që realizohen në javën e 13-të, punëve të laboratorit të cilat dorëzohen nga studentët gjatë semestrit, si dhe kontrolleve të ndërmjetme. Në vizitën në institucion u evidentua se pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Analiza e realizimit të objektivave formuese të këtij programi studimi bëhet nga departamenti, ku marrin pjesë edhe student. [Evidenca 38]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga vizita në institucion u verifikua se: studentët orientohen para testimeve të pjesshme dhe përfundimtare, në mënyrë që të fokusohen te çështjet më të rëndësishme të lëndës. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të cilat do t’u nevojiten studentëve. Pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion u verifikua se, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka organizuar takime informuese me biznesin si dhe leksione të hapura, ku janë ftuar specialistë të inxhinierisë dhe studentët janë njohur me aplikimet më të fundit. [Evidencë 33]. Gjatë periudhës 2020-2022, personeli akademik i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës kanë marrë pjesë në disa leksione të hapura, të organizuara nga klubet studentore, Disa prej leksioneve të hapura, të lidhura me fushën e Inxhinierisë Industriale, kanë qenë: <ul style="list-style-type: none"> • Robotika: mundësitë dhe ndikimi socioekonomik • Planet urbane të trafikut, • Mundësitë dhe avantazhet e përdorimit të gazit të TAP dhe gazit të lëngshëm të USA në Shqipëri • Standardet Angleze të ndriçimit dhe sistemet antizjarr, etj [Evidencë 33].
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në	Bazuar në kurrikulën e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” mund të themi se ajo është hartuar në mënyrë të tillë që tu japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë

laboratorë dhe praktikat profesionale.	dhe në praktika profesionale. Temat laboratorike janë në përputhje me temat e leksioneve dhe seminarëve. Me qëllim arritjen e objektivave të mësimdhënies mbi bazë kompetencash, dhe zhvillimin e orëve mësimore në laboratorë, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe harton raport periodik për përfitimet e tyre. [Evidencë 34, 35]. Zhvillimi i praktikave profesionale, për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, bëhet përgjithsisht pranë qendrave të tyre të punës. GVJ sugjeron që të shtohen memorandumet e bashkëpunimit dhe të shfrytëzohen maksimalisht për zhvillimin e praktikave profesionale, por edhe më tej, duke qënë se dhe numri i studentëve sa vjen dhe rritet.		
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Nga takimi me personelin akademik dhe studentët rezultoi se personeli akademik, nxit bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën në grup të tyre. Detyrat e kursit, që studentët i prezantojnë gjatë orëve të seminarit, pedagogët lejojnë që studentët t'i zhvillojnë në grupe prej 2-3 vetash, në bazë të temave të përcaktuara më parë. Sipas pedagogëve përgjegjës qëllimi kryesor është të nxitin e punën në grup aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve si dhe diskutimin e tyre.		
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nga vizita në institucion, në takimet me personelin akademik, studentët dhe drejtuesit i njësisë bazë e kryesore, rezulton se stafi akademik përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” mbështet implementimin e ideve inovative, gjatë detyrave të kursit, diplomave dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në konferenca studentore dhe aktivitete të organizuara nga klubet studentore.		
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në “Strategjinë Kërkimore Shkencore”, Vizioni, pika 1.2, Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafik akademik, transferimit të arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. [Evidencë 3.1] Nga vizita në institucion u verifikua se: stafi akademik përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale” mbështet studentët për temat inovative. Deri tani nuk ka patur ndonjë rast për të patur mbështetje financiare.		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Nga vizita në institucion u verifikua se, shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UET, dhe mund të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, si njësi bazë relativisht e re, ka një numër jo të madh mobilitetesh në kuadër të Projekteve ERASMUS+KA1 [Evidencë 28.1]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, parashikon që detyrimet përmbyllëse të jenë nëpërmjet Mbrojtjes së diplomës. UET ka hartuar një procedurë të posaçme për studentët që mbrojnë punimin e diplomës, Dokumenti B.II "Mbi punimin e diplomës". [Evidencë 10] Në bazë të këtij dokumenti studentët e Masterit të Shkencave kanë detyrimin të kryejnë një punim individual, në mënyrë të pavarur, original për mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Dokumenti B.II Për punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. [Evidencë 10] Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome.</p> <p>Nga vizita në UET, u theksua se procedurat e mbrojtjes së diplomave janë publike, në faqen e intranetit dhe studentët kanë akses ndaj tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjësin e departamentit, personelin akademik dhe studentët rezultoi se të gjitha procedurat që ndiqen që në momentin e përzgjedhjes së udhëheqësit, zhvillimit të seancave metodologjike deri në prezantimin e punimit janë të përcaktuara në dokumentet rregullatorë të institucionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. Përgjegjësi i departamentit i sqaron për çdo paqartësi në lidhje me procedurat.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p><i>Nuk aplikohet për studentët e programeve të studimit Master i Shkencave</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga biseda me pedagogët dhe studentët u verifikua se, stafi akademik i orienton studentët për zgjedhjen e temës. Udhëheqësi i temës së diplomës ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Pedagogu udhëheqës zhvillon seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, jo vetëm për të përcaktuar temën, por edhe për t'i ndihmuar për vështirësitë që mund të kenë, gjatë punimit të saj, deri në dorëzimin e saj [Evidencë 10]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe personelin akademik, rezultoi se brenda mundësive, UET i ndihmon studentët për të realizuar studimet e tyre, duke u krijuar lehtësira të ndryshme. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve</p>




	<p>metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. [Evidencë 7.1]</p> <p>Institucioni i ndihmon studentët për mbledhjen e të dhënave brenda institucionit ose jashtë tij. Kështu, nëpërmjet koordinatoreve sigurohet shpërndarja e pyetësorëve tek studentët e tjerë. Gjithashtu, institucioni nëpërmjet lëshimit të vërtetimit të studentit (me kërkesë të studentit) mund të ndihmojë procesin e mbledhjes së të dhënave jashtë institucionit. [Takimi me përgjegjësën e departamentit]</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në bazë të procedurës B.II. "Dokumentimi për punimin e diplomës", udhëheqësi në seancat metodologjike trajton me studentin çështje të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aspekte të metodologjisë; • Përpunimi i metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); • Puna në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/ të dhënave; • Hartimin e punimit të diplomës etj, • Nxjerrja e konkluzioneve; <p>Udhëheqësi i diplomës, garanton cilësinë e rezultateve të punimit, pasi studentët nuk mund të dorëzojnë punimin e diplomës, pa marrë miratimin e udhëheqësit. [Evidencë 10].</p> <p>Këto aspekte u theksuan edhe në takimin me personelin akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojn se studenti, në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, vlerësohet me notë. Nota e vlerësimit është në përputhje me sistemin e vlerësimit që përdor IAL</p> <p>Vlerësimi i punimit të diplomës është mesatarja e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, formati i të cilave është në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore në fuqi. Formatimi i diplomës dhe suplementit të diplomës nuk është regjistruar ende në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave, pasi pritet akreditimi i programeve të studimit, por është i miratuar nga MAS me licensimin e programit të studimit. Kohëzgjatja e lëshimit të diplomës është brenda 6 (gjashtë) muajve. Deri në momentin e pajisjes me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave.</p> <p>[Evidencë 15, takimi me drejtuesin e departamentit].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojn se, studentëve të interesuar, me kërkesë të tyre, ju vihet në dispozicion një kopje e plotë e programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i Institucionit.</p>

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Nga vizita në institucion, në zyrën qendrore të sekretarisë mësimore, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, IAL ruan dhe arkivon për një periudhë kohe të pacaktuar dokumentacionin e studentit, nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij. Regjistrat ishin të plotësuar, të mirëmbajtura dhe të sistemuara në dosje dhe në dollape. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Përgjegjës në UET për menaxhimin e vazhduar të burimeve njerëzore duke përfshirë dhe personelin akademik është Zyra e Burimeve Njerëzore. Ky sektor është gjithashtu struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit. Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.</p> <p>Nga takimi i GVJ-së në institucion me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, u kërkuan kontratat individuale të punës. Në to, UET ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas funksioneve të stafit përbërës të tij. Bashkangjitur me kontratën është edhe përshkrimi i punës për çdo punonjës. Përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara edhe në rregulloren e UET. Detyra të tjera specifike për stafin përcaktohen në dokumenta të tjerë si: Rregullore programit studimit, rregullore diplomimit, rregullore praktikave profesionale, etj.</p> <p>Sektori i Burimeve Njerëzore disponon një dosje të plotë, për secilin prej anëtarëve të personelit akademik të brendshëm, të përgjegjës të programit,</p>




	<p>të stafit ndihmës akademik. Këto të dhëna përditësohen prej vetë stafit akademik duke plotësuar informacionin në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë.</p> <p>[Evidenca 5, 11, 44.1, 44.2] [Evidenca shtesë 7]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në statutin e UET Neni 5 pikat 5.1; 5.2 dhe 5.3 shprehet veprimtaria e Universitetit Europian të Tiranës duke theksuar se është një institucion jo publik i arsimit të lartë (5.1), kryen veprimtari në përputhje dhe në zbatim të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 (5.1) dhe kryen aktivitetet të pavarur ekonomik (5.3).</p> <p><i>GVJ konstaton se ne dokumentat bazë të UET, si: Statuti dhe Rregullore e UET mungojnë të shprehura qartazi kriteret e punësimit të personelit akademik (PAE/PAK) por sikuder evidentohëet te veprimtarit që kryen shprehet perputhja me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në listën e stafit akademik të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale” dukshëm ka pedagog PAE me moshë më të madhe se 68 vjec për te dy vitet e studimit. Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015, Neni 65 pika 1 dhe pika 2 shpreh qart kushtet e punësimit për kategorinë “Profesor” dhe kërkon përcaktime në statutin e institucionit të arsimit të lartë!</i></p> <p>Nga vizita në institucion hapat/procedurat e ndjekura nga institucioni UET janë në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Departamenti në fillim të çdo viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik për mbulimin e lëndëve të ofruara në programin e studimit të ciklit të dytë Master në “Inxhinieri Industriale” duke përpiluar një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual. Me hartimin e këtij dokumenti, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për staf. Këto nevoja për staf përcillen në rektorat në zbatim të Rregullores së Universitetit. Pas vlerësimit të kërkesave në referencë të nevojave të mësimdhënies e kërkimit shkencor bëhet publikimi i vendeve të lira të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen eeb të universitetit dhe bëhet ngritja e komisionit të rekrutimit. Vlerësojmë se gjithë këto procedura janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi, statutin dhe rregulloren e Universitetit.</p> <p>[Evidenca 2, 5] [Evidenca shtesë 13.9, 16.8]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik janë të parashikuara në dokumentin përkatës, në të cilin përcaktohen fazat nga evidenti i nevojave për personel të ri e deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.</p>




	<p>Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit, rrjetet sociale dhe në gazetën Liberale.</p> <p>Duke respektuar të gjitha afatet e përcaktuara e të bëra publike, ndiqen hapat e plotë për të përfunduar procedurën e rekrutimit. Çdo hap i kësaj procedure duke filluar me identifikimin e nevojës për staf prej Njesisë Bazë, miratimin e kriterëve, publikimin, procesin e vlerësimit të kandidatit dhe vendimi i marrjes në punë janë të dokumentuara në dosjen e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të universitetit [Vizita në UET].</p> <p>Faqja zyrtare e UET https://uct.edu.al/rreth-uct/ [Evidenca 11.1]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Nga vizita monitoruese GVJ-kërkoj të vihet në dispozicion në kuadrin e dokumentave shtesë një procedurë e plotë rekrutimi për personelin akademik të programit Master Shkencor në "Inxhinieri Industriale" në Fakultetin e Inxhinierisë, IT dhe Arkitetkurës. Në këto procedurë evidentohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e komisionit të rekrutimit (Urdher Administrativ); • Poblkim i njoftimit në ëeb të UETsë kriteret e përgjithshme dhe specifike; • Konfirmimi i kandidatit për kalimin në fazën e intervistës; • Shënime gjat intervistës me kandidatin me sistem pikëzimi • <p>GVJ evidenton se në këto dokumente është bërë skualifikim paraprak i kandidatëve që nuk plotësojnë kriterin ligjor të notës mesatare nga Institucioni.</p> <p><i>GVJ rekomandon që referuar Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë" Nenin 65 pika 1 dhe pika 2, urdhrat administrative dhe dokumentat bazë të UET, si: Statuti dhe Rregullore e UET të vendosen kushtet specifike për kohëzgjatjen e shërbimeve akademike nga persona të cilët kanë mbushur moshën e daljes në pensionit (sipas titujve "Profesor" apo "Profesor I asociuar") në rastet kur institucioni ka nevoja për angazhimin/ria-angazhim e tyre.</i></p> <p>Siç e vërejtëm në vlerësimin e kriterit të mësipërm procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit të stafit akademik bëhen mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura paraprakisht dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet rregullatorë bazë të UET (Statutin dhe Rregulloren e UET). Kriteret e përgjithshme përshkruhen tek Statuti dhe Rregullorja e UET-së, ndërsa dhe kriteret specifike propozohen prej Njesisë Bazë, në reference të specifikave e kërkesave të lëndës/grup lëndëve për mbulimin e të cilave kërkohet ky staf si dhe bëhen publike dhe në faqen ëeb të UET-së.</p>





	<p>Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.</p> <p>[Evidenca shitesë 16.8] [Vizita në UET]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Si rezultat i investimeve të bëra prej vetë universitetit në ambientet e Universitetit me seli në adresën Rruga “Xhanfize Keko” Nd.56, janë krijuar ambiente komode pune për stafin akademik, për stafin ndihmës akademik e administrativ, Drejtuesit e Njësive Bazë e të Njësive Kyresore. Në këtë godina (A, B dhe C) zhvillohet dhe procesi mësimor për të gjithë studentët të cilët ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Industriale, duke mundësuar krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale [shënime nga vizita monitoruese në UET].</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës për zhvillimin e procesit mësimor ka në dispozicion një numër sallasësh leksionesh/seminarësh në përputhje me nevojat e parashikuar në planin mësimor. Këto ambiente mësimi shfrytëzohen njëkohësisht edhe nga njësitet e tjera të UET. Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, salla e departamenteve, zyrat dyshe, zyrat individuale të drejtuesve të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm.</p> <p>[Evidenca 42]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga takimi me stafin akademik rezultojnë që UET mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat inovative, pjesëmarrjen në konferencat të cilat organizohen, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta.</p> <p>Ndihma ka qënë konkrete, e konsiderueshme dhe e vazhdueshme, vecanërisht në realizimin e mobiliteteve të ndryshme për periudha të shkurtra kohore, në kuadër të programeve nderkombëtare ku UET ka fituar 47 projekte Erasmus KA1 dhe 14 projekte Erasmus KA2 [shënime nga vizita monitoruese në UET].</p>

	<p>Detyrimi i universitetit në mbështetjen e stafit akademik për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit është e shprehur dhe në dokumentat bazë të UET si Statuti, Strategjia e kërkimit shkencor, dhe Rregullore e UET.</p> <p>[Evidenca 3,2 28.5, 43]</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Stafi i UET dhe i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës në veçanti inkurajohet të përdorë metoda të larmishme të mësimdhënies në funksion të arritjes së objektivave të programit të lëndës. Ata janë të interesuar në njohjen dhe aplikimin e metodave bashkëkohore të arritjeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtu vlen të theksohet dhe organizimi i mësimi on-line në kushtet e pandemisë së Covid-19.</p> <p>Trajnime të ndryshme janë kryer për përdorimin e sistemit TEAMS dhe LMS. Në çdo fillim viti akademik, është realizuar aktiviteti trajnues i drejtuesëve të departamenteve në programin një javor "Back to Ëork" ku drejtuesit e universitetit dhe profesorë me tituj akademike kryejnë trajnimin mbi ecurinë e aktivitetit akademik dhe menaxherial të IAL. Gjithashtu, në vitin akademik 2019-2020 është realizuar trajnimi "UET 2020: mësimdhënia, cilësia, strukturimi" për pedagogët e Universitetit ku profesorë me tituj akademik trajnuan pedagogët mbi metodat e reja të mësimdhënies, inovacionit si dhe trajnim mbi përdorimin e platformës elektronike LMS. Qëllimi i aktivitetit ishte zhvillimi i stafit akademik për mësimdhënien dhe rregullat Universitare.</p> <p>[Evidenca 3.1, 3.2, 5.1, 46.4]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë Master Shkencor në Inxhinieri Industriale me profilet "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe jo vetëm, dëshmojnë për një angazhim në arritjen e këtij qëllimi. Kjo tregohet përmes kohës vjetore të punës për secilin anëtar të stafit, që është e shpërndarë në të tre elementët përbërës së saj: realizim i procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve (sipas kuadrit ligjor në fuqi).</p> <p>[Evidenca shtesë 14.2]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi IV.3




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Aktualisht UET e ka selinë në kampusin e ri universitar me adresë Rruga “Xhanfize Keko”, Nd. 56, në Tiranë ku u zhvillua dhe vizita e GVJ-së.</p> <p>Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Nga dokumentat në dispozicion dhe nga RVB evidentohet se: Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m². Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m² dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m², dhe 353 vende.</p> <p>[Evidenca 42, 42.1]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në mjediset e UET-së dhe nga dokumentat e vendosura ne sistem evidentohen që UET ka aktualisht në përdorim 7 laboratorë mësimorë informatike, 1 sallë interneti 70 vende, dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëaret përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj.</p> <p>[Evidenca 46.1, 46.2, 46.3]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, system audio dhe internet për të mundësuar një proces mësimdhënie efektiv.</p> <p>Nevoja për laboratorë të ndryshëm të cilët mbështesin këtë program studimi mbetet një sfidë e vazhdueshme e UET dhe Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës ku zgjidhja aktuale është dhënë në bashkëpunim me Kolegjin Profesional të Tiranës ku kryen Laboratorët.</p> <p><i>Sa më sipër GVJ konstatoi se UET nuk kishte laboratorë të dedikuar për zhvillimin e disiplinave të kurrikulës së Inxhinierisë Industriale. Kjo pjesë e punëve laboratorike zhvilloheshin pranë Kolegjit Profesional të Tiranës, me të cilën ishte lidhur edhe një Memorandum bashkëpunimi.</i></p> <p><i>GVJ gjykon se zgjidhja e dhënë për kryerjen e laboratorëve në një institucion tjetër nuk është e qëndrueshme dhe afatgjatë. UET duhet të</i></p>

	<p><i>planifikojë në buxhet krijimin e laboratorëve të nevojshëm për mbështetjen e zhvillimit të moduleve dhe disiplineve në fushën e Inxhinierisë Industriale, të cilat në të ardhmen mund të shërbejnë edhe si bazë për zhvillimin e temave të diplomave.</i></p> <p>[Evidenca shtesë 15.5]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UET disponon disa salla të teknologjisë së informacionit (të paisuara me kompjutera dhe softë përkatës), të cilat janë në dispozicion të studentëve, në të cilat ata marrin njohuritë sipas programit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve mbi programe informatike (7 laboratorë mësimorë informatike me sipërfaqe 383m² me një total prej 190 vendesh) specifike të fushave të ndryshme.</p> <p>[Evidenca 42.1]</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Studentët kanë mundësi që të zhvillojnë aktivitete praktike në laboratorët që vetë institucioni posedon dhe që GVJ konstaton se kanë kapacitete pritëse të mjaftueshme [Laboratori I informatikës, Lab. Mekanikes, shënime nga vizita ne Institucion]. Për të kapërcyer këtë mangësi lidhur me laboratorët specifik për programin e studimit, janë lidhur marrëveshje të ndryshme që Departamenti/ Fakulteti apo Universiteti ka me kompani shtetërore apo private të cilat zhvillojnë aktivitete në fushat që përputhen me programin mësimor.</p> <p>Marrëveshja e bashkëpunimit me Kolegjin Profesional të Tiranës krijon akses për studentët e programit Master shkencor në Inxhinieri Industriale të perfeksionohen nga pikpamja praktike me temat e laboratoreve dhe praktikat në mjediset e KPT.</p> <p>[Evidenca 32, 32.1, 34.1 – 34.21] [Evidenca shtesë 5.4]</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës) në UET nuk disponon një bibliotekë të vetën, por studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Industriale shfrytëzojnë bibliotekën e institucionit, e vendosur në godinën C dhe me një sipërfaqe prej 35 m² e cila është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e programit MSc Inxhinieri Industriale [shënime nga vizita në institucion].</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Literatura e ofruar nga institucioni përmes Bibliotekës së tij është multidisiplinare, kjo për vetë natyrën e UETsë. Në këtë Bibliotekë gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi. Ajo është e vendosur ne Godinën A me 3 salla me 41 vende leximi është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikes të këtij programi studimi.</p> <p><i>GVJ konstaton se fondi i librave në bibliotekë për fushën e Inxhinierisë Industriale nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha disiplinat e këtij programi i studimi. Nga ana tjetër një pjesë e kësaj literature është mjaft e vjetëruar për t'u rekomanduar për përdorim.</i></p> <p>[Evidenca 45.2, 45] [Tableat përmbledhëse – tabela Nr. 17]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UET I jep mundësi studentëve dhe pedagogëve që përmes abonimit në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapaciteteve infrastrukturore në bibliotekë (PC, Ëi-fi) garantojnë azhurnimin e vazhdueshëm në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies me literature/artikuj dhe materiale bashkohore.</p> <p>Në faqen ëeb të universitetit, personeli akademik dhe studentët nuk kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore dhe është e integruar me laboratorin e IT. Gjithashtu Biblioteka e UET-sëpjese e rrjetit COBISS bën të mundur katalogimin e me bazën bibliografike të përbashkët të të dhënave me bibliotekat e përfshirë në këtë rrjet [shënime nga vizita në institucion].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UPT çdo vit, përpara hartimit të buxhetit vjetor, kërkon prej Njërive Bazë të përcjellin nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës, duke përditësuar fondin ekzistues me botime të kohës. Institucioni ka hartuar procedura për funksionimin dhe pasurimin e bibliotekës.</p> <p>Vlerësohet se literatura në dispozicion, duhet të pasurohet me botime më bashkëkohore në fushën e programit të studimit, kryesisht në gjuhën shqipe, por edhe në literaturë e rekomanduar në gjuhë të huaj [Vizita në UET].</p> <p>[Evidenca 42, 42.1, 45.1; 45.2; 45.3]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion me oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Oraret jane nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00 per këtë program studimi. Kurse gjatë sezonit të provimeve ky orar është i zgjatur [Vizita në UET].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesësisht
		X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në zbatim të kuadrit ligjor për arsimin e lartë UET mban në formë të shkruar [Vizita në UET]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve, • Regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik, • Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. <p>Sistemi nëpërmjet të cilit UET administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është sistemi UMIS. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite.</p> <p>[Evidenca 46]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi MOODLE (UET LMS) dhe UMIS, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit si dhe mbështesin studentin në procesin mësimor.</p> <p>Sekretaria mësimore në UET drejtohet nga Sekretari I Përgjithshëm dhe përbëhet nga: (i) zv. Sekretari I Përgjithshëm, (ii) Sekretaret e Programeve të Studimit (Sekretaria) dhe (iii) Koordinatorët e Departamenteve (Koordinatorët); (iv) Zyra e Regjistrimit të Studentëve (Registray); (v) Zyra e koordinimit të Studimeve Doktorale. Sekretari mesimore, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrative, sipas akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Nga vizita në institucion e GVJ u evidentua se egzistojnë dosjet e personelit dhe nxjerrja e të dhëna kur kërkohen është lehtësisht e aksesueshme, por</p>

	<p>duke respektuar ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale [shënime nga vizita monitoruese në UET].</p> <p><i>Nga dokumentacioni i vendosur ne dispozicion për GVJ, nuk evidentohet rregjistri themeltar për menaxhimin e dokumentacionin personal të punonjësve nga DBNJ ose nëpërmjet specialistit të zyrës së burimeve njerëzore.</i></p> <p>[Evidenca 9]</p>								
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ndër të tjera sistemi menaxhimit UET LMS (Learning Management System), siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në Inxhinieri Industriale. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarin e tij [Vizita në UET].</p> <p>[Evidenca 46.2, 46.3]</p>								
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi me pedagogët dhe studentët aksesimi në sistemin LMS është shumë praktik, I thjeshtë dhe fleksibël. Komonikimi në këtë platformë shërben për marrjen e laksioneve, orientimet për problematika lidhur me lëndët si edhe për njoftime të ndryshme midis tyre.</p> <p>LMS mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish: Zyra IT, Përgjegjës Departamenti, Sekretare, KryeSekretare, Studentë, Pedagog, [shënime nga vizita monitoruese në UET].</p>								
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi kompjuterik LMS i UETsë, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët [Vizita në UET].</p>								
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>UET ka një faqe web (www.uct.edu.al) të dedikuar në të cilën publikohen informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> <p>Në ëeb GVJ konstatoi të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit etj.</p> <p>[Evidenca 48]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Administratori dhe Zyra e Financës harton në mënyrë periodike projekt-buxhetin financiar të institucionit i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik, përpara se ti paraqitet për miratim Asamblesë së Ortakëve të UET-së.</p> <p>GVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se <i>“raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë”</i>.</p> <p>[Evidenca 2, Kreu III, Neni 19, 50.1 – 50.3, 50.4 – 50.6].</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga ana e UET vihen në dispozicion për një program studimi të gjitha burimet njerëzore dhe asetet e nevojshme për realizimin e tij. UET mbështet stafin akademik në ngritjen e tyre profesionale duke i mbështetur në pjesmarrjet e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në lidhje të marrveshjeve bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare.</p> <p><i>UET nuk ka të hartuar një plan financiar të dedikuar për një program studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të vetë institucionit dhe si rregull përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij</i> [Vizita në UET].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ-së, rezulton që, Universiteti Europian i Tiranës angazhon auditues ligjor I cili kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. Raporti i auditit fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të shoqërisë EEI shpk, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p> <p>[Evidenca 50.1 – 50.3, 50.4 – 50.6]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi raporte financiare për 3 vitet e shkuara (2018, 2019, 2020) sikunder kriteri 4 kërkon.</p> <p>[Evidenca 50.4 – 50.6]</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>GVJ, konstatoi se strukturat përkatëse hartojnë pasqyrat financiare vjetore, të cilat sipas RVB dhe takimit me GVB, raportohen në senat dhe në Asamblesë së Ortakëve të UET-së si institucion jopublik I Arsimit të lartë.</p> <p><i>GVJ rekomandon gjetjen e mekanizmave për rritjen e numrit të studentëve dhe të të ardhurave për këtë program, për të rritur qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Proceduar dhe kriteret e pranimit në programin e studimit "Master Shkencor" në "Inxhinieri Industriale" me profilet "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" (të cilat kërkohen të akreditohen), janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e institucionit. Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të dytë të studimeve "Master" në Inxhinieri Industriale, në Universitetin Europian të Tiranës mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (neni 74), në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kriteret e parashikuara të rregullores së UET, si dhe në kriteret e propozuara nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës).</p> <p>Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>

	<p>Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.</p> <p>Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET) http://uet.edu.al/ncë/si-te-aplikojme/, fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.</p> <p>[Evidenca 5, 7, 27.1]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse. Regjistrimi i studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master" në "Inxhinieri Industriale" kryhet pranë sekretarisë së Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës).</p> <p>Rregullorja e UET-së dhe e programit të studimit, përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Shkencor në Inxhinieri Industriale.</p> <p>[Evidenca 5, 7]</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Para fillimit të vitit akademik, institucioni i dërgon për miratim MASR-së kuotat si edhe kriteret për programin e studimit. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të Universitetit "European të Tiranës".</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, ata u shprehën se referuar rregullores së programit të studimit "Master" në Inxhinieri Industriale, njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UET-së, është transparente dhe e kuptueshme për ta.</p> <p>[Evidenca 7, 12, 27.2, 28]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me drejtuesin e departamentit, por edhe me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve bachelor dhe që plotëson:</p> <p>a) Kriter pranimi në një program të ciklit të dytë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European;</p>

	<p>b) Në raste kur studenti kërkon njohje të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga Departamenti përgjegjës për programin;</p> <p>c) Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose totale sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse.</p> <p>Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të UET-it dhe sipas kritereve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>[Evidenca 7, 27.1] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 1] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 2]</p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga takimi i GVJ me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve u evidentua se UET ndërton fushata/evente marketingu të mirë organizuara më në fokus lobimin dhe bërjen sa më atraktive të programeve të studimit që UET ofron. Këto fushata jan me karakter informuese lidhur me mundësit që programet e studimit ofrojn, mundësit e punësimit, funksionimin e jetës studentore në UET dhe janë në disa forma të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fushata informues (para fillimit të vitit akademik), • Panairë pune, • Këshillime në institucion, • Java e Orientimit, • Informacione në rrjetet sociale, • Etj. <p>[Evidenca 7, 12.2, 48, 51]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u konstatua se studentët e këtij programi studimi, informoheshin në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e pëfituara në përfundim të tij.</p>




	<p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren mësimore të programit të studimit.</p> <p>Në fillimin e vitit akademik, përpara fillimit të procesit mësimor, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës shpall në ambiente publike orarin mësimor, në të cilin janë të përcaktuara qartë: kodi dhe emërtimi i lëndës, ngarkesa e lëndës, dita, ora, salla dhe pedagogu i lëndës për semestrin përkatës. Për çdo kurs hartohet programi mësimor (syllabusi), i cili u prezantohet studentëve nga pedagogu i lëndës në fillim të kursit.</p> <p>Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë.</p> <p>[Evidenca 7, 19.1] [Evidenca shtesë 6.4, 9]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Informacioni është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit. Staf i gjithashtu informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimin.</p> <p>Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p>Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UET, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve.</p> <p>[Evidenca 28]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentet dhe pedagogët që mbulojnë lëndët e programit mësimor "Master Shkencor" në Inxhinieri Industriale u evidentua se informimi i studenteve në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit realizohej nëpërmjet prezantimit të syllabusit.</p> <p>Referuar organizimeve informuese institucionale (Java e Orientimit si dhe informacionet Online) studentët kanë mundësi të informohen lidhur me programin e studimit, jetën studentore në UET, mjediset e mesimdhënies, mënyrën e vlerësimit, sistemin e menaxhimit LMS etj.</p> <p>[Evidenca 48]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me studentet, ata u shprehën se ishin në dijeni të kriterëve dhe procedurave për mbylljen e studimeve të tyre nëpërmjet mbrojtjes së një punimi diplome. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me originalitetin e studentit, mund të ketë karakter teorik ose empirik.</p> <p>Departamenti dhe koordinoret e Departamenteve informojnë studentët përmes, takime me studentët, sistemit të menaxhimit LMS, apo edhe nëpërmjet faqes së internetit, për kriteret që kërkohet të plotësohen për</p>

	<p>procedurat e punimit të diplomës. Kriteret mbi punimin e diplomës dhe disertacionin janë vendosur dhe në dokumentat bazë të institucionit: Statuti, Rregullore e programit të studimit, etj.</p> <p>[Evidenca 5, 10, 10.1, 10.2, 10.3, 10.4]</p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve në UET si strukturë mbështetëse planifikon dhe organizon veprimtaritë në fushën e bashkëpunimit dhe informimit me palët e interesuara në aktivitete si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fushata informues (para fillimit të vitit akademik), • Këshillime në institucion, • Java e Orientimit, • Informacione në rrjetet sociale, • Panairë pune • Open-days • Etj. <p>[Evidenca 12.2, 27.1, 48, 51]</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me studentet ata u shprehën se informohen lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e programit të studimit; • Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit; • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Kontratës që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit.
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmës. Ky informacion gjithashtu gjendet edhe në faqen web të institucionit.</p> <p>Me fillimin e semestrit pedagogu bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, informacion ky që</p>

	<p>pasqyrohet edhe në syllabusin e lëndës. Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes e-mail-it dhe sistemit LMS me: pedagogët, Sekretarinë Mësimore, Drejtuesit e departamenteve, koordinatorin, etj.</p> <p>[Evidenca 7]</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UET ka në fokusin e vet bashkëpunimin me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. Bashkëpunimet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara, memorandume bashkëpunimi, partnership në kuadër të kërkimit shkencor, zhvillimit të projekteve të përbashkëta, shkëmbimit studentor dhe të stafit akademik, etj. Në kuadrin e këtyre marrëveshjeve bëhet i mundur realizimi i praktikave mësimore të studentëve, të cilat shërbejnë dhe si pikënisje për punësimin e mëtejshëm të studentëve mbas diplomimit.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës ka Zyrë të Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Misioni i saj është të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë. Po ashtu Bordeve të tregut të punës, shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.</p> <p>[Evidenca 12-12.4, 34-34.21, 35]</p>				
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me drejtues të institucionit, përgjegjës të departamentit etj, konstatoi se studentët e këtij programi studimi, informohen në mënyra të ndryshme për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, nëpërmjet stafit akademik, sekretarisë, mediat sociale si edhe faqe ëeb të UET. Informimi i studentëve në lidhje me sallat e mësimit, bibliotekën e gjithçka tjetër që lidhet me realizimin e programit të studimit bëhet në fillim të vitit akademik.</p> <p>[Evidenca 9]</p>				
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me studentët, ata u shprehën se Informacioni në lidhje me programin e studimit, komunikimin me pedagogët, njoftimet në nivel universiteti/Fakulteti/Departamenti bëhet i aksesueshëm nëpërmjet postës elektronike me adresë e-maili UET, nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UET dhe rrjeteve sociale. Këto metoda janë të mundura të aksesohen edhe në distancë nga studentët me sistemin e menaxhimit LMS.</p>				
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me Sekretarinë mësimore dhe me studentët, u evidentua që i gjith sistemi përsa i përket aktivitetit mësimor menaxhohet më së miri nga sistemi LMS.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet plotësisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.4
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga Sekretaria mësimore, të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi.</p> <p>Nga dokumentat e vendosura në sistemin e ASCAL paraqiten Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi për V.A 2019-2020; V.A 2020-2021 dhe V.A 2021-2022;</p> <p>[Evidenca 27]</p>
--	---

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve për ciklin e dytë "Master Shkencor" në Inxhinieri Industriale mënxhohet nga Sekretaria mësimore.</p> <p>Nga takimi I GVJ me sekretarinë mësimore këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e universitetit.</p> <p>Të dhënat për këtë program studimi për të dy profilet "Inxhinieri Energjitike", "Inxhinieri Mekanike", "Inxhinieri Transporti", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" të regjistruar në vitet akademike sëbashku janë:</p> <table border="1" data-bbox="683 1411 1276 1635"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Për herë të parë në vitin e parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>10</td> <td>6.69</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>16</td> <td>5.98</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>26</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Evidenca 27]</p>	Numri i studentëve të regjistruar	Për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare	2019-2020	10	6.69	2020-2021	16	5.98	2021-2022	26	6
Numri i studentëve të regjistruar	Për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare											
2019-2020	10	6.69											
2020-2021	16	5.98											
2021-2022	26	6											

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me Sekretarinë mësimore dhe u evidentua që ajo është përgjegjëse dhe mban gjithë informacionin lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Shkencor" në Inxhinieri Industriale.</p>
---	---




	Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve regjistron dhe arshivon në formë të shkruar dhe në formë elektronike të dhënat e studentëve dhe arritjet e tyre akademike.		
	[Evidenca 9]		
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga vizita në institucion e GVJ-së dhe takimet me përfaqësues të Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Regjistrimit të Studentëve dhe Zyrën IT-së, u evidentua përdorimi i sistemit UMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit) i cili bën të mundur mbajtjen e rekordeve të studentëve. Ky sistem administron të dhënat akademike, gjeneron raporte statistikore si edhe informacione aktivitetesh të tjera didaktike dhe ekonomike për funksionimin e UET-së. Administrimi i të gjithë sistemit në nivel sigurie menaxhohet nga Zyrës IT-së.		
	[Evidenca 46]		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Departamenti analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Gjurmimi i punësimit të studentëve edhe pse është bërë, duhet të jetë më periodik dhe i vazhduar për të pasur një tablo më të plotë të cilësisë së punësimit të tyre.		
	[Evidenca 38]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në zbatim të Ligjit Nr. 80, 2015, si dhe Statutit të Universitetit Europian të Tiranës parashikohet përfshirja dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të universitetit. Nga takimi i GVJ me studentet ata u shprehën se janë në dijeni që përfaqësohen në struktura si: <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.

	<ul style="list-style-type: none"> • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. • Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët. <p>[Evidenca 2]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfaqësuesit e studentëve në senatin akademik (kryetari i këshillit Studentor dhe dy student të tjerë përfaqësues të tre cikleve të studimit me mandat 2 vjeçar) përfshihen në mënyrë aktive në cdo vendimarrje në lidhje me procesin mësimor e më gjerë. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës dhe Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës i marrin gjithmonë në konsideratë dhe propozimet dhe ankesat e studentëve, si personale dhe kolektive.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, u shprehën që përfshirja e tyre në vendimmarrje dhe adresim të vlerësimit të tyre mbi procesin akademik kryet nëpërmjet (i) pyetësorit të studentëve; (ii) përzgjedhjen e studentëve në bazë të vendimmarrjes së tyre, (iii) adresimi i kërkesave të studentëve.</p> <p>Angazhimi i tyre në proceset e vendimmarrjes, këshillimit apo vlerësimit të institucionit, i garantuar nëpërmjet akteve rregullatore të UET-së, është real e i mbështetur në evidenca dhe rezultate të matshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • UET i përfshin studentët në vlerësimin real dhe konkretë prej tyre të procesit akademik bazuar në rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme përmes marrjes së mendimit të studentëve të UET-së me pyetësorët që përgatit dhe organizon KSBC për cilësinë e mësimdhënies për programet e studimit. • Studentët përfshihen në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional (një student i programit MSH Industriale është pjesë e GVB-së) <p>[Evidenca 2, 5]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në programin MSc Inxhinieri Industriale, shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër) dhe duke patur parasysh mostejkalimin e 25 orëve javore si ngarkesë akademike të studentëve në këtë program studimi, të ndara në grupe leksioni, seminari e laboratore. Mësimi, si rregull, zhvillohet mbasdite.</p> <p>Vetë përmbajtja e këtij plani mësimor (lëndët/ modulet dhe programi lëndor shoqërues) e mundëson realizimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentit përgjatë programit, duke krijuar mundësi për njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të studentëve. Njohja e krediteve nga studime të mëparshme zhvillohet nga komisioni i transferimeve i cili përcakton përputhshmërinë e tyre me lëndët e ofruara në këtë program studimi.</p> <p>[Evidenca 5; 14.2. 28]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe</p>	<p>UET, nëpërmjet KSBC-së, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e ç’do lëndë dhe ç’do pedagogu për lëndët përkatëse. Në këtë</p>

<p>përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflektion sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre dhe mbetën anonim. Rezultatet e pyetësorit merren në konsideratë dhe kontribuojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Në RVB evidentohet që “Raporti i Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të përgatitur nga të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, për secilin prej programeve të studimit të ofruara në këtë universitet si dhe për secilën lëndë/modul të këtyre programeve, është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet e dala nga ky raport në njësinë bazë” por GVJ nuk evidenton një raport të till.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Studentëve të këtij programi studimi gjat takimit me GVJ u shprehën se u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme sikurse dhe në silabusin e secilës lëndë.</p> <p>[Evidenca 7, 19.1, 24, 27, 32]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga takimi i GJV-së me pedagogët u informuan se UET mundëson publikime periodike në revista ndërkombëtare si POLIS por edhe në revistën e departamentin NODUS. Po ashtu në dokumentat strategjik që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor UET nxit aspektin cilësor të punimeve në revista të indeksuara ndërkombëtare.</p> <p>[Evidenca 3.1, 3.2, 43]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion evidentohen një numër I konsiderueshëm marrëveshjesh partneriteti në institucione homologë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo strategji e ndjekur nga UET krijon premisa për mundësin e projekteve, studimeve por edhe punimeve kërkimore të përbashkëta.</p> <p>[Evidenca 3.1, 3.2, 34]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, UET mbështet marrëdhëniet me studentët e regjistruar në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Industriale". Nga dokumentat GVJ nuk evidenton ndonjë përfshirje konkrete nga studentët lidhur me punime shkencore.</p>

	<p><i>GVJ sygjeron që Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, duhet të ket angazhim konkret në këtë drejtim pasi profilet që janë pjesë e këtij Masteri paraqesin fusha interesi kombëtare, ku angazhimi i studentëve sidomos në përfundim të studimeve (vitet e dyta) të mund të japin kontribut real analitik dhe bibliografik.</i></p> <p>[Evidenca 4]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Sikundër evidenton Kriteri 1, tashmë stafi i Fakulteti i “Inxhinierisë dhe Informatikës dhe Arkitekturës” dhe ai i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës mund të publikojnë punë kërkimore shkencore edhe në revistën NODUS, përveç revistave prestigjioze me factor impakti si Thomson Reuters/Clarivate Analytics dhe SCOPUS.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p><i>Mbështetur në RVB evidentohet fakti që UET mbështet angazhimin e studentëve për këtë kriter, por GVJ nuk evidenton ndonjë formë konkrete të mekanizmave financues në këtë drejtim.</i></p>		
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p><i>Nga vetë natyra e programit të studimit Master I Shkencave në “Inxhinieri Industriale” sfidat për realizimin e punimeve të diplomave me karakter praktik mbështetur në analiza, përpunim rezultatesh dhe interpretim në secilin prej profileve “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti” dhe “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” mbeten vazhdimisht e hapur. UET disponon marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzimin e laboratoreve me KPT për të mbështetur këto lloj diplomash por GVJ propozon alokimin e fondeve të dedikuara ose angazhime në projekte kombëtare/ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve laboratorike për një zgjidhje sa më afatgjatë dhe të qëndrueshme.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Numri i konsiderueshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni disponon me partner të ndryshëm si: Universitet, Institucione të shoqëris civile, partner dhe donator kombëtar dhe ndërkombëtar krijon mundësi reale për rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 4]</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët</p>	<p>Referuar kurikulës dhe planit mësimor të programit MSH në “Inxhinieri Industriale” studentët zhvillojnë lëndë si “Metoda kërkimi të avancuara”</p>

siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	dhe "Kërkime operacionale" të cilat I japin studentëve aftësitë analitike për kërkime shkencore të plota ose të pjeshme. GVJ nuk evidenton raste të vazhdimësisë së studentëve të këtij programi studimi në ciklin e tretë të studimeve doktorale. [Evidenca 14, 14.2]						
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Projektet e Mëdha Kërkimore (PMK) në të cilat UET ndërton dhe realizon kërkimet shkencore janë instrumenti kryesor I drejtimit dhe gjenerimit të punimeve dhe botimeve shkencore në UET. Në strategjitë e kërkimit shkencor shprehen qartë përfshirja në to e kategorive si senior-researcher të cilët kanë për qëllim ndër-disiplinaritetin e kërkimit. [Evidenca 3.1, 3.2]						
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Mbështetur në RVB dhe në dokumentat në dispozicion evidentohet angazhimi I kërkuesve shkencorë të huaj në aktivitetet shkencore akademike që institucioni organizon në pozicione si keynote speaker, si referues etj. [Evidenca 55]						
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	UET mbështet mobilitetet e studenteve të tijë me politika konkrete në kuadër të ndërkombëtarizimit për shkëmbim të tyre. <i>Nga takimi me stafin akademik nuk evidentohen shkëmbime të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, me profile</i>						
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Sikundër përmendet në kriterin 4 por edhe në RVB, UET nxit përpjekjet institucionale me partnerët ndërkombëtar në aktivitete kërkimore shkencore të cilat promovojnë profilin akademik të tijë						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Nga takimi i GVJ me përfaqësues të me Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve u informua se informimi i studentëve është i vazhdueshëm. Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. Në funksion të këshillimit akademik të studentëve jan edhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament.

	[Evidenca 12, 27.2]						
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit (kriteri 1 I sipërpërmendur).						
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Karrierës dhe Këshilluesit të Karrierës (pedagog pranë cdo departamenti) shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Këto njësi I mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke u ofruar atyre informacionet dhe orientimet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> informacion në lidhje me mundësi punësimi, informacion në lidhje me aktivitete studentore asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. realizohen panairë të ndryshme për punësim punësimi të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. Asistojnë dhe këshillojnë studentin për përfitimin e bursave dhe kredive studentore, organizimeve studentore etj; Etj. 						
	[Evidenca 12.2, 32.1]						
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe edhe Zyra Alumni e ngritur në UET, janë struktura përgjegjëse që sigurojnë të dhëna për studentët pas diplomimit si edhe mban kontakte me studentët e diplomuar. Në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve janë të përfshirë studentë Alumni.						
	[Evidenca 2, 5, 8, 29]						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ evidentohen sa më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në Statutin e Universitetit “UET”, sanksionohet garantimi i të drejtës së studentëve dhe stafit akademik për të zhvilluar lirisht dhe në mënyrë cilësore procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke vënë në dispozicion infrastrukturën adekuate për këtë qëllim. Në Statutin e Institucionit janë parashikuar strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Po ashtu në Statut përshkruhen kompetencat e Komisioneve të Përherëshme të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për cdo Njësi Kryesore/ Departament (KSCBF), Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucional (KSBCI) ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve detyrat dhe përgjegjësitë. <p>Vlen të evidentohet nga GVJ se paralel janë hartuar dhe përpiluar planet strategjike në nivel institucional (Planin Strategjik UET 2015-2020; Plani Strategjik UET 2021; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA ne Ing Industriale) të UET-së.</p> <p>[Evidenca 2, 3, 3.3, 5, 8, 53.2]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në funksion të Sigurimit të brendshëm të cilësisë Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës operon në koherencë të plotë me procedurat e Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i cili nga ana e tij respekton procedurat që janë përcaktuar nga strukturat e nevojshme në nivel institucioni, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.</p> <p>Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në UET, funksionon nëpërmjet këtyre strukturave:</p> <ul style="list-style-type: none"> Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), Bordet e Tregut të Punës, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), <p>Monitorimi nga këto struktura si edhe angazhimi i përfshirjes së personelit akademik dhe ndihmës akademik, marrjes së mendimit të studentëve garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel institucional.</p> <p>[Evidenca 8, 30, 30.1, 30.4]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i</p>	<p>Dy prej instrumentave kryesore të jashtëm për sigurimin e cilësisë në UET janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i programeve të studimit,</p>

<p>Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>të cilat janë dhe detyrim ligjor për çdo IAL (neni 104 Ligji i Arsimit të Lartë nr.80/2015).</p> <p>UET në mënyrë i ëshë nënshtruar periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe akreditimin periodik Institucional, me qëllim vlerësimin e shkallës së përbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike .</p> <p>Po ashtu, janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik [Vizita në UET].</p> <p>[Evidenca 26, 54.3-54.5]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike. GVJ duke u bazuar në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni edhe në RVB evidenton se: KSBC harton një plan kalendarik (Plani i veprimit) të përvitshëm në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p> <p>Në mënyrë periodike KSBC raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UET-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara për çdo program studimi, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca 30.1, 30.3]</p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>UET ka ngritur një sërë strukturash/sectorësh me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit. Si strukturë e posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programe mësimore në nivel institucioni si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioneve të Sigurimit të Brendshem të Cilësisë së (është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit në nivel institucional),

	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësit e grup-lëndëve/koordinatorët (kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, silabuseve dhe literaturës), • Bordet e Tregut të Punës (reflektojnë dinamikën dhe kërkesat që vijnë nga tregu), • Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave (bëhen rekomandime bazë për ndryshime në kurrikula) <p>[Evidenca 13, 30.3, 30.6, 36]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit, pedagogët dhe studentët, u evidentua se disa nga mekanizmat apo proceset që përdoren në UET për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij, • Në Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, procedura për ndryshime, miratime në programet e studimit bëhet referuar ndryshimeve në bazën ligjore (ndryshime në ligj, VKM, Urdhëra, Udhëzime prej MASR) apo ndryshime të diktura nga koha dhe kërkesat e tregut të punës. Në të gjitha rastet, si praktikë këto ndryshime kanë ndjekur procedura standarte dhe të dokumentuara. • Pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, në përfundim të të cilit hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore. <p>[Evidenca 30.5, 30.6, 40]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UET zhvillon anketim të studentëve nga ana e KSBC, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mirë.</p> <p><i>GVJ thekson se Institucioni, organizon aktivitete monitoruese dhe vlerësuese të organizuara nga KSBC mbështetur në plane monitorimi periodike për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.</i></p> <p>GVJ, bazuar nga takimi që pati me përfaqësues të KSBC, evidentoi se disa nga treguesit e përdorur për ecurinë e programit të studimit janë nota mesatare dhe kalueshmëria, sikurse edhe punësimi i studentëve në total dhe punësimi i studentëve sipas profilit të studimit. Instrumenti i vetëm i përdorur prej NJSBC-së është pyetësi për studentët për vlerësimin e pedagogut të lëndës dhe pyetësi për stafin akademik. Drejtuesi i</p>




	<p>departamentit organizon monitorime per pedagoget lidhur me programin e lendes, materialet didaktike te perdorura gjate ores se mesimit.</p> <p>[Evidenca 30.7] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 8] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 12] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 13] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 14] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 15] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 16] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 17] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 18]</p>		
<p>Kriteri 4. Rezultatet e ketyre vleresimeve dokumentohen dhe u behen te njohura autoriteteve pergjegjese dhe vendimmarrëse per programin e studimit.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë Procedurën e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin European të Tiranës, ky raport përpilohet në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve pergjegjese sikurse dhe titullarit të lëndës, pergjegjësve të grup-lëndëve, pergjegjësit të departamentit, etj.</p> <p><i>GVJ rekomandon që ky relacion duhet të përmbajë dhe projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke e përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve.</i></p> <p>[Evidenca 30.7]</p>		
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Referuar procedurës së sipërcituar raporti i rezultateve të pyetësorëve KSBC-së ju përcillen Njësive Kryesore të cilat realizojnë më tej një diskutim të gjerë në cdo departament me stafin akademik. Ky raport nuk diskutohet me studentët dhe rezultatet e anketimit nuk iu bëhen të ditura atyre.</p> <p>Pra, edhe pse ka perpjekje pozitive transparenca dhe gjithëpërfshirja kërkojnë një angazhim të drejtëpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata.</p> <p><i>GVJ rekomandon që pavarësisht kësaj Njësitë Kryesore të diskutojnë rezultatet respektive duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas të diskutohen në Mbledhjet e Rektoratit. Në këtë të fundit përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien i cili mund ti përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit.</i></p> <p>[Evidenca 8]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret | **Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit dhe pedagogët u evidentua që Komisionet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësitë Bazë/ Departamentet (KSCBF) janë ende struktura jo të plota dhe të konsoliduara në praktika.</p> <p>GVJ mbështetur dhe në RVB evidenton që citoj: “Vlerësimi nga KSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike”</p> <p>Në nivelin e Njësive Bazë/ Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka materializuar vlerësimin e brendshëm të programeve të saj, në kuadër të procesit të akreditimit.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të programit Bachelor në “Inxhinieri Industriale” me profile “Inxhinieri Elektrike” dhe “Inxhinieri Mekanike”, strukturat përgjegjëse përdorin instrumenta të përdorur edhe në programe të tjerë studimi në UET.</p> <p>Të dhënat që ofrohen nga sekretaria mësimore janë kryesisht për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, monitorimin e realizimit të mësimin.</p> <p>Ndërkohë që kryhet edhe anketimi i studentëve dhe personelit akademik në nivel institucioni, njësie kryesore dhe në nivel të këtij program studimi.</p> <p>Disa nga metodat e përdorura janë: zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p> <p>[Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 8] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 9] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 11]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar natyrës së programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Inxhinieri Industriale” në dokumentat e vendosura në dispozicion të GVJ-së, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së këtij programi studimi evidentohet analiza e Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës mbi arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional për periudhat V.A 2019-2020, V.A 2020-2021 dhe V.A 2021-2022. Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve.</p> <p>Në dokumentat e vendosura ne dispozicion evidentohet dhe raporti sasior dhe cilësor gjatë zhvillimit të mësimin online nga platformat platformave UET LMS dhe Microsoft Teams.</p> <p>Sikunder citohet në RVB për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eperi (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raportit vlerësimi. Ky raport vlerësimi merr ne konsiderate vlersimin e</p>




	<p>elementeve te lendes si: programi i lendës, materialet e tjera didaktike që përdoren gjatë orës së mësimi, organizimi/qartësia dhe komunikimi me studentët. Ky raport vlerësimi duhet ti behet i njohur kolegut qe vlerësohet.</p> <p>[Evidenca 5.1, 30.8, 38, 46.5, 46.6,] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 14] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 15] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 16] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 17] [Evidenca shtese date 15.07.2022 Nr. 18]</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Në nivel institucional, kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit (mbështetur në Ligjin80/2015) buron nga departamenti përgjegjës për programin e studimit dhe në rastin konkret Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Propozimi shqyrtohet ne Dekanat dhe me pas kalon për miratim në Senatin Akademik të UET, pasi është konsultuar më parë me Zyrën e Kurrikulave. Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës, dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit.</p> <p>Institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. Rezultatet e tyre i vihet në dispozicion drejtuesëve të institucionit si dhe atyre të fakulteteve.</p> <p>[Evidenca 30.7, 52]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet						
			X						

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga materialet e vendosura në dispozicion të GVJ rezulton se parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, bazuar në Statutin e UET-ës, Rregulloren e UET-s dhe në Planet Strategjik 2015-2020 dhe 2021 të UET-ës.</p> <p>[Evidenca 28.5, 30, 30.3, 30.4, 30.9, 30.10]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe</p>	<p>Në institucion janë të përcaktuar qartë njësitë që janë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Industriale”. Dokumentat dhe aktet rregullatore të Universitetit përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete në funksion të garantimit dhe ruajtjes së sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit nga cdo anëtar dhe strukturë si:</p>

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • departamenti, • koordinatori i programit, • zyra e karrierës, • sekretaria mësimore, • stafi akademik. <p>Po kështu kontaktet e vazhdueshme me studentët bëjnë që të gjitha palët të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjes së tij me nevojat më të fundit të tregut.</p> <p>[Evidenca 2, 8, 36]</p>						
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesin e departamentit dhe pedagogët evidentohet fakti që këto komisione për sigurimin e cilësisë në nivel fakulteti ende nuk janë ngritur. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ngrihet në nivel institucional dhe rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar sipas dokumentave të vëna në dispozicion GVJ-së.</p> <p>[Evidenca 8]</p>						
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student në strukturën e KSBC-së, duke shmangur gjithashtu diskriminimin apo pabarazinë ndërmjet tyre.</p> <p>[Evidenca 8]</p>						
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm janë stafi akademik, studentët, bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm në strukturën e KSBC-së.</p> <p>[Evidenca 12.1, 30, 30.4, 30.9, 30.10]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të</p>	<p>Universiteti European I Tiranës, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike https://uet.edu.al/rreth-uet/ të Universitetit, si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Kryesore, Njësite Bazë duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij.</p> <p>GVJ gjykon që krahas rregullores së KSBC-së, institucioni ka hartuar edhe një plan pune sipas një plani kalendarik (planit të veprimit) të përvitshëm.</p> <p>[Evidenca 30.1]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të KSBC dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave u informua që Institucioni publikon rezultatet si është parashikuar në rregullore. Kështu sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët, rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës sikurse edhe Rektorit.</p> <p>[Evidenca 30.7, 37]</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësiave e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përfaqësues të KSBC, evidentoi se në rast të vlerësimeve negative, synohet shqyrtimi i tyre dhe marrja e masave për përmirësim nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme në aspektin didaktik dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në RVB theksohet se UET organizon plan masash të cilat adresojnë përmirësimin e mangësiave dhe dobësive të evidentuara në pyetësori i plotësuar nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studenti. Por GVJ, në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion nuk evidentoi ndonjë evidencë në lidhje me këtë.</p> <p>[Evidenca 41]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Synimi i vazhdueshëm i Universitetit European të Tiranës, është efektiviteti i veprimtarive në kuadër të përmirësimin të cilësisë si edhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies UET e ka bazuar në ngritjen e strukturave përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Kurrikulave, • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, • Koordinatorit të programit të studimit <p>Këto struktura por edhe aktorët e tjerë në UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të</p>

	<p>programeve të studimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët.</p> <p>[Evidenca 2, 8, 13, 36]</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Në RVB theksohet se Institucioni organizon aktivitete dhe veprimtari periodike për informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe që në këto veprimtari marin pjesë edhe përfaqësi nga studentët.</p> <p><i>GVJ, në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion nuk eidentoi ndonjë evidencë në lidhje me këtë.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se evidencat e vëna në dispozicion në sistem, në mbështetje të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, ishin të përgjithshme në formën e dokumentave themeltarë (statut, plane strategjike, rregullore të ndryshme, procedura pune, manuale), dokumentacionit të programit të studimit (kurrikul, plan mësimor, rregullorja e programit të studimit, silabuset e lëndëve, cv e stafit, etj), memorandumet bashkëpunimi. Në sistem nuk kishte regjistrime në lidhje me mënyrën se si zbatohen procedurat e punës gjatë kryerjes së aktiviteteve nga Njësia kryesore, njësia bazë si dhe nga administrata. Të gjitha format e hedhura në sistem ishin të paplotësuara. Për më tepër RVB i është referuar kryesisht dokumentave dhe jo mënyrës së zbatimit të tyre për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Industriale.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Industriale”, me profile: “Inxhinieri Energjitike”, “Inxhinieri Mekanike”, “Inxhinieri Transporti”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. UET-i ka implementuar një sistem të plotë të menaxhimit në nivel institucional, me një dokumentacion të plotë, të cilat janë bazë për funksionimin normal të tij. Veprimtaria akademike dhe ajo administrative në UET kontrollohet nga rregulla të qarta e të sakta, të shprehura në Statutin e UET, Rregulloren Bazë të UET, Broshurën e Dokumenteve Themelore të UET, dhe në dokumentacionin e programeve të studimit etj. Këto dokumente, janë të depozituara në sistemin informatik të UET dhe të disponueshme elektronikisht nga tërë personeli akademik, administrativ si dhe studentët për çështje në interes të tyre.
2. Institucioni ka vënë në dispozicion të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij program studimi, e cila mirëmbahet në vazhdimësi. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën fizike dhe online me literaturë mbështetëse të procesit të mësimnxënies.
3. UET ka ndërtuar struktura institucionale për të mundësuar një menaxhim të qëndrueshëm, në nivel institucional të gjithë procesit mësimor. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë organet drejtuese të Universitetit, Departamentet/Fakultetet, Drejtoria e Standardeve dhe Cilësisw dhe Komisioni I Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë. Sistemi menaxhimit LMS për procesin mësimor ka rritur cilësinë e komunikimit ndërmjet niveleve të ndryshme: studentëve, pedagogëve, stafit drejtues të njëjësive bazë/njëjësive kryesore dhe aksesueshmërinë e studentëve ndaj materialeve didaktike.
4. Stafi akademik, i përfshirë në programin e studimit në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe ka ekspertizën e nevojshme në mësimdhënie.
5. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa indikatorëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm për ta vendosur studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e inkurajuese.
6. UET ka realizuar marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi të mira mobiliteti për stafin akademik dhe studentët.
7. Institucioni ka njësi të posaçme dhe procedura për orientimin dhe këshillimin e studentëve, të cilat operojnë në vazhdimësi dhe përdoren nga studentët. Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe sigurimit të cilësisë së tyre.

Pika të dobta



1. Formulimi i rezultateve të të nxënit nuk shprehin qartazi njohuritë që merr studenti në fushën e Inxhinierisë Industriale, aftësitë që fiton dhe kompetencat profesionale, sipas kërkesave të VKM Nr.879, datë 18.12.2019. Rezultatet e të nxënit nuk bëjnë diferencën për profilet që ofrohen. Objektivat formuese nuk shkojnë tërësisht në linjën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar për profesionet e rregulluara. VKM Nr. 514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, si dhe me direktivën e Bashkimit Europian 2005/36/EC “on the recognition of professional qualifications”.
2. Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit-strukturës dhe përmbajtjes së kurrikulës - mundësive të punësimit nuk është domethënëse dhe e qëndrueshme. Programi i studimit nuk arrin të formojë specialistë, që të punojnë në sektorët e industrisë prodhuese qofshin këto në fushën e mekanikës, të elektrikes, të impianteve kimike, etj., pasi studentët marrin shumë pak informacion të thelluar në lidhje me proceset e prodhimit, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë, automatizimin e proceseve industrial, etj. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që zhvillohen nga ky program studimi përafrohen më shumë me programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike se sa me formimin Inxhinieri Industriale, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve të miratuar me VKM 514, date 20.09.2017.
3. Mundësitë e punësimit të shprehura për disa profile dalin jashtë objektivave formuese, (p.sh. në profilin Inxhinieri Transporti jepen mundësi të punësimit në nën-sektorë apo aktivitete, për të cilat në kurrikulën përkatëse nuk përfshihen disiplinat formuese). Tre disiplina me 18 ECTS gjithsej (15% të totalit të krediteve) nuk mund të bëjnë një diferencim shumë të madh në mundësitë e punësimit. Nga ana tjetër mundësitë e punësimit janë të shprehura në forma të ndryshme në disa dokumenta.
4. Emërtimi i profileve: “*Inxhinieri Mekanike*”, “*Inxhinieri Energjitike*”, “*Inxhinieri Transporti*”, programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale nuk është në përputhje me klasifikimin e fushave të edukimit sipas ISCED, ku fushat e studimit në “*Inxhinieri Mekanike*”, “*Inxhinieri Energjitike*”, “*Inxhinieri transporti*” klasifikohen si fusha bazë në edukimin inxhinierik. Emërtimi i profileve “*Inxhinieri Energjitike*”, “*Inxhinieri Mekanike*”, “*Inxhinieri Transporti*”, të cilat diferencohen nga njera tjetra vetëm me 18 ECTS, i ekuivalenton këto profile me programet e studimit bazë Master i Shkencave, me të njëjtin emërtim. Emërtimi i profileve “*Inxhinieri Transporti*” dhe “*Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh*” nuk përputhet me rezultatet e të nxënit që përfton studenti në përfundim të tyre. Profili “*Inxhinieri Energjitike*” i këtij programi studimi përafrohet shumë më tepër me profilin Energjitike të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, dhe jo me fushën e Inxhinierisë Industriale. Profili “*Menaxhim dhe Vlerësim Projekti*” nuk përputhet me listën e klasifikimit të profesioneve, (VKM 514, date 20.09.2017). Kjo e vështirëson hyrjen e studentëve në tregun e punës.
5. Organizimi i kurrikulës është më shumë në funksion të profilit “*Inxhinieri Energjitike*”. Në disiplinat e trungut të përbashkët 50% e krediteve të kategorisë B i përkasin lëndëve që japin formim në fushën e energjistikës dhe vetëm 20% e tyre i përkasin fushës së teknologjisë së prodhimit. Në trungun e përbashkët nuk ka asnjë disiplinë në drejtim të formimit menaxherial, që është aq i nevojshëm për Inxhinierin Industrial, të orientuar drejt prodhimit. Në kurrikulë janë parashikuar disiplina, të cilat nuk lidhen me formimin e Inxhinierisë Industriale dhe/ose studenti nuk ka njohuri paraprake të nevojshme për të nxënit e asaj lënde, si “*Bioteknologji*”, “*Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve Elektrike dhe Energjitike*”, “*Mekatronikë*”.

6. Në planin mësimor nuk reflektohet sasia e krediteve të lëndës që alokohen për detyra/projekte. Aktiviteti formues detyrë ose projekt nuk pasqyrohet në planin mesimor, megjithëse ky aktivitet është pjesë përbërëse e aktiviteteve formuese të disiplinave inxhinjrike. Ndërkohë kontrolli i vazhdueshëm nuk është aktivitet formues për lëndën.
7. Në silabuset e vëna në dispozicion ka mangësi të theksuara, si:
 - mungesa e disa silabuseve në sistem, ose mungesa në faqe;
 - mospërputhje të orëve në auditor të vendosura në planin mësimor me ato të reflektuar në silabuse;
 - Rezultatet e të nxënit për lëndën nuk shprehen sipas komponentëve të tij përbërës: njohuritë që fiton studenti, aftësitë për zbatim dhe kompetencat në përfundim të lëndës.
 - Për aktivitetin formues ushtrime/laborator, në silabus, nuk jepet asnjë informacion i detajuar. Në disa silabuse nuk reflektohet fare ky aktiviteti formues, megjithëse janë të parashikuar në planin mësimor.
 - Nuk jepet informacion për aktivitetin formues “Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor”, megjithëse janë alokuar 18-22orë orë në auditor.
 - Në përmbajtjen e disa silabuseve ka përsëritje të tematikave të dhëna në disiplina të tjera të ciklit të parë
 - Ka mospërputhje të informacionit që jepet në “Përmbledhje të lëndës dhe rezultatet e të nxënit” me përmbajtjen e lëndës.
8. Burimet njerëzore efektive për këtë program studimi janë të kufizuara. Numri i personelit akademik efektiv, të përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, referuar stafit të deklaruar për vitin akademik 2021-2022, është relativisht i ulët (5 PAE ndaj 11 PAK). Ngarkesa mësimore e realizuar në këtë program studimi nga personel akademik efektiv i UET është 32.1% (më i ulët se 70%).
9. Koordinator i programit të studimit nuk ka ekspertizën e nevojshme për këtë program studimi. Për më tepër departamenti ka caktuar një koordinator programi studimi për të gjitha programet e studimit që ofron: në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, Inxhinierisë Industriale dhe Arkitekturës
10. Fondi i librave në dispozicion të studentit, në fushën e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Industriale”, është i vogël dhe relativisht i vjetër. Tekstet që rekomandohen nga pedagogu në silabuset e lëndëve përgjithsisht nuk gjenden në bibliotekë.
11. Raportet e vlerësimit nuk përfshijnë planin e masave që duhet të merret për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Rekomandime

1. Të formulohen rezultatet e të nxënit të këtij programi studimi konform me kornizën ligjore në fuqi, duke përfshirë Njohuritë që merren, Aftësitë që fiton, Kompetencë për vendimmarrje. Rezultatet e të nxënit të jenë në përputhje me klasifikimin ISCED të fushave të edukimit, Listës Kombëtare të Profesioneve dhe brenda nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK). Të shprehet qartazi diferenca në rezultatet e të nxënit për profilet që ofrohen, duke i lidhur me mundësitë e punësimit.

2. Të rishikohet struktura dhe përmbajtja e kurrikulës, për t'ju përshtatur rezultateve të të nxënit dhe tregut të punës, duke u orientuar drejt sektorëve të industrisë prodhuese në fushën e mekanikës, të elektrikes, të impianteve kimike, etj.
3. Të saktësohen mundësitë e punësimit për profilet e ofruara, duke i lidhur me rezultatet e të nxënit dhe kurrikulën.
4. Të rishikohen profilet dhe emërtimet e tyre, duke mbajtur parasysh që profilet të jenë nën-ndarje të formimit kryesor, pa haruar qëllimin për të cilën ngrihet ky program studimi dhe emërtimet e tyre të jenë të lidhura ngushtësisht me emërtimin kryesor, duke shmangur konfuzionin me emërtimet në fushat bazë të inxhinierisë. Rekomandohet që të rritet pesha (në kredite) e disiplinave që formojnë profilizimet.
5. Të ripunohet plani mësimor dhe silabuset e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, duke reflektuar konstatimet e bëra nga grupi i ekspertëve. Planet mësimore të jepen të ndarë sipas profileve dhe në to të evidentohet viti akademik përkatës dhe firmat e personave përgjegjës për atë plan mësimor: përgjegjësi i departamentit, dekani dhe rektori. Në kurrikul të shmangen disiplina, përmbajtja e të cilave nuk lidhet me rezultatet e të nxënit të këtij programi studimi, ose studenti nuk ka njohuri paraprake të nevojshme për të nxënurit e asaj lënde.
6. Në planin mësimor të reflektohet sasia e krediteve të alokuara për detyra/projekte, si aktivitete formuese të lëndës.
7. Silabuset të rishikohen për të pasqyruar të gjitha aktivitetet formues të lëndës: kreditet/orët e alokuara për aktivitetet Seminar, Ushtrime, Tematikat e punëve laboratorike, tematikat e detyrave apo projekteve, çështjet që duhet të trajtohen në zbërthimin e një teme leksioni. Të gjitha silabuset të miratohen nga përgjegjësi i departamentit që ofron këtë program studimi.
8. Rekomandohet që Institucioni të synojë në rritjen e numrit të personelit akademik efektiv me ekspertizë në fushën akademike të njejtë/të afërt me Inxhinierinë Industriale, duke përmirësuar raportin PAE/PAK për këtë program studimi, me qëllim që ngarkesa mësimore e realizuar nga PAE të jetë të paktën 70% e ngarkesës totale dhe niveli i kualifikimit të personelit akademik të jetë më i lartë se ai i ciklit të studimit.
9. Rekomandohet që koordinatori i programit të studimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit, rishikimin e silabuseve dhe zhvillimin e praktikave profesionale të ketë kompetencën e nevojshme në fushën përkatëse të studimit.
10. Rekomandohet që të pasurohet biblioteka me botime të viteve të fundit në fushat inxhinierike, në mënyrë që studentët të kenë akses në literaturën e rekomanduar në silabuset e lëndëve.
11. Në rregulloren e programit të studimit të saktësohen në kriteret e hyrjes fushat e edukimit paraprak të studentit si dhe të vendosen kriteret për të kontrolluar cilësinë në hyrje.
12. GVJ rekomandon që departamenti të synojë me shumë në rritjen e efektivitetit të mekanizmave të vendosura për sigurimin e cilësisë së programit të studimit (Bordi i tregut të punës, kontrolli i silabuseve, roli i koordinorit të programit të studimit, monitorimi i cilësisë në mësimdhënje, roli i studentëve, etj.) me synimin përmirësimi i kurrikulës, planin mësimor dhe silabuset e lëndëve.




13. GVJ rekomandon që DIA të bëjë përpjekje për përfshirjen e studentëve të Inxhinierisë Industriale në aktivitete kërkimore, nëpërmjet bashkëpunimit të tyre me pedagogët. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturë, duhet të motivoj studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore pasi profilet që janë pjesë e këtij Masteri paraqesin fusha interesi kombëtare, ku angazhimi i studentëve sidomos në përfundim të studimeve (vitet e dyta) të mund të japin kontribut real analitik dhe bibliografik.
14. Gjetjet e raporteve të vlerësimit të diskutohen nga njësitë kryesore duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas të diskutohen në mbledhjet e Rektoratit. Në këtë të fundit përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien i cili mund ti përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit.
15. Komisionet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësitë Bazë/ Departamentet (KSCBF) duhet të kthehen në struktura të plota dhe të konsoliduara në praktika.



Conclusions of the evaluation of the first cycle study program, Master of Science "Industrial Engineering" with profiles "Energy Engineering", "Mechanical Engineering", "Transportation Engineering", "Project Management and Evaluation" of European University of Tirana.

Strengths and Affirmations:

1. UET has implemented a whole management system at the institutional level, with all necessary documentation, which is the basis for governing and managing of main and supporting process. The academic and administrative processes are controlled by clear and precise rules, expressed in the UET Statute, the UET Basic Regulation, the UET Basic Documents Booklet, and in the study program documentation, etc. These documents are uploaded at the information system of UET and are electronically available by all academic and administrative staff as well as by students.
2. The institution has the necessary facilities to realize this study program. The premises fulfill the teaching state standards and are regularly maintained. The institution has made available to students supporting learning facilities, physical and online library with literature supporting the learning process.
3. UET has built an institutional organizational structure to enable a sustainable management of the teaching process at the institutional level. The structures responsible for quality assurance are the governing bodies of the University, the Departments/Faculties, the Directorate of Standards and Quality, and the Internal Quality Assurance Commission. The LMS management system for the learning process has increased the quality of communication between different levels: students, lecturers, management staff of basic units/main units and the students' accessibility to didactic materials.
4. The academic staff involved in the Bachelor of Industrial Engineering study program is qualified and has the necessary competences in this academic field.
5. The assessment of the student's academic progress is based on the principle of continuous control. The final grade takes into account the weight of assessing students in subject forming activities, with the aim of student continued assessment throughout the courses. Continuous assessment increases the level of objectivity and transparency in student assessment and has a stimulating and encouraging nature.
6. UET has signed agreements with a number of Albanian and foreign homolog institutions, creating good opportunities for mobility of academic staff and students.
7. The institution has proper units and procedures for student orientation and counseling. This unit performs different activities to help the students during their studies courses. The students are included and engaged in decision-making and advisory bodies of the institution in framework of drafting, approval, review and improvement of study programs, teaching methods and quality assurance.



Weaknesses:

1. The formulation of learning outcomes does not clearly express the knowledge that the student receives in the area of Industrial Engineering, the skills that he acquires and the professional competences, according to the requirements of VKM No. 879, dated 18.12.2019. Learning outcomes do not make a difference to the profiles offered. Forming objectives do not go entirely in the lines defined in the Albanian legislation for regulated professions. VKM No. 514, dated 20.09.2017 "On the approval of the national list of professions (LKP)", revised, as well as with the directive of the European Union 2005/36/EC "on the recognition of professional qualifications".
2. The correlation between learning outcomes - curriculum structure and content - employment opportunities is not significant and consistent. The study program fails to train specialists to work in the manufacturing industry sectors, such as in the areas of mechanics, electricity, chemical plants, etc., since the students acquire very little in-depth information about production processes, management and quality control, automation of industrial processes, etc. The knowledge, skills and competences developed by this study program are more similar to the Master of Science in Mechanical Engineering study program than to the Industrial Engineering training, referred to the National List of Professions approved by VKM 514, dated 20.09.2017.
3. The employment opportunities expressed for some profiles go beyond the learning outcomes, (eg at the Transport Engineering profile, employment opportunities are provided in sub-sectors or activities, for which there are not included forming subjects in its curriculum). Three subjects with a total number of 18 ECTS credits (15% of total credits) cannot make a very big difference in employment opportunities. On the other hand, employment opportunities are not the same in several documents.
4. The naming of the profiles of this study program, as: "Mechanical Engineering", "Energy Engineering", "Transportation Engineering", is not in line with the classification of education fields according to ISCED, where the areas of study in "Engineering Mechanical", "Energy Engineering", "Transportation Engineering" are classified as basic fields in engineering education. This kind of naming gives a confusion in practical using of Diploma title. The naming of the profiles "Transportation Engineering" and "Project Management and Evaluation" does not match the learning outcomes of this study program. The "Energy Engineering" profile of this study program aligns much more with the Energy profile of the study program "Master of Science in Mechanical Engineering", and not with the field of Industrial Engineering. The "Project Management and Evaluation" profile does not comply with the list of regulated professions classification (VKM 514, date 20.09.2017). This induces difficulties for students to enter in the labor market. The profiles are differed from each other only by 18 ECTS.
5. The curriculum design is oriented mainly towards the profile "Energy Engineering". The subjects of category B that are in the joint trunk have different weights related to the academic profiles. So, 50% of them expressed in ECTS credits belong to the academic area of energy and only 20% of them belong to the academic area of production and technology. In the joint trunk, there is no subject in the area of management training, which is so significant for the Industrial Engineer, oriented towards production. The curriculum includes disciplines that are not related to learning outcomes for Industrial Engineering and/or the student does not have the necessary background to study that subject, such as "Biotechnology", "Science and Technology of Electrical and Energy Materials", "Mechatronics".



6. At the teaching plan there are not reflected the number of credits allocated to assignments/projects. The forming activity assignment/project is not reflected in the curriculum, although this activity is an integral part of the forming activities of engineering disciplines. Meanwhile, continuous control is not a forming activity for the subject.
7. There are significant deficiencies at the uploaded syllabi, such as:
 - lack of some syllabi in the system/or lack of the pages;
 - mismatch between teaching hours in the auditorium presented in the curriculum with those reflected in the syllabus;
 - The subject learning outcomes are not expressed according to their proper components: knowledge the student acquires, skills for application and the competencies.
 - No detailed information is given in the syllabus for the exercise/laboratory activity. Some syllabi do not reflect this forming activity at all, although it is presented in the curriculum.
 - No information is given about the forming activity "Forms of continuous control and sessions of professional practices developed in the auditorium", although 18-22 hours are allocated in the auditorium.
 - In the content of some syllabi, there are repetitions of topics given in other disciplines of the first cycle
 - There is a discrepancy between the information provided in the "Summary of the course and learning outcomes" with the content of the course.
8. Effective human resources for this study program are limited. The number of effective academic staff involved in teaching in the study program "Master of Science in Industrial Engineering", referring to academic year 2021-2022, is relatively low (5 PAE by 11 PAK). The teaching load realized in this study program by effective academic staff of UET is 32.1% (lower than 70%).
9. The coordinator of the study program does not have the necessary expertise for this academic field of study. In addition, the department has appointed one coordinator for all the study programs it offers: in the field of Civil Engineering, Industrial Engineering and Architecture.
10. The books fund at library, in the "Industrial Engineering" academic field, is too small and relatively in old publications. Texts recommended by the lecturer in the subject syllabi are generally not found in the library.
11. The evaluation reports do not include the proper activities plan to address the deficiencies and continual improving of the study program quality.

Recommendations:


1. The learning outcomes of this study program have to be formulated in accordance with the legal framework in force, describing the Knowledge taken, Skills acquired, Competence for decision-making. The differences in learning outcomes for the offered profiles have to be clearly stated, referring them to employment opportunities.
2. The curriculum structure and content of this study program has to be revised, in order to adapt to the learning outcomes and the labor market, and being oriented towards the sectors of the manufacturing industry in the field of mechanics, electricity, chemical plants, etc.




3. The department need to specify the employment opportunities for the profiles offered, linking them to the learning outcomes and proper curriculum.
4. Department need to revise the profiles and their designations, keeping in mind that the profiles are sub-divisions of the main academic forming providing by this study program and their designations are closely related to the main designation, avoiding confusion with designations in basic engineering fields. It is recommended to increase the weight (in credits) of the profile disciplines.
5. The curriculum and syllabi of the study program "Master of Science in Industrial Engineering" need to be revised, in order to be corrected all the findings found by the group of experts. The teaching plans should be divided according to the profiles. There should be evidenced the corresponding academic year and the signatures of the persons responsible for that teaching plan: department head, dean and rector. In the curriculum should be avoided subjects that are not in line with learning outcomes, or the student does not have the necessary prior knowledge to study that subject.
6. The number of credits allocated to assignments/projects, as formative activities of the subject should be reflected to the teaching plan.
7. Syllabi should be revised to reflect all formative activities of the subject: credits/hours allocated for seminar activities, exercises, topics of laboratory work, topics of assignments or projects, issues that should be addressed in explaining the lecture topics. All syllabi must be approved by the head of the department offering this study program. The content of the course syllabuses has to be reviewed to avoid repeating topics and matching them to the learning outcomes.
8. Despite the fact that until now the full-time and contracted academic staff have the appropriate qualification and competences for this study program, it is necessary for the Institution to have a long-term strategy for the recruitment and qualification of new academic staff.
9. The coordinator of the study program, who is responsible for realizing of the study program, revising of the syllabi and developing of professional practices, has to have the necessary competence in the relevant academic field of study.
10. It is recommended to enrich the library with new publications in the engineering fields, so that students should have access to the literature recommended in the subject syllabi.
11. It is necessary to specify as the entry criteria, in the study program regulation, the student's preliminary education Diploma, as well as the other selection criteria intently to control the entry quality of students.
12. It is necessary to be increased the effectiveness of the mechanisms established to ensure the quality of the study program, as Labor Market Board, control of syllabuses, the role of the coordinator of the study program, monitoring the quality of teaching, the role of students, etc., with the aim of improving the curriculum, the teaching plan and the syllabi of the subjects.
13. Department has to make efforts to involve Industrial Engineering students in research activities, through their cooperation with academic staff. The Department of Engineering and Architecture

has to motivate students to draft, write and publish scientific studies and papers, as the profiles of this study program are scientific areas of national interest.

14. The findings of the evaluation reports should be discussed by the main units giving relevant proposals, which should then be analyzed at the Rectorate. Rectorate should draw up the Activities Plan for continuous improvement of quality in Study Programs and Teaching, which can be approved to the Academic Senate of the institution.
15. Internal Quality Assessment Commissions in Base Units/Departments (KSCBF) should be turned into complete structures and consolidated in practice.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

